



# RAPORTI VJETOR

2018

## Përmbajtje

|                                                                                                                                                                        |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| MESAZHI I KRYETARIT TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE .....                                                                                                        | 3  |
| HYRJE .....                                                                                                                                                            | 4  |
| 1 STRATEGJIA AUTORITETIT .....                                                                                                                                         | 8  |
| 2 ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NË REZOLUTËN E KUVENDIT PËR RAPORTIN VJETOR TË AUTORITETIT PËR VITIN 2018.....                                                   | 9  |
| 3 MASAT E MARRA NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONE TË TJERA KUSHTETUESE OSE TË PAVARURA NDAJ AUTORITETIT .....                                    | 21 |
| 4 REKOMANDIMET E LËSHUARA NË PROGRES-RAPORTIN E BE-së DHE DETYRIME TË TJERA NDËRKOMBËTARE NDAJ AUTORITETIT.....                                                        | 23 |
| 4.1 Në lidhje me procesin e kalimit në transmetimet numerike.....                                                                                                      | 23 |
| 4.2 Në lidhje me çështje të tjera .....                                                                                                                                | 27 |
| 5 TË DHËNA LIDHUR ME AKTIVITETIN E AUTORITETIT PËR KRYERJE INSPEKTIMESH OSE HETIMESH ADMINISTRATIVE, VENDIME TË SANKSIONEVE ME GJOBË NË RAPORT ME VITET E FUNDIT ..... | 29 |
| 6 QEVERISJA E AUTORITETIT .....                                                                                                                                        | 32 |
| 6.1 Vendimmarrja mbi licencat/autorizimet .....                                                                                                                        | 32 |
| 7 AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM ...                                                                                                | 35 |
| 7.1 Shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuara .....                                                                                                                 | 35 |
| 7.2 Monitorimet e përmbajtjeve.....                                                                                                                                    | 38 |
| 7.3 Përjasja ndaj fenomenit të piraterisë në transmetimet audiovizive .....                                                                                            | 45 |
| 8 KËSHILLI I ANKESAVE.....                                                                                                                                             | 47 |
| 9 AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMËRISË LIGJORE.....                                                                                                              | 51 |
| 9.1 Referencat ligjore mbi të cilat mbështetet aktiviteti i institucionit .....                                                                                        | 51 |
| 9.2 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA. ....                                                                            | 52 |
| 9.3 Nevoja për ndryshime të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit.....                                                                              | 53 |
| 9.4 Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave.....                                                                                                          | 54 |
| 10 AUTORITETI SI NXITËS I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT AUDIOVIZIV .....                                                                                                      | 56 |
| 10.1 Angazhimi i Autoritetit në zhvillimet teknologjike të tregut audioviziv .....                                                                                     | 56 |
| 10.2 Kontributi i Autoritetit në mbështetje të studimeve shkencore.....                                                                                                | 56 |
| 10.3 Bashkëpunimi në rregullimin e tregut audioviziv .....                                                                                                             | 57 |
| 11 KALIMI NË TRANSMETIMET NUMERIKE.....                                                                                                                                | 59 |
| 11.1 Lirimi i brezit të Dividendit Digjital. ....                                                                                                                      | 65 |
| 11.2 Fushata e infomimit të publikut në lidhje me procesin e transmetimeve digjitale.....                                                                              | 67 |
| 11.3 Kontrata AMA - RTSH.....                                                                                                                                          | 69 |
| 11.4 Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave .....                                                                                                      | 71 |

|        |                                                                                      |    |
|--------|--------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 11.4.1 | Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive.....                             | 71 |
| 11.4.2 | Koordinimi i frekuencave të brezit audioviziv.....                                   | 72 |
| 11.4.3 | Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio .....                                  | 73 |
| 11.5   | Adresimi i intererencave të shkaktuara nga operatorët audio/audiovizive.....         | 73 |
| 12     | AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RRITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL ..... | 75 |
| 12.1   | Organizimi i brendshëm i institucionit.....                                          | 75 |
| 12.2   | Programi i transparencës.....                                                        | 76 |
| 12.3   | Aktivitetet e Autoritetit .....                                                      | 77 |
| 12.4   | Botimet e Autoritetit .....                                                          | 81 |
| 12.5   | AMA në bashkëpunim me partnerët .....                                                | 81 |
| 12.6   | Marrëveshjet e bashkëpunimit .....                                                   | 82 |
| 12.7   | Publikimi i Buletinit Periodik të AMA-s .....                                        | 84 |
| 12.8   | Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore .....                                 | 84 |
| 12.9   | Infrastruktura e informacionit dhe e njohurive .....                                 | 88 |
| 13     | TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE.....                                   | 89 |
| 13.1   | Menaxhimi i burimeve financiare .....                                                | 89 |
| 13.2   | Realizmi i burimeve të financimit në vitin 2018.....                                 | 89 |
| 13.2.1 | Ecuria e arkëtueshmërisë të burimeve të vetfinancimit (a+b+c+ ç).....                | 89 |
| 13.2.2 | Detyrimet financiare të OSHMA-ve .....                                               | 91 |
| 13.2.3 | Financime nga Buxheti i Shtetit.....                                                 | 93 |
| 13.3   | Përdorimi i burimeve financiare në vitin 2018 .....                                  | 93 |
| 13.3.1 | Shpenzimet dhe investimet të mbuluara me vetfinancim.....                            | 93 |
| 13.3.2 | Shpenzimet me fonde të buxhetit të Shtetit.....                                      | 95 |
| 13.4   | Pasqyrat Financiare .....                                                            | 95 |

## **MESAZHI I KRYETARIT TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, gjatë vitit 2018 u investua maksimalisht për realizimin e detyrave dhe funksioneve institucionale, në favor të konsolidimit të performancës, si një rregullator eficient dhe i pavarur, për të ndikuar në konkurrencën e lirë dhe të ndershme të operatorëve në tregun audioviziv.

Miratimi dhe përmirësimi i një sërë rregulloreve dhe udhëzimeve, bazuar në kërkesat e ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, influencojnë konkretisht në cilësinë dhe shumëllojshmërinë e produkteve audio dhe audiovizive, si dhe modernizimin e shërbimeve për publikun.

Për herë të parë, në muajin shtator të vitit të kaluar, u arrit mbyllja e të gjithë transmetimeve të paligjshme audiovizive numerik dhe analog, si dhe audio, si një problematikë prezente në rreth dy dekada në qendrat kryesore urbane të vendit.

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për AMA-n, vitin e kaluar janë realizuar shqyrtime tematike për vlerësimin e përputhshmërisë ligjore dhe zbatimit të Kodit të Transmetimit për përmbajtjet e emetuara nga OSHMA-të. Këto shqyrtime periodike u fokusuan tek mbrojtja e fëmijëve në transmetimet audiovizive; reklamat dhe komunikimet tregtare; programet audiovizive me karakter informimin mbi shëndetin dhe përdorimin e medikamenteve; respektimi i standardeve të shqipes së folur dhe të shkruar; përmbajtjet e dëmshme me dhunë, pornografi apo përdorim të substancave narkotike në kanalet e profilit muzikor.

Gjatë vitit të kaluar AMA dhe Komisioni për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë u koordinuan në çështjen e rregullimit të marrëdhënieve të punës së gazetarëve në mediat audiovizive. Në maj 2018, për herë të parë, u ulën në një tryezë diskutimi përfaqësues nga të gjitha grupet e interesit: gazetarë, drejtues mediash, nga shoqatat dhe organizatat e tyre, anëtarë të parlamentit, profesorë të gazetarisë, institucionet shtetërore që mbulojnë aspekte të punësimit etj., me vetëdijen sa pa një gazetar të sigurtë në punë nuk mund të kemi media të lirë dhe pluraliste.

Partneriteti me organizata dhe institucione që punojnë në fushë e medias ka vijuar edhe për 2018-n si një standard i konsoliduar i AMA-s, për të realizuar projekte që ndikojnë në përmirësimin e raportimit të redaksive audiovizive në aspekte të tilla si, mbrojtja e fëmijëve, barazia gjinore, Fake News, edukimi mediatik apo përshtatja e aplikacioneve të reja në redaksitë audiovizive. Risi në këtë partneritet ishte angazhimi për të pasuruar literaturën në gjuhën shqipe mbi median audiovizive, duke përkthyer tituj nga fondi i bibliografisë ndërkombëtare.

AMA gjatë vitit të kaluar u tregua proaktive në ndërtimin dhe forcimin e urave të komunikimit me institucione dhe agjenci të tjera publike për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me qëllim krijimin e hapësirave dhe lehtësimin e formave të kooperimit të punës. Ky angazhim është në kuadër të ndjekjes dhe zbatimit të mekanizimit ndërinstitutional për monitorimin sistematik të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj- një iniciativë kjo e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

## HYRJE

Në përmbushje të detyrave dhe funksioneve të AMA-s të përcaktuara në Ligjin 97/2013, Strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në transmetimet numerike, Planin e Veprimit të Dokumentit Strategjik të AMA-s si dhe në përmbushje të rekomandimeve të Bashkimit Evropian dhe Kuvendit të Shqipërisë, gjatë vitit të kaluar Autoriteti është angazhuar tek procesi i digjitalizimit të transmetimeve audiovizive.

Aktualisht janë mbyllur transmetimet analoge në tre qarqe të vendit, Berat, Fier dhe Korçë, dhe më 1 shtator 2019 do të mbyllen transmetimet analoge edhe në dy qarqet me popullsi më të madhe në vend, Tiranë dhe Durrës, si dhe në qarkun e Vlorës.

Për herë parë, në shtator të vitit të kaluar tregu audioviziv shqiptar arriti mbylljen e të gjithë transmetimeve të paligjshme, të cilat ofroheshin përmes teknologjisë DVB-T prej më se 15 vitesh. Kjo u arrit në bashkëpunim të ngushtë me operatorët në treg, të cilët u angazhuan maksimalisht në zëvendësimin e pajisjeve të përdoruesve apo rikonfigurimin e tyre.

Gjatë vitit të kaluar, operatori publik shqiptar (RTSH) përfundoi shtrimin e infrastrukturës numerike në të gjithë vendin, ndërsa operatorët privatë kombëtarë numerikë vijnë implementimin e rrjeteve të tyre në qarqet ku ende nuk janë mbyllur transmetimet analoge. Aktualisht, rreth 70 % e popullsisë ka mundësi të aksesojë transmetimet digjitale audiovizive. Në zonat ku është prezent sinjali digjital është dy-trefishuar numri i programeve që transmetohen pa pagesë.

Gjatë vitit 2018 u realizua dhe lirimi i brezit të Dividendit Digjital, i cili u akordua për shërbimet e lëvizshme çka do të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve të internetit me shpejtësi të lartë në rang kombëtar.

Promovimi dhe inkurajimi i futjes së teknologjive të reja, duke ruajtur konkurrencën dhe mundësitë e barabarta për të gjitha palët e interesuara është një ndër fokuset e AMA-s. Tregues për përmbushjen e kësaj detyre është vetë tregu mediatik, i cili tashmë ofron shërbimet e reja innovative, si Video on Demand, Chach up, OTT etj. AMA ka nxitur dhe inkurajuar operatorët në treg nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, ka përgatitur terrenin për të lehtësuar hyrjen e shërbimeve të reja, duke miratuar akte rregullative me procedura lehtësuese për të gjithë të interesuarit.

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për AMA-n vitin e kaluar janë realizuar shqyrtime tematike për vlerësimin e përputhshmërisë ligjore dhe zbatimit të Kodit të Transmetimit për përmbajtjet e emetuara nga OSHMA-të. Këto shqyrtime periodike janë fokusuar tek mbrojtja e fëmijëve në transmetimet audiovizive; reklamat dhe komunikimet tregtare; programet audiovizive me karakter informimin mbi shëndetin dhe përdorimin e medikamenteve; respektimi i standardeve të shqipes së folur dhe të shkruar; përmbajtjet e dëmshme me dhunë, pornografi apo përdorim të substancave narkotike në kanalet e profilit muzikor.

Po në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, AMA gjatë vitit të kaluar ka kryer dhe dy vlerësime për procesin e ndërtimit të buqetës me programet e vetë RTSH-së, bazuar në kërkesat e Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në Kontratën e Shërbimit të transmetimit publik. Sipas standardit të AMA-s, gjetjet, përfundimet dhe sugjerimet e vlerësimeve u janë përcjellë për njohje drejtuesve të RTSH-së, si dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues. Informacioni mbi ndërtimin e buqetës së programeve të vetë RTSH-së është shoqëruar dhe me informacionin mbi nivelin e arritjes së mbulimit me sinjal të Transmetuesit Publik në territorin e vendit, një aspekt tjetër shumë sensitiv për ofrimin e shërbimit për qytetarët nga ana e Transmetuesit Publik në gjithë territorin e vendit.

AMA, gjatë vitit 2018, ka konsoliduar më shumë partneritetin dhe sinergjinë me institucione dhe organizma që dhe ato angazhohen në problematikat e tregut audio e audioviziv. Në muajin maj AMA dhe Komisioni për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë u bashkëinvestuan në çështjen e rregullimit të marrëdhënieve të punës së gazetarëve në mediat audiovizive. Për një kohë të gjatë komuniteti i gazetarëve ka hasur dhe has problematika të tilla si, niveli i kushteve të punës së gazetarëve, format e rekrutimit dhe largimit nga redaksia, mosshlyerja në kohë e pagesave nga punëdhënësi, pafuqinë e organizatave të gazetarëve etj. Ndaj, AMA dhe Komisioni, për herë të parë ulën në një tryezë diskutimi përfaqësues nga të gjitha grupet e interesit: gazetarë, drejtues mediash, nga shoqatat dhe organizatat e tyre, anëtarë të Parlamentit, profesorë të gazetarisë, institucionet shtetërore që mbulojnë aspekte të punësimit etj. Gjatë debatit mes pjesëmarrësve pati qëndrime të ndryshme, por e përbashkëta ishte se që prej fillimeve të demokracisë e në vijim, ka ardhur koha për veprime në sigurimin e lirisë së medias. Me vetëdijen se pa një gazetar të sigurtë në punë nuk mund të kemi media të lirë dhe pluraliste.

Partneriteti me organizata dhe institucione që punojnë në fushë e medias ka vijuar për të realizuar projekte që ndikojnë në përmirësimin e raportimit të redaksive audiovizive në aspekte të tilla si, mbrojtja e fëmijëve, barazia gjinore, Fake News, edukimi mediatik apo përshtatja e aplikacioneve të reja në redaksitë audiovizive. Risi në partneritetin e vitit 2018 ishte angazhimi për të pasuruar literaturën në gjuhën shqipe mbi median audiovizive, duke përkthyer tituj nga fondi i bibliografisë ndërkombëtare.

Për t’u theksuar për vitin e kaluar, ishte dhe bashkëpunimi me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Fakultetin e Histori- Filologjisë në Universitetin e Tiranës, që i ka filluar prej vitit 2015. Projekti “Oferta programore e transmetuesve televizivë shqiptarë” arriti të realizojë një studim dhe analizë shkencore mbi aspekte të ndryshme të përmbajtjeve që emetojnë subjektet audiovizive në Shqipëri dhe mbi bazën e tij organizoi një konferencë shkencore në fillim të muajit dhjetor, me pjesëmarrjen e pedagogëve, studiuesve dhe ekspertëve të fushës, doktorantëve të gazetarisë dhe komunikimit etj. Ky kombinim i produkteve u vlerësua si në favor të pasurimit të këndvështrimeve dhe analizave që bëjnë studiuesit, për të shikuar më tej se sa fotografia aktuale e situatës në transmetimet audiovizive, për prezantimin dhe të trendeve e prirjeve të tregut në të ardhmen e afërt dhe atë të largët.

Në kuadër të projektit “Oferta programore e transmetuesve televizivë shqiptarë” u krye dhe një sondim i publikut në terren, një kampion me 500 të pyetur, si dhe kryerja e intervistave cilësore. Të gjitha data-t e grumbulluara i janë nënshtruar një procesi përpunues për t’i bërë funksionale, si pjesë e studimit përfundimtar, ndarë me kapituj të veçantë, bazuar tek operatorët në fokus apo problematika me përmbajtjet e emetuara – një material që bashkë me kumtesat që u mbajtën nga studiuesit në konferencën shkencore, pritet të dalë si botim më vete nga Departamenti brenda gjashtëmujorit të parë të këtij viti, si një dosje për t’u shfletuar nga grupet e interesit, nga studentët dhe kërkuesit e fushës, nga subjekte dhe institucione vendase e të huaja etj.

Në përmbushje të kërkesave të ligjit dhe Kodit të Transmetimit të AMA-s, por edhe në zbatim të detyrave të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë vitin e kaluar, Këshilli i Ankesave ka trajtuar me seriozitet dhe përgjegjësi çdo ankesë, dhe pas vlerësimit ka adresuar rastet e shkeljeve tek OSHMA-të. Ankesat për vitin 2018 kanë qenë:

- 40% për shkelje të të drejtave të fëmijëve;
- 38% për shkelje të të drejtave të njeriut, normave ligjore dhe etike;
- 12% për komunikimet me natyrë tregtare;
- 10 % të tjera.

Në funksion të rritjes së efikasitetit të shqyrtimit të ankesave, në muajin maj u miratua edhe udhëzimi “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA)”, që përfshin dhe vetë subjektet audio dhe audiovizive në trajtimin e ankesave mbi përmbajtjet e transmetuara.

Këshilli i Ankesave ka organizuar disa konferenca dhe tryeza, me pjesëmarrjen dhe kontributin e figurave të njohura të jetës akademike, universitare, të medias, publikut dhe të shoqërisë civile. Këto konferenca trajtuan tema të rëndësishme, si mbrojtja e fëmijëve, edukimi për median dhe gjuha e urrejtjes. Por gjithashtu, anëtarët e Këshillit të Ankesave kanë qenë pjesëmarrës në tryeza të iniciuara nga organizata të ndryshme, shoqëria civile etj, ku janë diskutuar tema mbi lirinë e medias, përdorimin e gjuhës diskriminuese etj.

AMA e ka vlerësuar dhe vlerëson përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të veta institucionale duke u investuar shumë tek ndjekja e një plani të zhvillimit profesional të nëpunësit civil, duke pasur në fokus rritjen në cilësi dhe profesionalizëm të stafit, duke i dhënë prioritet procesit të kryerjes së trajnimeve dhe zhvillimit profesional të punonjësve.

Kualifikimet dhe trajnimet u bazuan në kalendarin e analizës së identifikimit të nevojave për trajnim, i cili synon një praktikë uniforme të përvitshme me qëllim zhvillimin e nëpunësve civil të administratës së AMA-s; ngritjen e kapaciteteve menaxhuese; rritjen e përgjegjshmërisë së punonjësve; krijimin e një trupe funksionarësh, profesioniste dhe eficiente në kryerjen e detyrave.

Sa i takon bashkëpunimit me institucionet e tjera, AMA ka ndërmarrë disa iniciativa për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me qëllim krijimin e hapësirave dhe lehtësimin e formave të koordinimit të punës. Këto marrëveshje vijnë gjithashtu në kuadër të kërkesës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë mbi krijimin e hapësirave dhe thellimin e formave të bashkëpunimit midis organeve të krijuara me ligj, sikurse janë institucionet e shtetit shqiptar. Gjatë vitit 2018, AMA ka mbajtur marrëdhënie shumë të mira dypalëshe me autoritetet rregullatore në rajon dhe më gjerë. Përfaqësuesit e AMA-s kanë mbajtur sistematikisht kontakte në kuadër të pjesëmarrjes së tyre në organizmat dhe platformat evropiane apo rajonale të medias audiovizive, si EPRA, ERGA, BRAF, MNRA etj.

Në rolin e rregullatorit të tregut audioviziv, AMA u investua gjatë vitit të kaluar tek plotësimi dhe rishikimi i një sërë aktesh nënligjore që ndikojnë drejtpërdrejt në dinamikën e tregut dhe performancën e OSHMA-ve, të tilla si:

- Rregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 41 datë 12.03.2018.
- Rregullore “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare. Format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e tyre”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 42, datë 19.03.2018.
- Rregullore “Mbi kriteret e ofrimit të shërbimeve të mbrojtura”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 68, datë 20.04.2018.
- Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e AMA-s, nr. 209, datë 16.09.2016 “Për miratimin e rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive” me vendimin e AMA-s nr. 120, datë 08.06.2018.
- Udhëzimi “Për format dhe kategoritë e programeve për regjistrim dhe arkivim nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA), miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 121, datë 08.06.2018.

AMA ka ndjekur standardin e tërheqjes së mendimeve, sugjerimeve dhe propozimeve nga ana e grupeve të interesit, duke zbatuar rigorizisht proceset e konsultimi dhe këshillimit publik, prej të cilave përmirëson draftet e paraqitura.

- Gjatë vitit 2018, në ndryshim nga vitet e kaluara, duke pasur parasysh zhvillimet teknologjike dhe përhapjen në shkallë të gjerë e internetit, AMA është investuar dhe tek lufta kundër piraterisë televizive së kryer përmes faqeve dhe portaleve online. Ky angazhim do të vijojë, bazuar në planifikimin e një agjende që verifikon dhe vlerëson raste të piraterisë, në kooperim dhe me AKEP-in, si dhe institucione të tjera që kanë këtë fokus.
- Si një institucion me vetëfinancim, Autoriteti krijon dhe siguron me burimet e veta financiare përmbushjen e objektivave dhe funksioneve, bazuar në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore të miratuara që janë fuqi. Realizimi i burimeve të vetëfinancimit dhe rritja e efektivitetit të shfrytëzimit të tyre sipas projektbuxhetit të vitit 2018, ka qenë një ndër objektivat e realizuara të strategjisë së AMA-s dhe Planit të saj të Veprimit 3-vjeçar 2017-2019.

Gjithashtu, në përmbushje detyrave të Rezolutës së vitit të kaluar të Kuvendit të Shqipërisë, është evidente rritja e arkëtueshmërisë së të ardhurave duke ndjekur kryerjen e pagesave prej subjekteve të licencuara/autorizuara për detyrimet financiare të lindura nga AMA në vitin 2018. Institucioni, gjatë vitit raportues, ka ndjekur procedurat me organet gjyqësore për vjeljen e detyrime financiare të bartura ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit nga subjektet për periudhën 2015-2018.



## 1 STRATEGJIA AUTORITETIT

Autoriteti i Mediave Audiovizive, gjatë vitit 2018 është përpjekur të realizojë angazhimet dhe objektivat kryesorë që lidhen me ecurinë e institucionit, si dhe zbatimin e kuadrit ligjor. AMA, me vendimin nr. 28, datë 29.03.2017 ka miratuar “Strategjinë e Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Planin e Veprimit”, ku janë parashikuar qëllimet kryesore dhe aktivitetet në përmbushje të objektivave të AMA-s. Planin e Veprimit parashikon aktivitetet që duhet të ndërmerret AMA për periudhën 2017-2019.

Në kuadër të sigurimit të diversitetit dhe pluralizmit dhe promovimit të transmetimit të përgjegjshëm për të përmirësuar përmbajtjet audio dhe audiovizive:

- përmirësimi legjislativ (Rregullorja mbi kriteret e ofrimit të shërbimeve të mbrojtura; rregullorja për monitorimin e spektrit të frekuencave; rregullorja e reklamave dhe komunikimeve tregtare; udhëzimi për format dhe kategoritë e programeve për regjistrim dhe arkivim nga OSHMA-të);
- shqyrtimet tematike për probleme sensitive të përmbajtjeve të emetuara (mbrojtja e fëmijëve në transmetimet audiovizive; reklamat dhe komunikimet tregtare; programet audiovizive me karakter informimin mbi shëndetin dhe përdorimin e medikamenteve; respektimi i standardeve të shqipes së folur dhe të shkruar; përmbajtjet e dëmshme me dhunë, pornografi apo përdorim të substancave narkotike në kanalet e profilit muzikor etj.);
- organizimi i forumeve me OSHMA-te për tema të caktuara (respektimi i standardeve të shqipes në median audiovizive, gjuha e urrejtjes në median audiovizive);
- bashkëpunimi me partnerët për trajnimet me redaksitë audiovizive, studimet e tregut audioviziv, publikime të literaturës së fushës audiovizive (në aspekte të tilla si, mbrojtja e fëmijëve, barazia gjinore, fake news, edukimi mediatik apo përshtatja e aplikacioneve të reja në redaksitë audiovizive);
- ka vijuar publikimi i Buletinit Periodik të AMA-s, një fluks të dhënash nga performanca e OSHMA-ve. Mbledhja, administrimi dhe publikimi i informacionit për sektorin e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë, si një nga funksionet kryesore që i atribuohen AMA-s me ligj, ishte një nga shtysat kryesore për fillimin e botimit në mënyrë periodike të këtij Buletini për t’u prezantuar të gjithë grupeve të interesit tregues nga performanca e ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv, OSHMA-ve, përfshirë të dhënat mbi pronësinë, të ardhurat nga reklamat, punësimi, etj.

Gjatë vitit 2018, duke mbajtur në konsideratë edhe rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të procesit të transparencës dhe llogaridhënies, AMA ka realizuar dy vlerësime mbi dinamikën e procesit të ndërtimit të buqetës me programet e vetë RTSH-së, bazuar në kërkesat e Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Hapat e ndërmarra në lidhje me përfundimin e qeverisjes dhe zhvillimin e organizatës janë shtjelluar në mënyrë të hollësishme në pikën 12.8 të këtij raporti “Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore” dhe 12.9 “Rritja e kapaciteteve komunikuese dhe përpunuese në fushën e Teknologjisë së Informacionit”.

## **2 ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NË REZOLUTËN E KUVENDIT PËR RAPORTIN VJETOR TË AUTORITETIT PËR VITIN 2018**

### **1) Miratimin e rregulloreve të ndryshme, sipas Planit Strategjik të Veprimit, me qëllim plotësimin e kuadrit nënligjor dhe përmirësimin e zbatueshmërisë së ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.**

AMA, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Strategjisë dhe Planit të Veprimit për 2017-2019 të Autoritetit të Mediave Audiovizive gjatë vitit 2018, ka hartuar dhe miratuar aktet e mëposhtme nënligjore:

- Rregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 41 datë 12.03.2018.
- Rregullore “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare. Format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e tyre”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 42, datë 19.03.2018.
- Rregullore “Mbi kriteret e ofrimit të shërbimeve të mbrojtura”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 68, datë 20.04.2018.
- Disa ndryshime në vendimin e AMA-s, nr. 209, datë 16.09.2016 “Për miratimin e rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive” me vendimin e AMA-s nr. 120, datë 08.06.2018.
- Udhëzimi “Për format dhe kategoritë e programeve për regjistrim dhe arkivim nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA), miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 121, datë 08.06.2018.

### **2) Vijimin e shqyrtimeve tematike mbi përmbajtjet e transmetuara nga OSHMA-të, duke garantuar respektimin e ligjit dhe Kodit të Transmetimit për reklamat dhe komunikimet tregtare, respektimin e standardit të shqipes së folur dhe të shkruar, si dhe mbrojtjen e fëmijëve në transmetimet audiovizive.**

Gjatë vitit 2018 kanë vijuar shqyrtimet tematike, të cilat konkretisht janë përqendruar te mbrojtja e fëmijëve në transmetimet audiovizive; reklamat dhe komunikimet tregtare; programet audiovizive me karakter informimin mbi shëndetin dhe përdorimin e medikamenteve; respektimi i standardeve të shqipes së folur dhe të shkruar; përmbajtjet e dëmshme me dhunë, pornografi apo përdorim të substancave narkotike në kanalet e profilit muzikor. Këto tematika janë vlerësuar në segmente të ndryshme të tregut, në OSHMA-të kombëtare që kanë dhe impakt të madh në publik, por dhe në subjektet rajonale a lokale, duke e kombinuar shqyrtimin edhe me emisione të veçanta, edicione informative etj. Më gjerësisht për këtë aspekt tregohet në pikën 7.1 të këtij raporti.

### **3) Vijimin e monitorimit të zbatimit të kontratës së shërbimit me RTSH-në, sipas kërkesave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.**

Gjatë vitit 2018 AMA ka realizuar dy vlerësime mbi dinamikën e zbatimit të procesit të ndërtimit të buqetës me programet e vetë RTSH-së, të cilat janë vijim i zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, por dhe në Kontratën e Shërbimit të Transmetimit Publik, miratuar nga AMA me vendim 18, datë 02.03.2017. Monitorimet kanë shqyrtuar programacionin e kanaleve, duke evidentuar elementë të strukturimit të tyre, përputhshmërisë me angazhimin që ka marrë RTSH në Kontratë, duke

shënuar ato kërkesa që mbeten për t'u plotësuar nga oferta përmbajtësore e Transmetuesit Publik. Paralelisht me këtë vlerësim kryhet dhe monitorimi për nivelin e përhapjes së sinjalit të RTSH-së, një element shumë i rëndësishëm për shërbimin që ofrohet për familjet në të gjithë territorin e vendit. Për të dy vlerësimet informacioni me gjetjet dhe problematikat u është dërguar drejtuesve të RTSH-së dhe Këshillit Drejtues të këtij institucioni. Më gjerësisht për këtë aspekt tregohet në pikën 11.3 të këtij raporti.

Për sa i përket kanaleve të platformës së RTSH, AMA ka mbajtur vazhdimisht në monitorim çeljen e kanaleve të reja. Aktualisht, RTSH numëron 13 kanale prodhime të veta, të cilat i transmeton në rrjetin numerik të saj:

1. RTSH 1 HD
2. RTSH 2 HD
3. RTSH 3 HD
4. RTSH PLUS
5. RTSH FËMIJË
6. RTSH 24
7. RTSH KUVEND
8. RTSH FILM
9. RTSH SPORT
10. RTSH SHQIP
11. RTSH MUZIKË
12. RTSH KORÇA
13. RTSH GJIROKASTRA

**4) Përfundimin e procesit të digjitalizimit në allotmenin Tiranë-Durrës, si dhe në dy allotmenë të tjerë brenda vitit 2018, duke bërë të mundur realizimin e procesit të digjitalizimit në nivelin 80 për qind të popullsisë.**

Lidhur me përfundimin e procesit të digjitalizimit në qarqet Tiranë, Durrës, dy qarqe ku është përqëndruar dhe popullsia më madhe e vendit, AMA ka ndërmarrë një sërë aktiviteteve koordinuese me operatorët audiovizivë në treg, si dhe me të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë. Si rezultat i aktiviteteve të ndërmarra dhe, bazuar në rekomandimet e Kuvendit dhe rekomandimet e Komisionit Evropian, AMA përcaktoi si afat përfundimtar për mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë, Durrës datën 31 korrik 2018.

Ndërkohë më datë 24 korrik 2018, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik (KEMIP), nisur nga ankesat e paraqitura nga operatorët vendorë lidhur me vështirësitë e hasura në procesin e digjitalizimit, organizoi një takim me përfaqësues të AMA-s, operatorit publik RTSH-së, Shoqatës së Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë Valorë, si dhe operatorëve audiovizivë privat lokalë/ rajonalë. Një ndër kërkesat e operatorëve vendorë ishte edhe shtyrja e afatit për mbylljen e transmetimeve analoge në Tiranë dhe Durrës deri në fund të vitit 2018.

Sikurse u përmend më sipër, duke marrë parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian dhe Parlamentit Shqiptar lidhur me finalizimin e procesit të digjitalizimit, si dhe duke vlerësuar që problemet e ngritura nga operatorët vendorë nuk përbënin shkak për shtyrjen e afatit pasi ato mund të trajtoheshin paralelisht me zhvillimin e këtij procesi, AMA vendosi të shtyjë afatin deri më 10 shtator 2018. Theksojmë se gjetja e zgjidhjeve të problematikave të ngritura nga operatorët audiovizivë kërkonte përfshirjen e të gjithë palëve në këtë proces dhe kohë të konsiderueshme, e cila përkthehet në vonesë të finalizimit të procesit të digjitalizimit.

Referuar afatit të përcaktuar nga AMA, më 10 shtator transmetimet analoge u mbyllën në qarqet Tiranë dhe Durrës. Me mbylljen e transmetimeve analoge u krijua një situatë e vështirë për qytetarët shqiptarë, u identifikuan radhë të gjata në pikat e shitjeve të dekoderave dhe paqartësi lidhur me teknologjinë e dekoderave. Gjithashtu u konstatua rritje e konsiderueshme e telefonatave drejt dy numrave në Call Center-in e AMA-s dhe numër i madh mesazhesh/pyetjeve drejt faqes zyrtare të AMA-së dhe në adresën info@ama.gov.al.

Përsa më sipër, duke e konsideruar këtë një situatë jonormale dhe për të krijuar kushte sa më lehtësuese për qytetarët, AMA vendosi të shtyjë afatin deri më 15 janar 2019.

Vlen për t'u theksuar se me mbylljen e transmetimet analoge në qarqet Tiranë dhe Durrës u realizua edhe mbyllja e të gjithë transmetimeve të paligjshme në vendin tonë që ofroreshin përmes teknologjisë DVB-T, si dhe kalimi i plotë në teknologjinë DVB-T2. Kjo është mundësuar në bashkëpunim të ngushtë me operatorët në treg, të cilët janë angazhuar maksimalisht në zëvendësimin e pajisjeve të përdoruesve apo rikonfigurimin e tyre

Kjo ishte një situatë e paparashikueshme për AMA-n duke menduar se fushata e informimit ka filluar që në prill të vitit 2016 në forma nga më të ndryshmet të tilla si broshura, fletëpalosje, reklama, njoftime publike, ngritja e strukturës Call Center (2 numra telefoni), duke iu përgjigjur pyetjeve të publikut në faqen sociale të AMA-së në facebook si dhe në info@ama.gov.al. Gjithashtu, AMA kishte realizuar me sukses mbylljen e transmetimeve analoge në tre qarqe të tjera të vendit, përkatësisht Berat, Korçë dhe Fier.

Mbajtur parasysh situatën e krijuar në datën 10 shtator 2018, AMA me shkresën e datës 04 janar 2019, kërkoi prej disa operatorëve tregtarë informacion mbi numrin e aparatëve televizivë dhe dekoderave të sistemit DVB-T2, të importuar gjatë 3 mujorit të fundit të vitit 2018 dhe numrin gjendje të tyre. Informacioni i është kërkuar edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Duke konsideruar se në qarqet Tiranë dhe Durrës është përqendruar numri më i madh i banorëve, si dhe bazuar në të dhënat e ardhura nga operatorët ekonomikë tregtarë dhe Drejtoria së Përgjithshme të Doganave, u evidentua se **ende nuk është siguruar sasia e mjaftueshme e dekoderave të tipit DVB-T2.**

Gjithashtu, Autoriteti i Konkurrencës, referuar situatës së krijuar më datë 10 shtator 2018, pasi ka monitoruar tregun në disa pika tregtimi të pajisjeve dekoder, ka arritur në përfundimin se kjo situatë ka ardhur si pasojë e mungesës së informimit të publikut për mundësitë që ofronte tregu i pajisjeve elektronike për përmbushjen e kërkesave të tyre. Ky Autoritet, me vendimin nr. 547, datë 24.09.2018 "Për dhënien e rekomandimeve për rritjen e konkurrencës gjatë procesit për dixhitalizimin e transmetimeve audiovizive", ka rekomanduar që AMA të rritë sensibilizimin ndaj opinionit publik, nëpërmjet fushatave informuese duke informuar publikun se tregu i shitjes së dekoderëve DVB-T2 është treg i hapur dhe këto dekoderë mund të sigurohen në çdo pikë shitje të pajisjeve elektronike.

Në këto kushte, bazuar edhe në vendimin e Autoritetit të Konkurrencës, të sipërcituar, me qëllim që kalimi nga transmetimet analoge në ato numerike për qarkun e Tiranës dhe Durrësit, ku banojnë rreth 1/3 e popullatës së Shqipërisë, të realizohet në mënyrë sa më efikase, duke shmangur problematikat e hasura deri tani, me qëllim që qytetarët të kuptojnë sa më mirë informacionin dhe detajet e nevojshme, në mënyrë të veçantë ato teknike, që prekin drejtpërdrejt përdorimin e pajisjeve apo aksesorëve shtëpiakë të nevojshëm për të mundësuar marrjen e sinjalit numerik dhe eventualisht shikimin e kanaleve dixhitale, AMA për përmirësimin e fushatës informuese për publikun, angazhoi një ekspert të jashtëm për

ndryshimin e përmbajtjes së spoteve informuese, njoftimeve, zgjerimin e kanaleve të komunikimit etj., në mënyrë që procesi i mbylljes së programeve (kanaleve) analoge dhe kalimi në transmetimet numerike të jetë sa më i qartë dhe i kuptueshëm për qytetarët.

Përsa më sipër, bazuar në vendimin e Autoritetit të Konkurrencës dhe në Strategjinë e Komunikimit për fushatën e kalimit në transmetimet numerike të hartuar nga eksperti i kontraktuar, fushata e informimit të publikut është ndryshuar dhe diversifikuar duke realizuar gjashtë spote të reja me karakter informativ, të cilat përthithen më thjeshtë nga publiku dhe synohet qasja sa më afër publikut, me gjuhë të thjeshtë, ilustrime praktike, imazhe mbi teknologjinë që duhet përdorur, me grupmosha të caktuara fëmijë/të rritur dhe aktorë. Këto spote do të transmetohen vazhdimisht në televizionet kombëtare dhe lokale, në portalet kryesore në vend, në faqen zyrtare të AMA-s dhe në rrjetin social të AMA-s.

Në vijim të kësaj fushate, AMA ka planifikuar edhe zhvillimin e një fushate “*outdoor*”, i cili cilësohet si një medium i rëndësishëm komunikimi në aspektin e informimit të qytetarëve, siç janë përdorimi i hapësirave të reklamimit/vizibilitetit të jashtëm përmes përdorimit të platformarve “*Billboard*” dhe “*City lights*”. Ato do të vendosen në qarqet ku ende nuk është mbyllur procesi i digjitalizimit, me qëllim për t’i informuar mbi afatin e kalimit në transmetimet analoge në qarkun përkatës si dhe paraqitjen e kontakteve ku qytetarët mund të drejtohen për të marrë informacion më të detajuar dhe praktik mbi procesin.

Duke patur parasysh se në pamundësi të sigurimit të dekoderave në treg, si dhe synimin e përmirësimit të fushatës së informimit për publikut, me qëllim që procesi të vijojë pa ndërprerje sinjali audioviziv për publikun e gjerë, dhe të mos përsëritet situata e shtatorit 2018, AMA ka shtyrë afatin e mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Tiranë dhe Durrës deri më datë 1 shtator 2019. Brenda këtij afati do të mbyllen transmetimet analoge edhe në qarkun e Vlorës.

Ndërkohë sqarojmë se, për familjet tashmë të pajisura me dekodera, vijojnë transmetimet digjitale tokësore, që sigurojnë cilësi të lartë dhe një numër më të madh programesh televizive pa pagesë.

Gjithashtu, bëjmë me dije se AMA do të vijojë fushatën e informimit të qytetarëve deri në mbylljen e plotë të procesit të digjitalizimit në të gjithë vendin.

Lidhur me procesin e digjitalizimit informojmë se aktualisht nuk janë funksionale strukturat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012 “Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike”, për ndjekjen e implementimit të këtij procesi. Konkretisht, Komiteti Ndërinstitucional i ngritur me Urdhrin nr. 144 të Kryeministrit, datë 7.4.2014, për ndjekjen e zbatimit të Strategjisë për kalimin në transmetimet numerike si dhe Sekretariati Teknik, strukturë mbështetëse e Komitetit Ndërinstitucional nuk janë funksionalë që nga shtatori i vitit 2017. Në këto kushte AMA duke bashkëpunuar ngushtë me operatorët audivizivë në treg, si dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe rekomandimeve të Kuvendit, ka marrë vendime mbi ecurinë e këtij procesi sikurse vendimet lidhur me përcaktimin e qarkut vijues si dhe afateve kur do të mbyllen transmetimet analoge, si dhe çështje të tjera.

Gjithashtu, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 3.6.2015 “Për miratimin e rregullave teknike për aparatet marrëse televizive, që do të vendosen në treg”, janë përcaktuar strukturat përgjegjëse lidhur me tipin e dekoderave të hedhur në tregun shqiptar, sqarojmë këtu se ndër këto struktura është edhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila ka detyrimin që të mos lejojë hyrjen e dekoderave të ndryshëm nga ato të përcaktuar në VKM 480 (tipi i dekoderave që duhet të jenë në treg është DVB-T2/MPEG-4).

## **5) Garantimin e vijmësisë së transmetimeve audiovizive gjatë dhe pas periudhës tranzitore të kalimit në transmetime digjitale.**

Legjislacioni që normon procesin e kalimit në transmetimet numerike parashikon që kalimi në transmetimet numerike duhet realizuar pa prishur strukturën ekzistuese të tregut mediatik. Me qëllim garantimin e objektivave për shumëllojshmërinë e mediave dhe sigurimin e vazhdimësisë të ofrimit të shërbimit audioviziv të subjekteve edhe pas kalimit në transmetimet digjitale, AMA ka kërkuar vazhdimisht prej operatorëve ekzistues marrjen e masave për lidhjen e kontratave për mbështetjen në rrjetin numerik të operatorit publik, apo operatorëve të tjerë të licencuar për transmetime numerike.

Aktualisht janë depozituar kontratat e nënshkruara me RTSH nga 18 (tetëmbëdhjetë) operatorë audiovizivë.

Subjektet audiovizive që mbështesin programin e tyre në rrjetin e RTSH-së pretendojnë se tarifat e miratuara për mbështetje në rrjetin numerik të RTSH-së janë të pabazuara në kostot reale të RTSH-së dhe kanë kërkuar rishikimin e tyre, duke theksuar se janë në pamundësi financiare për shlyerjen e detyrimeve kundrejt RTSH-së.

Nga ana tjetër, për të siguruar vazhdimësinë e marrjes nga publiku të të gjithë programeve televizive, por edhe në mbështetje të operatorëve privatë analogë ekzistues, me ligjin nr. 34/2017 “Për Lirimin e Frekuencave të Dixhital Dividentit”, të ndryshuar, parashikohet që, gjatë vitit të parë operatorëve ekzistues lokalë/rajonale për vijimin e ofrimit të shërbimit mediatik audioviziv do t’u jepet kompensim financiar për kalimin nga transmetimet analoge në transmetimet numerike. Ky ligj nuk ka nisur ende të zbatohet, pasi është i lidhur me tenderin për dhënien në përdorim të Dividentit Numerik 1, që organizohet prej Autoritetit të Komunikimeve Elektronike Postare.

Pavarësisht problematikave të cituara më lart, AMA ka garantuar vijueshmërinë e transmetimeve televizive edhe pas kalimit në transmetimet numerike.

Në këtë kuadër janë kryer monitorime intensive në të gjithë Shqipërinë. Monitorime më të shpeshta janë kryer në zonat ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit:

- Allotmenti Berat
- Allotmenti Korçë
- Allotmenti Fier

Fokusi i monitorimeve në këto zona ka qenë verifikimi i mbylljes së transmetimeve analoge, mbartja e operatoreve lokale/rajonale në rrjetet kombëtare dhe përmbushja e kërkesave/kushteve të licencës nga operatorët kombëtar numerik (realizimi i mbulimit të territorit me sinjal numerik, cilësia e sinjalit, respektimi i numrit logjik të programit etj.).

Gjatë gjithë periudhës tranzitore të digjitalizimit të plotë të këtyre allotmenteve, AMA siguroi transmetimin njëkohësisht, edhe analog edhe digjital, deri në ditën e mbylljes së transmetimeve analoge.

Përmes grupeve të monitorimit, AMA ka ndjekur me vëmendje edhe procesin e pajisjes me dekodera DVBT2 të banorëve në këto zona. Përmes shërbimit të *call center* të vënë në dispozicion, banorët e këtyre zonave kanë mundur dhe vijnë të informohen në kohë, mbi

pajisjet dhe pikat e transmetimit se nga duhej të kthejnë antenat e tyre për të siguruar marrjen e sinjalit digjital.

Aktualisht, AMA, vijon të monitorojë transmetimet, si analoge ashtu edhe digjitale, edhe në zonat e tjera të vendit, në mënyrë të veçantë në qarqet Tiranë, Durrës dhe Vlorë. Aktualisht, në këto qarqe operatorët e licencuar, përveç transmetimeve në rrjetet numerike, sipas përcaktimeve ligjore, vijojnë edhe me transmetimet analoge.

**6) Vijimin në monitorimin e mbulimit të territorit dhe të cilësisë së sinjaleve të RTSH-së dhe operatorëve kombëtarë të licencuar për transmetimet numerike, si dhe monitorimin e transmetimeve analoge të RTSH-së deri në mbylljen e tyre.**

AMA vazhdon të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme mbulimin e territorit dhe cilësisë së sinjaleve të RTSH-së dhe operatorëve kombëtarë të licencuar për transmetime numerike, si dhe monitorimin e transmetimeve analoge të RTSH-së.

Nga monitorimet e kyera në qarqet Berat, Korçë, Fier ku tashmë janë mbyllur transmetimet analoge, respektivisht më 15 gusht 2017, 8 janar 2018 dhe 31 mars 2018, ka rezultuar se RTSH dhe operatorët privatë kombëtarë numerike nuk mbulojnë me sinjal numerik zona të caktuara si më poshtë:

**1. Subjekti RTSH nuk mbulon me sinjal numerik zonat si më poshtë:**

**• Allotmenti Berat**

- *Lagjet mbas kalasë së Beratit*
- *Njësia administrative Roshnik*
- *Njësia administrative Sinjë*
- *Njësia administrative Potom*
- *Njësia administrative Çepan*

**- Allotmenti Korçë**

- *Njësia administrative Voskopojë*
- *Njësia administrative Dardhë*
- *Njësia administrative Çërravë*
- *Njësia administrative Gorë*
- *Njësia administrative Barmash*

**2. Subjektet private kombëtare TV “Top-Channel”, TV “Vizion +”, Digjitalb dhe ADTN nuk i kanë të ndezur të gjithë transmetuesit, për rrjedhojë disa zona mbeten të pambuluara me sinjal audioviziv. Konkretisht :**

**- Në qarkun Berat nuk mbulohet nga sinjali i TV “Top Channel”, TV “Klan”, “Digjitalb”, TV “Vizion +”, dhe “ADTN-së.**

- *Njësia administrative Kuçovë*
- *Njësia administrative Poliçan*
- *Njësia administrative Çorovodë*

- Në qarkun Fier nuk mbulohet nga sinjali i TV “Top Channel”, “Digjitalb, TV “Vizion +” dhe “ADTN”-së.
  - Pjesërisht Bashkia Divjakë
- Në qarkun Korçë nuk mbulohet nga sinjali i TV “Top Channel”, TV“Klan” “Digjitalb”, TV Vizion + dhe ADTN-së.
  - Njësia administrative Ersekë
  - Njësia administrative Leskovik
  - Njësia administrative Voskopojë
  - Njësia administrative Dardhë
  - Njësia administrative Çërravë
  - Njësia administrative Mokër

Sa më sipër, AMA ka bashkëpunuar ngushtë dhe vijon bashkëpunimin me operatorët numerikë dhe në mënyrë të veçantë me operatorin publik shqiptar (RTSH) për të gjetur zgjidhjet e duhura dhe të shpejta për realizimin e mbulimit të plotë të këtyre qarqeve me transmetime numerike.

Gjithashtu, rëndësi të veçantë u është dhënë monitorimeve në qarqet Tiranë dhe Durrës, për të cilët ishte parashikuar të mbylleshin transmetimet analoge më datë 10 shtator 2018. Në këtë datë u bë e mundur mbyllja e të gjithë transmetimeve analoge dhe çfarë vlen për t’u theksuar, në këtë datë janë mbyllur edhe të gjithë transmetimet numerike të paligjshme.

Për sa u përket transmetimeve **analoge të RTSH-së**, gjatë monitorimeve në zonat ku nuk është finalizuar procesi, janë konstatuar zona që nuk mbulohen me sinjal. Konkretisht,

- Njësitë administrative Qukës, Gramsh, Prrenjas (Kotodesh), Labinot, Lunik Kostenjë e Drenovicë, Orenjë dhe Steblevë të qarkut Elbasan
- Njësitë administrative Selenicë, Qeparo, Borsh dhe Lukovë të qarkut Vlorë
- Njësia administrative Këlcyrë e qarkut Gjirokastrë
- Njësitë administrative Vau i Dejës, Razëm të qarkut Shkodër
- Njësitë administrative Maqellarë, Sllovë, Kalaja e Dodës, Kalis të qarkut Dibër
- Njësitë administrative Krujë, Cudhi, Maminas dhe Lagjet pas Vilës së Zogut në qarkun Durrës

Në lidhje me konstatimet e mësipërme, me operatorin publik shqiptar (RTSH) ka pasur korrespondenca të njëpasnjëshme. Edhe pas korrespondencave tona, situata lidhur me transmetimet analoge nuk ka ndryshuar plotësisht, pasi RTSH ngre pretendimin se janë duke investuar për të kaluar në transmetimet numerike dhe nuk mund të bëjnë shpenzime dyfishe edhe për transmetimet analoge. Përsa u përket transmetimeve numerike të subjektit RTSH, nga monitorimet e kryera është konstatuar gjithashtu se subjekti RTSH, krahas zonave ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit ka ndezur transmetuesit e tij edhe në zona të tjera të vendit. Konkretisht, RTSH mbulon me sinjal numerik qarqet Tiranë-Durrës, Shkodër, Pukë, Dibër, Kukës, Vlorë, Gjirokastrë, Tepelenë, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Burrel dhe Lezhë.



**7) Përmirësimin e mbikëqyrjes në identifikimin e interferencave që vijnë nga vendet fqinje dhe atyre të shkaktuara nga pikat transmetuese në territorin e Shqipërisë, si dhe marrjen e masave për eliminimin e tyre.**

Në kuadër të mbikëqyrjes/monitorimit të interferencave me vendet fqinje, AMA ka intensifikuar monitorimet në zonat kufitare. Konkretisht, janë kryer matje periodike në zonën e Shkodrës, Durrësit, Korçës, Himarës, Sarandës dhe Pogradecit. Nga monitorimet e kryera nuk janë identifikuar interferenca të dëmshme drejt stacioneve tona transmetuese.

Sa u takon ndërhyrjeve të shkaktuara nga operatorët audio/audiovizivë shqiptar drejt operatorëve të vendeve fqinje, informojmë se gjatë vitit 2017 problematikë e ndjeshme ka qenë interferenca shkaktuar drejt Malit të Zi në brezin 790-862 MHz (DD1). AMA ka organizuar aktivitete të përbashkëta koordinimi dhe monitorimi me vendin fqinj, me ekspertë të përbashkët, si dhe ka patur korrespondenca të vazhdueshme midis palëve, për zgjidhjen sa më të shpejtë të tyre. Gjithashtu, për të shmangur interferencat e dëmshme, në hartimin e planit për lirim të brezit DD1, AMA ka vendosur si prioritet lirim të tij në zonat kufitare.

Në sajë të aktiviteteve të ndërmarra, problemi i ndërhyrjeve është zgjidhur përfundimisht.

Gjithashtu, në tetor 2018 u paraqit një ankesë nga Radio “Elita”, e cila operon në Malin e Zi, për ndërhyrje nga sinjale audio shqiptare. AMA vendosi menjëherë korrespondencë me operatorin shqiptar duke i kërkuar shmangien e interferencës së shkaktuar dhe operatori menjëherë ka eliminuar këtë interferencë.

**8) Vijimin e monitorimit dhe forcimit të luftës kundër fenomenit të piraterisë, duke shtuar koordinimin me AKEP-in dhe institucione të tjera ligjzbatuese kundër luftës së formave të reja të piraterisë nëpërmjet internetit.**

Në mënyrë të veçantë, në 6-mujorin e dytë të periudhës së raportimit, AMA është fokusuar në luftën kundër piraterisë që kryhet përmes internetit. Duke pasur parasysh ndryshimet e vazhdueshme teknologjike dhe shtimin e formave të reja të piraterisë në rrjetin e internetit, përmes portaleve, faqeve apo aplikacioneve të ndryshme on line, AMA ka zhvilluar disa takime, pranë ambienteve të saj, me përfaqësues të AKEP, si institucioni kryesor që autorizon dhe monitoron aktivitetet në rrjetin e internetit, por edhe me përfaqësues të palëve të interesuara, prodhues dhe përdorues të produkteve dhe të drejtave televizive, si Digitalb, Tring, Albtelecom dhe ABCOM.

Me fokus në kërkesat dhe shqetësimet e operatorëve në fjalë, AMA dhe AKEP nisën punën për hartimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi, me qëllim përcaktimin e procedurave dhe krijimin e një marrëdhënie bashkëpunimi konstante dhe intensive, e cila do të ishte përtej bashkëpunimit të zakonshëm ndër-institucional. Por pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të AMA-s, AKEP e shprehu gatishmërinë e vet për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje vetëm në janar 2019, por edhe kësaj here, ndryshimet dhe sugjerimet e AKEP mbi mënyrën e zbatimit të marrëveshjes e bënë atë të pazbatueshme dhe joefikase për qëllimin e dakordësuar më parë nëpër takimet e zhvilluara.

Pavarësisht kësaj, nisur edhe nga rekomandimet e Kuvendit, AMA ka bërë verifikimin e çdo ankese të ardhur pranë saj nga subjektet e interesuara (Tring, Digitalb, ABCOM dhe Albtelecom), duke përcjellë më pas në AKEP kërkesat për mbylljen e të paktën 150 ofruesve të shërbimit internet, përmes të cilëve ushtrohej aktivitet audioviziv pirat, i paautorizuar.

Komunikimi me AKEP për ndalimin e piraterisë online ka nisur që në maj, për t'u intensifikuar më pas në muajt nëntor-dhjetor, kur janë dërguar 5 kërkesa për ndalim të piraterisë online, të kryer nga ofrues të shërbimit audioviziv në internet.

Duhet theksuar se AKEP në asnjë rast nuk ka kthyer përgjigje konkrete mbi masat konkrete të marra, por nga verifikimet e mëpasshme të kryera nga specialistët e AMA-s, është konstatuar mbyllja e ofruesve të shërbimit audioviziv në internet, përmes të cilëve ushtrohej aktivitet pirat, i paautorizuar.

Njëkohësisht, përmes grupeve të inspektimit, AMA ka bërë vetë verifikimin dhe identifikimin e aktiviteteve audiovizive të paligjshme, që kryheshin përmes internetit nga subjekte ISP. Gjatë periudhës së raportimit janë proceduar:

- 4 subjekte iptv të paligjshëm me dënim me gjobë prej 5.000.000 lekë secili;
- 1 subjekt iptv/ott të paligjshëm me sekuestrim pajisjesh audiovizive.

Për ofrimin e shërbimit të aksesit në internet, AMA i ka kërkuar AKEP krijimin e grupeve të përbashkëta kontrolli, me qëllim verifikimin e aktiviteteve të tyre dhe, eventualisht, identifikimin e piraterisë televizive të ushtruar përmes këtyre rrjeteve. Për këtë, AKEP ka shprehur gatishmërinë e vet dhe bashkëpunimi ka filluar të konkretizohet prej muajit shkurt 2019, me kontrolle të përbashkëta.

Për vitin 2019 AMA parashikon të forcojë akoma edhe më shumë luftën kundër këtij fenomeni, duke planifikuar kontrolle të vazhdueshme në të gjithë territorin e vendit, në bashkëpunim me AKEP, por edhe me institucionet e tjera, të Policisë së Shtetit etj.

**9) Vijimin e ndjekjes së realizimit të detyrimeve financiare të subjekteve debitoare të licencuara/autorizuara të vitit 2018 dhe atyre të viteve 2015-2017, si dhe të subjekteve që u është hequr licenca/autorizimi apo u është bërë e pavlefshme, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të pritshme të institucionit, duke realizuar shpenzimet dhe investimet për vitin 2018, në përputhje me objektivat e institucionit.**

Bazuar në ligjin nr. 97/2013, i ndryshuar, Strategjinë dhe Planin e Veprimit për vitet 2017-2019, Vendimit të AMA-s, nr.220, datë datë 01.12.2017 *“Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/ autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”*, AMA vijoi ndjekjen e realizimit të detyrimeve financiare të subjekteve të licencuara/autorizuara gjatë vitit 2018, përmes rrugës shkresore, postës elektronike dhe komunikimit telefonik.

Ndaj subjekteve audio/audiovizivë, licenca/autorizimi i të cilëve është bërë i pavlefshëm si pasojë e vendimmarrjeve së autoritetit rregullator (heqje apo konstatim pavlefshmërie në vitet 2015-2018), dhe që kanë rezultuar debitorë ndaj AMA-s, në rastin e subjekteve të pajisur me autorizim, apo ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit, në rastin e subjekteve të pajisur me licencë, AMA ka vijuar me investimin e organeve gjyqësore për të bërë të mundur vjeljen e këtyre detyrimeve financiare.

Pas përfundimit të proceseve gjyqësore, AMA ka proceduar me lidhjen e kontratave më subjektet private përmbartimore për ekzekutimin e titujve ekzekutivë. Deri në fund të vitit 2018, AMA ka lidhur kontrata për vjeljen e detyrimeve financiare për 17 subjekte audio/audiovizivë.

Nga ana tjetër, pranë gjykatave kompetente vijon shqyrtimi i 10 proceseve gjyqësore me objekt shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj AMA-s dhe/ose Buxhetit të Shtetit.

**10) Rritjen e efijencës në shqyrtimin e ankesave të ardhura nga qytetarët dhe institucionet për shkelje të parimeve të mbrojtjes së interesit publik, respektimit të dinjitetit të individëve dhe rregullave që parashikohen në Kodin e Transmetimit, shtimin e organizimit të tryezave tematike, si dhe dëgjësive me grupe të ndryshme interesi për njohjen me përmbajtjen e Kodit të Transmetimit dhe ndërgjegjësimin e respektimit të tij.**

Në përmbushje të kësaj detyre, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) ka organizuar disa tryeza tematike, konferenca dhe takime rreth Kodit të Transmetimit, si dhe ka hartuar një dokument të rëndësishëm, siç është Rregullorja “Mbi procedurat për trajtimin e ankesave dhe për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes”, shoqëruar me udhëzimin “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA)”.

Nga ana tjetër, Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar me rigorozitet, profesionalizëm dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara rreth 50 ankesa të adresuara nga individë, organizata dhe agjenci të ndryshme, kryesisht shkelje të parimeve të Kodit të Transmetimit.

Këshilli i Ankesave ka organizuar dhe kontribuar në disa aktivitete të përbashkëta me partnerë institucionalë dhe ndërkombëtarë, si OSBE, KiE etj. Ka organizuar tre konferenca dhe tryeza, me pjesëmarrjen dhe kontributin e figurave të njohura të jetës akademike, universitare, të medias, publikut dhe të shoqërisë civile. Në këto aktivitete janë trajtuar pika të rëndësishme të Kodit të Transmetimit, si mbrojtja e fëmijëve, edukimi për median dhe gjuha e urrejtjes. Këto aktivitete synuan të promovojnë kulturën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në transmetimet audiovizive, të rrisin ndërgjegjësimin e publikut dhe të të gjithë aktorëve të interesuar mbi çështje të ndjeshme, si mbrojtja e fëmijëve dhe edukimi mediatik, të skanojnë situatën mbi aspekte të ndryshme të transmetimeve televizive etj.

Krahas këtyre organizimeve, Këshilli i Ankesave ka vijuar dhe po vijon takimet e tij me aktorë të ndryshëm të shoqërisë, për t’u shpjeguar rolin dhe detyrat e tij, në mbrojtje të parimeve themelore të sanksionuara nga Kodi i Transmetimit. Çmujmë se përpjekje të tilla kanë shërbyer për të sensibilizuar shoqërinë që të adresojnë ankesat dhe shqetësimet e tyre, si dhe për të ndërgjegjësuar operatorët audiovizivë mbi respektimin e normave dhe parimeve ligjore dhe etike.

Këshilli i Ankesave përmbylli kuadrin nënligjor, si kërkesë e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që normojnë punën e Këshillit të Ankesave në raport edhe me Operatorët e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA). Pas miratimit të Rregullores “Mbi procedurat për trajtimin e ankesave dhe për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes”, u hartua dhe u miratua edhe udhëzimi përkatës “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA)”. Këto dy dokumente të rëndësishëm u janë dërguar OSHMA-ve, të cilëve u është kërkuar zyrtarisht ngritja e Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave, që është një nga kërkesat e Rregullores “Mbi procedurat për trajtimin e ankesave dhe për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes”. Deri tani janë krijuar Bordet e Shqyrtimit të Ankesave nga disa operatorë audiovizivë dhe Këshilli i Ankesave po i inkurajon ato të bëhen pjesë aktive e shqyrtimit të ankesave. Përmbyllja e këtyre akteve, ndjekja e tyre, si dhe përfshirja e OSHMA-ve në procesin e shqyrtimit të ankesave e ka përmirësuar këtë proces, si dhe trajtimin e shqetësimeve të adresuara nga individë, shoqata dhe agjenci të ndryshme për problematikat që shfaqen në transmetimet audiovizive.

Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar brenda afateve ligjore të përcaktuara të gjitha ankesat e depozituara në AMA, pjesa më e madhe e të cilave janë dërguar nga individë. Ankesat e ardhura deri në muajin qershor të vitit 2018 janë përfshirë në Buletinin nr. 4 të këshillit të Ankesave, i cili gjendet lehtësisht në faqen zyrtare të internetit të AMA-s [ama.gov.al](http://ama.gov.al). Në këtë Buletin janë trajtuar dhe pranuar 14 ankesa nga qytetarë dhe institucione publike. Janë publikuar gjithashtu edhe shqyrtimet dhe masat përkatëse mbi këto ankesa, që janë kryesisht për cenim dinjiteti, shkelje të të drejtave të fëmijëve, reklamata e ndaluara etj. Ndërsa në Buletinin nr. 5, i cili është në proces hartimi, reflektohen mbi 30 ankesa të shqyrtuara përgjatë periudhës qershor-dhjetor 2018.

**11) AMA të forcojë më tej pavarësinë e tij si rregullator i tregut mediatik dhe të funksioneve mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse në drejtim të sigurimit të diversitetit dhe pluralizmit, transparencës së reklamave shtetërore, si dhe të bëhet promotor i zbatimit më të mirë të legjislacionit që garanton lirinë e shprehjes dhe të drejtës për informim, duke bashkëpunuar me të gjithë aktorët dhe institucionet në vend për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë, si kërkesa të Komisionit Evropian.**

Rregullat kryesore të funksionimit të AMA-s në fushën e medias audiovizive përcaktohen në Ligjin Nr. 97/2013, ku në Kreun të 2-të të tij përcaktohet statusi, kompetencat, organizimi dhe funksionet e AMA-s, si një organizëm i pavarur që vepron si autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.

AMA ka ushtruar veprimtarinë kolegjiale si një trup i plotësuar me të gjithë anëtarët e tij, duke përmbushur në këtë mënyrë plotësisht objektivat e parashikuara në ligjin e posaçëm, çka reflektohet në vendimet e miratuara prej saj që kërkojnë shumicë të cilësuar (dhënie/heqje licencash dhe/ose autorizimesh etj).

AMA ka plotësuar kuadrin nënligjor përmes miratimit të akteve përkatëse, të cilat kanë ndikim të ndjeshëm në veprimtarinë e mediave audiovizive.

Sa i përket elementit të pavarësisë financiare, në ligjin e posaçëm që rregullon veprimtarinë e mediave audio/audiovizive parashikohet kompetenca e AMA-s për të vendosur masën e pagesave të operatorëve të rrjeteve e programeve në mënyrë të pavarur. Konkretisht, AMA ka kompetencë të caktojë dhe rishikojë në mënyrë periodike me vendim të tij, të ardhurat nga pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave; të ardhurat nga pagesat vjetore të licencës; të ardhurat nga përpunimi i kërkesave për licencim.

Gjithashtu, në ligjin organik, përcaktohet pavarësia e autoritetit rregullator për hartimin dhe miratimin e projektbuxhetit vjetor. Një përcaktim i tillë ligjor është përkthyer në fleksibilitet dhe menaxhim të burimeve të financimit të autoritetit në mënyrë rentabël dhe në përputhje të plotë me funksionet dhe objektivat institucionale.

Ky rregullim ligjor përbën garanci për të siguruar dhe forcuar pavarësinë e autoritetit rregullator.

## **Mbrojtja dhe forcimi i të drejtave të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë**

AMA, në muajin maj të vitit 2018, nisi një akord bashkëpunimi me Komisionin për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë.

Fokusi ishte rregullimi i marrëdhënieve të punës së gazetarëve në mediat audiovizive. Shtysë ishin problematikat e hasura, si niveli i kushteve të punës së gazetarëve, format e rekrutimit dhe largimit nga redaksia, mosshlyerja në kohë e pagesave nga punëdhënësi, organizimi i gazetarëve ose mosorganizimi në shoqata, funksionaliteti i tyre etj.

Në maj të vitit të kaluar, AMA dhe Komisioni, për herë të parë u ulën në një Tryezë Diskutimi me përfaqësues nga të gjitha grupet e interesit: gazetarë, drejtues mediash, nga shoqatat dhe organizatat e tyre, anëtarë të Parlamentit, profesorë të gazetarisë, institucionet shtetërore që mbulojnë aspekte të punësimit etj.

Gjatë diskutimit, mes pjesëmarrësve pati qëndrime të ndryshme nga diskutantët, por e përbashkëta ishte se që prej fillimeve të demokracisë e në vijim, ka ardhur koha për veprime në sigurimin e lirisë së medias. Pa një gazetar të sigurtë në punë nuk mund të kemi media të lirë dhe pluraliste, u tha nga diskutantët në Tryezë.

Aty u bënë dhe 5 propozime, të cilat përmbledhtazi janë:

- Kontratë individuale pune (me afat të pacaktuar), ku duhet që OSHMA-të, në lidhjen e marrëveshjeve kontraktore me gazetarët duhet të parashikojnë gjithnjë një kohëzgjatje të Kontratës individuale me afat të pacaktuar në respektim të Nenit 140, paragrafi 2, të Kodit të Punës, përveç rasteve kur ka arsye objektive në lidhje me natyrën e përkohshme të detyrës së gazetarit.
- Formimi profesional për pranimin në punë të gazetarit, pasi me qëllim rritjen e cilësisë dhe larmisë së përmbajtjeve të transmetuara audio dhe audiovizive, OSHMA-të gjatë procedurave të marrjes në punës, duhet të inkurajojnë, mbështesin, promovojnë persona që kanë formimin profesional të kërkuar dhe të nxisin motivimin dhe përgjegjësinë për kryerjen e detyrave brenda dhe jashtë redaksisë ku angazhohen.
- Përshkrimi i punës së gazetarit, pasi bazuar në Nenin 21, paragrafi 3, gërma c e Kodit të Punës, përshkrimi i punës është një element i domosdoshëm për t'u parashikuar në Kontratën e Punës, sepse specifikisht e lidh marrëdhënien e punës në rastin në fjalë të Punëdhënësit dhe gazetarit me kryerjen e detyrave të parashikuara në përshkrimin e punës dhe jo në detyra të tjera shtesë.
- Paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të gazetarit. Në progres-raportet e BE-së u kushtohet vëmendje e posaçme garantimit të zbatimit të duhur të të drejtave të punës, sidomos të drejtave të gazetarëve për pajisjen me kontratë të rregullt punësimi, çka nënkupton ndër të tjera, edhe deklarimin real të pagës së përfituar. Sa u përket pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat personale, punëmarrësi duhet të kontrollojë periodikisht çdo muaj, nëse punëdhënësi i tij ka kryer rregullisht derdhjet brenda afateve ligjore.
- Transparenca në faqen web të OSHMA-së e listës së gazetarëve të punësuar, ku të gjitha OSHMA-të duhet të kenë të publikuara në faqet e tyre web listën e gazetarëve të punësuar pranë tyre në detyrat përkatëse.

AMA do të vazhdojë përpjekjet që ky proces të vijojë për të arritur tek rezultatet konkrete.

### **3 MASAT E MARRA NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONE TË TJERA KUSHTETUESE OSE TË PAVARURA NDAJ AUTORITETIT**

Gjatë vitit raportues, AMA u auditua nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna mbi auditimin e kryer gjatë vitit 2017 për periudhën 2014-2016, dhe ka vijuar komunikimin mbi rekomandimet e lëna.

AMA ka zbatuar rekomandimet e këtij organi kushtetues, duke miratuar ndryshimet e nevojshme në kuadrin nënligjor të saj, duke iniciuar procese gjyqësore për arkëtimin e vlerës së detyrimeve prej subjekteve, të cilëve u është hequr/konstatim pavlefshmërie licenca/autorizimi në vitet 2015-2016 e më tej. Institucioni ka përmbushur 2 (dy) masa për shpërblim dëmi duke investuar organet gjyqësore. Për 1 (një) masë shpërblim dëmi, AMA në çdo komunikim shkresor ka shprehur pamundësinë e zbatimit të tij, duke qenë se nuk janë përcaktuar nga KLSH personat përgjegjës dhe masat zhdëmtuese respektive të shumës së zhdëmtimit.

Gjithashtu, në rekomandimet e lëna nga KLSH është propozuar marrja e disa masave disiplinore ndaj disa prej punonjesve në AMA për shkeljet e konstatuara nga Grupi i Kontrollit. AMA ka vijuar procedurat për zbatimin e rekomandimit, duke ngritur Komisionin Disiplinor dhe duke shqyrtuar rast pas rasti shkeljet e konstatuara. Vendimet e Komisionit Disiplinor i janë bërë me dije edhe KLSH-së.

Gjatë vitit 2018, në vijim të kalimit për kompetencë tek Agjencia e Prokurimit Publik të një pjese të raportit të auditimit të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi procedurat e prokurimit me vlerë të vogël për periudhën 2014 – 2016 dhe të komunikimit me AMA-n, u mor vendimi 23/2018 nga Agjencia e Prokurimit Publik. AMA ka filluar zbatimin e masave të dënimeve me gjobë dhe gjithashtu edhe mbi masat disiplinore të rekomanduara.

Në vijim të rekomandimit të KLSH-së për Autoritetin e Konkurrencës, AMA ka mbajtur komunikim gjatë vitit 2018 me këtë të fundit. Autoriteti i Konkurrencës, me vendimin nr. 530/2018, ka rekomanduar që AMA të marrë masa për shmangien e sjelljeve abuzuese nga operatorët me pozitë dominuese në treg, duke mbajtur parasysh që marrëveshjet midis ndërmarrjes me pozitë dominuese dhe ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv të mos kenë klauzola kufizuese, dhënia e aksesit për ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv të jetë në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, tarifat për dhënien e aksesit OSHMA-ve për transmetim në rrjetin numerik të jenë të orinetuara në kosto, të parashtrijë pranë Autoritetit të Konkurrencës rastet kur vëren shenja të kufizimit të konkurrencës nga ndërmarrjet me pozitë dominuese në treg dhe të informojë mbi ndryshimin e strukturës së tregut kur të fillojnë aktivitetin të gjitha shoqëritë private kombëtare numerike.

Nga ana tjetër, AMA në zbatim të kërkesave të ligjit organik dhe Planit të Veprimit do të miratojë rregulloren me objekt përcaktimin e procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis mbajtësve të licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv dhe ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv, për çështje dhe problematika të aksesit për transmetim në rrjet numerik

Gjithashtu, Autoriteti i Konkurrencës, në vitin 2018 ka përcjellë pranë AMA-s disa rekomandime për rritjen e konkurrencës gjatë procesit për digjitalizimin e transmetimeve audiovizive (Vendimi nr. 548/2018). Bazuar në këtë vendim, AMA vijoi punën për përmirësimin e fushatës informuese për publikun, përfshirë edhe ndryshimin e përmbajtjes së spoteve informuese, njoftimeve apo zgjerimin e kanaleve të komunikimit.

## **4 REKOMANDIMET E LËSHUARA NË PROGRES-RAPORTIN E BE-së DHE DETYRIME TË TJERA NDËRKOMBËTARE NDAJ AUTORITETIT**

### **4.1 Në lidhje me procesin e kalimit në transmetimet numerike.**

#### **- PROGRES RAPORTI**

Shoqëria e informacionit dhe Media

*“Shqipëria duhet në veçanti të finalizojë procesin e vonuar të kalimit në transmetimet numerike, të lirojë dividendin digjital dhe të rishikojë planin kombëtar të shërbimit të internetit me shpejtësi të lartë (broadband) me objektiva dhe qëllime të qarta”.*

#### **- NËNKOMITETI SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA**

*“Shqipëria inkurajohet fuqishëm të përfundojë zbatimin e kalimit në transmetime numerike”.*

#### **- KOMITETI I STABILIZIM ASOCIIMIT**

*“Shqipërisë i kërkohet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të përfunduar zbatimin e kalimit në transmetime numerike”.*

AMA ka raportuar pranë Komisionit Evropian në lidhje me rekomandimet për finalizimin e procesit të digjitalizimit dhe lirim të brezit DD1 si më poshtë:

Në zbatim të Ligjit 97/2013 dhe në përmbushje të detyrave të përcaktuara në strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në transmetimet numerike, AMA ka vijuar me aktivitete të rëndësishme sa i takon procesit të digjitalizimit në vendin tonë.

Koordinimi në kuadër të implementimit të dy rrjeteve numerike të operatorit publik shqiptar (RTSH) dhe 5 rrjeteve numerike të operatorëve privatë kombëtarë të licencuar nga AMA ka zënë një vend të rëndësishëm në këto aktivitete. Janë zhvilluar takime dhe vendosur korrespondenca të vazhdueshme me këta operatorë lidhur me zbatimin e afateve të implementimit të rrjeteve sipas grafikut të “ishujve numerike”, mbi përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për mbështetjen në rrjetet e tyre të operatorëve lokalë/rajonalë, mbi mbulimin me sinjal numerike cilësor të territorit, mbi respektimin e numrit logjik të programeve të tyre etj.

AMA ka koordinuar punën edhe me operatorët analogë lokalë/rajonalë në kuadër të përmbushjes së afateve për mbështetjen e programeve të tyre audiovizive në rrjetet kombëtare numerike dhe gjetjen e zgjidhjeve teknike efektive për të realizuar këtë mbështetje.

Gjithashtu, AMA ka vijuar fushatën e informimit publik për t’iu gjendur pranë publikut deri në përfundim të procesit të digjitalizimit. Fushata është organizuar në forma të ndryshme për të qenë sa më efektive dhe depërtuese tek publiku shqiptar (spote televizive, broshura, fletëpalosje, struktura Call Center, emisione televizive etj.)

Aktivitetet e zhvilluara kanë sjellë progres në procesin e implementimit të rrjeteve numerike dhe në procesin e mbylljes së transmetimeve analoge në të gjithë vendin.



Aktualisht, infrastruktura e rrjeteve kombëtare numerike është prezente pothuajse në të gjithë territorin dhe transmetimet analoge janë mbyllur në tre qarqe të vendit (Berat, Korçë, Fier). Rreth 70 % e popullsisë mund të aksesojë transmetimet digjitale audiovizive.

Procesi i mbylljes së transmetimeve analoge vijon në qarqet Tiranë dhe Durrës, të cilët janë edhe qarqet me popullsi më të madhe në vend dhe afati i mbylljes së transmetimeve analoge në këto qarqe ishte përcaktuar data 31 korrik 2018. Ndërkohë, më datë 24 korrik 2018 është organizuar një takim nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, ku merrnin pjesë përfaqësues të AMA-s, RTSH-së, Shoqatës së Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë-Valorë (RRTL) si dhe operatorë lokalë/rajonale.

Bazuar në çështjet e ngritura gjatë takimit, afati i mbylljes së transmetimeve analoge në këto rajone u zhvendos për në 10 shtator 2018. Në këtë datë operatorët audiovizivë mbyllën transmetimet e tyre analoge në qarqet Tiranë dhe Durrës.

Ditën kur transmetimet analoge u mbyllën, u identifikuan vështirësi për qytetarët në aksesimin dhe instalimin e dekoderit të tipit DVB-T2 (një kërkesë teknike e përcaktuar në Ligjin 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikë e Shqipërisë" dhe Strategjinë e Kalimit në transmetime digjitale). Për shkak të kësaj situate, AMA vendosi të shtyjë afatin deri më datë 15 janar 2019. Gjatë këtyre katër muajve, deri në 15 janar 2019, në këto qarqe do të bashkëjetojnë/do të jenë të pranishme transmetimet dixhitale dhe analoge (simulcasts).

#### **- Lirimi i brezit 790-862 MHz (Dividendit Digjital)**

Procesi i digjitalizimit është shoqëruar edhe me procesin e lirimit të brezit 790-862 MHz ose ndryshe 800 MHz (Dividenti Digjital). Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 29.03.2017 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave", data përfundimtare për lirimin e këtij brezi nga transmetimet audiovizive ka qenë data 30.06.2017. Pas kësaj date ky brez duhet të ishte i disponueshëm për shërbimet e lëvizshme.

Në përmbushje të afatit ligjor, pas një sërë aktiviteteve të ndërmarra, si lirimin e këtij brezi nga transmetimet e paligjshme, migrimin e operatorëve që kishin në përdorim frekuencat e këtij brezi në frekuenca të tjera, takime me operatorët audiovizivë në kuadër të përshpejtimit të procesit dhe zgjidhjes së problematikave të hasura si dhe monitorimeve të vazhdueshme për të verifikuar situatatën në terren, AMA bëri të mundur lirimin e këtij brezi nga të gjithë operatorët audiovizivë që transmetonin në analog në të gjithë Shqipërinë brenda afatit të përcaktuar (30.06.2017). Ndërkohë pati vonesa në lirimin e këtij brezi nga transmetimet numerike, për shkak të procesit të zëvendësimit apo konfigurimit të dekoderave që kishin në përdorim konsumatorët shqiptarë.

Tashmë, brezi 800 MHz është i lirë për t'u përdorur për shërbimet e internetit me shpejtësi të lartë (shërbimet e lëvizshme).

**Gjatë vitit 2018, gjithashtu është raportuar lidhur me rekomandimet e Komisionerit Hann, në kuadër të Progres Raportit nëntor 2018 REA MAP-Digital. Raportimi i është kërkuar AMA-s nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila mban korrespondencën me Kryeministrinë lidhur me këto raporte.**

*Raportimi i parë është kryer në vijim të letrës së Komisionerit Hann drejtuar Kryeministrit më datë 19 tetor 2018, si më poshtë:*

| Masat Kryesore/Produkti                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Veprimet/Aktivitetet                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Realizuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <p>1. Transmetimet analoge janë mbyllur në qarqet Berat, Korçë dhe Fier.</p> <p>2. Infrastruktura numerike është prezente pothuajse në të gjithë vendin dhe rreth 70% e popullsisë mund të aksesojë këto shërbime.</p> <p>3. Operatori Publik Shqiptar (RTSH) ka instaluar të gjithë transmetuesit numerike në të gjithë vendin.</p> <p>4. Lirimi i brezit DD 1 (dividenti digital) me qëllim përdorimi i tij për shërbimet mobile (LTE).</p> | <p>1. Koordinim intensiv me operatorët privatë audiovizivë lokalë/rajonale dhe kombëtarë (takime në nivel të lartë dhe nivel teknik, korrespondenca të vazhdueshme, etj).</p> <p>2. Koordinim i vazhdueshëm me operatorin publik shqiptar (RTSH).</p> <p>3. Organizimi i fushatës sensibilizuese për publikun në forma të ndryshme (dy numra Call Center, mesazhe dhe spote publicitare, etj).</p> <p>4. Monitorime në terren për verifikimin e mbulimit me sinjal numerik të qarqeve Berat, Korçë dhe Fier si dhe verifikimin e cilësisë së sinjalit.</p> <p>5. Bashkëpunim me AKEP në kuadër të lirit të brezit DD1.</p> |
| Për t'u realizuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <p>1. Procesi i mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Tiranë, Durrës, ku është e përqendruar pjesa më e madhe e popullsisë, është në implementim dhe do të finalizohet më 15 janar 2019.</p> <p>2. Finalizimi i procesit të digjitalizimit brenda vitit 2019.</p>                                                                                                                                                                       | <p>1. Do të vijojë koordinimi me operatorët audiovizivë dhe të gjithë palët e interesuara.</p> <p>2. Do të vijojë fushata e informimit të publikut deri në finalizimin e procesit.</p> <p>3. Do të vijojë monitorimi në terren për të gjithë qarqet ku do të vijojë procesi i digjitalizimit.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |

*Raportimi i dytë është kryer në vijim të letrës së Komisionerit Hann drejtuar Kryeministrit më datë 19 dhjetor 2018. Në këtë letër kërkohej një përgjigje e arsyetuar lidhur me plan masat në vijim si dhe afatet e parashikuara për adresimin e tyre.*  
*Më poshtë është informacioni i raportuar:*

Bazuar në strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në transmetime digjitale, procesi i digjitalizimit është parashikuar të zhvillohet me faza. Çdo fazë parashikon mbylljen e transmetimeve analoge në një allotment (çdo allotment përkon me një qark të vendit me përjashtim vetëm të allotmentit të Tiranës, i cili përmban qarqet Tiranë dhe Durrës). Aktualisht procesi ka përfunduar në 3 qarqe Berat, Fier dhe Korçë dhe më datë 15 janar 2019 parashikohet mbyllja e transmetimeve analoge në 2 qarqe të tjera, përkatësisht Tiranë dhe Durrës. Masat e parashikuara për vijimin e procesit të digjitalizimit, të raportuara edhe më parë, janë si më poshtë:

- Koordinimi me operatorin publik shqiptar (RTSH) dhe me operatorët audiovizivë lokalë/rajonale/kombëtarë në kuadër të përcaktimit të qarkut vijues ku do të implementohet procesi i digjitalizimit, zgjidhjes së problematikave teknike që mund të lindin gjatë procesit, implementimit të numrit logjik të programeve etj.
- Zhvillim i fushatës së ndërgjegjësimit për publikun në forma nga më të ndryshmet, nëpërmjet spoteve publicitare, mesazheve informuese në faqen zyrtare të AMA-s, në rrjetin social facebook dhe në mediat elektronike, përgjigje pyetjeve drejtuar qendrës Call Center të ngritur në AMA, si dhe pyetjeve drejtuar në adresën zyrtare të AMA-s [info@ama.gov.al](mailto:info@ama.gov.al) apo në rrjetin zyrtar në facebook etj.
- Monitorime intensive në terren për t'u siguruar mbi vijimësinë e transmetimeve audiovizive në qarqet ku do të mbyllet transmetimet analoge, si dhe mbulimin e tyre me sinjal cilësor numerik.

Informojmë se masat e mësipërme do të ndërmerren për çdo qark ku do të implementohet procesi i digjitalizimit dhe përgjatë gjithë periudhës, deri në përfundimin e plotë të procesit të digjitalizimit. Në këtë kuadër nuk mund të përcaktohet plan masash me afate të përcaktuara. Afate mund të përcaktohen për mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet e mbetura, por nisur nga përvoja e deritanishme, afatet e përcaktuara nga AMA gjithmonë janë kapërcyer (janë shtyrë) për arsye teknike apo me kërkesë të operatorëve audiovizivë.

Rasti më i fundit është shtyrja e afatit të mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Tiranë e Durrës. Afati i përcaktuar për finalizimin e procesit në këto dy qarqe ka qenë 31 korrik 2018 dhe AMA kishte parashikuar mbylljen e transmetimeve analoge edhe në dy qarqe të tjera të vendit brenda vitit 2018. Ndërkohë, operatorët audiovizivë kërkuar shtyrjen e afatit deri në fund të vitit, por AMA gjykoi se kërkesa e tyre ishte e pabazuar duke qenë se infrastruktura ishte prej kohësh prezente në këto qarqe. Megjithatë AMA shtyu afatin deri më 10 shtator 2018. Me mbylljen e transmetimeve analoge më datë 10 shtator 2018 u konstatuan radhë të gjata të qytetarëve në pikat e shitjeve të dekoderave dhe një fluks i madh telefonatash drejt numrave Call Center në AMA, që tregonin për konfuzion të qytetarëve lidhur me teknologjitë DVB-T dhe DVB-T2. Duke e konsideruar këtë një situatë jonormale dhe për të krijuar kushte lehtësuese për qytetarët, AMA vendosi të shtyjë afatin deri më 15 janar 2019.

Kjo ishte një situatë e paparashikuar për AMA, së pari, pasi procesi tashmë ka përfunduar në 3 qarqe të vendit dhe nuk është shfaqur një problematikë e tillë dhe, së dyti, pasi AMA ka filluar fushatën e ndërgjegjësimit të publikut që nga viti 2016 në forma të ndryshme të tilla si broshura, fletëpalosje, spote publicitare, njoftime/mesazhe publike, ngritjen e strukturës Call Center, përgjigje pyetjeve të drejtuara në faqen sociale Facebook apo adresën zyrtare [info@ama.gov.al](mailto:info@ama.gov.al).

Megjithë shtyrjet e afateve të deritanishme, që ndikojnë drejtpërsëdrejti në afatin e finalizimit të procesit të digjitalizimit, informojmë se operatori publik shqiptar (RTSH) ka shtruar infrastrukturën digjitale në të gjithë vendin dhe operatorët privatë numerik kanë implementuar rrjetet e tyre në pjesën më të madhe të allotmenteve të mbetur. Si rrjedhojë, parashikimi për përfundimin e plotë të procesit brenda vitit 2019, sikurse është raportuar nga AMA, konsiderohet i realizueshëm.

**Shënim:** Raportimet e AMA-s lidhur me rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare përkojnë me vitin 2018. Prandaj nuk është përfshirë shtyrja e afatit për mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë, Durrës nga 15 janar 2019 më 1 shtator 2019, e cila është raportuar në këtë material në Kapitullin 8 “Kalimi në Transmetimet Numerike”.

## 4.2 Në lidhje me çështje të tjera

### - PROGRES-RAPORTI

Liria e Shprehjes

*“Shqipëria duhet në veçanti:*

*• Të përshtasë legjislacionin në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare për reklamën shtetërore për rritjen e transparencës”.*

### - KOMITETI I STABILIZIM-ASOCIIMIT

*“Shqipëria inkurajohet të përfshijë në legjislacion reklamën shtetërore në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare për të rritur transparencën.”*

Mbi këtë rekomandim, Autoriteti ka raportuar se Buletini Periodik i AMA-s ka një kapitull të veçantë mbi performancën ekonomike dhe financiare të operatorëve audio dhe audiovizivë në shërbim të transparencës së aktivitetit të tyre. Në kapitull jepen tregues të nivelit të financimeve për subjektet kryesore në treg, investimet, të ardhurat etj.

Po ashtu, AMA, si autoriteti monitorues i programeve që emetohen prej subjekteve audio dhe audiovizivë raporton mbi volumin që zënë reklamën si burimi kryesor i financimit të ofruesve të shërbimit mediatik audiovizivë. (në kohë dhe në numër).

Në ligjin organik nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përkufizohen reklamën politike dhe institucionale si dhe trajtohen në nenet 39 dhe 40 të tij. Ligji i posaçëm nuk parashikon rregulla apo kritere mbi mënyrën e prokurimit të tyre. AMA, në kuptim të tagrave dhënë prej ligjit organik, monitoron tërësinë e programeve të transmetuara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, ndërkohë që është jashtë sferës së veprimtarisë së AMA-s, kryerja e procedurave të prokurimit të reklamave shtetërore që aktualisht prokurohen nga secili institucion publik.

### - NËNKOMITETI DREJTËSI LIRI DHE SIGURI

*“Shqipëria të adresojë mangësitë në rregullimin kombëtar të financimit të medias, duke përfshirë legjislacionin mbi reklamën shtetërore”.*

AMA e mbështet veprimtarinë në Ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Subjektet që kërkojnë pajisjen me licencë/autorizim për ushtrimin e veprimtarisë audio/audiovizive, në zbatim të dispozitave të parashikuara në ligjin organik në aplikimin e tyre duhet të depozitojnë origjinën dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen e licencës/autorizimit dhe AMA, gjatë shqyrtimit të aplikimeve, verifikon burimet financiare që zotërojnë aplikuesit si dhe aspektet e funksionimit ekonomik e financiar të subjekteve.

Po ashtu, AMA, si autoriteti monitorues i programeve që emetohen prej subjekteve audio dhe audiovizivë raporton mbi volumin që zënë reklamën si burimi kryesor i financimit të ofruesve të shërbimit mediatik audiovizivë (në kohë dhe në numër).

Në ligjin organik nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përkufizohen reklamat politike dhe insitucionale, si dhe trajtohen në nenet 39 dhe 40 të tij. Ligji i posaçëm nuk parashikon rregulla apo kritere mbi mënyrën e prokurimit të tyre. AMA në kuptim të tagrave dhënë prej ligjit organik monitoron tërësinë e programeve të transmetuara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive ndërkohë që është jashtë sferës së veprimtarisë së AMA-s, kryerja e procedurave të prokurimit të reklamave shtetërore të cilat aktualisht prokurohen nga secili institucion publik.

## **5 TË DHËNA LIDHUR ME AKTIVITETIN E AUTORITETIT PËR KRYERJE INSPEKTIMESH OSE HETIMESH ADMINISTRATIVE, VENDIME TË SANKSIONEVE ME GJOBË NË RAPORT ME VITET E FUNDIT**

Një prej aspekteve të punës së AMA-s është kontrolli i veprimtarisë programore, financiare, teknike dhe organizative të mbajtësit të një licence dhe/ose autorizimi, sipas përcaktimeve të ligjit dhe mbikëqyrja e respektimit të kushteve të licencës/autorizimit.

Gjatë vitit 2018 nga AMA janë vendosur 31 sanksione me gjobë, të ndërmarra si më poshtë:

- Drejtoria e Mbikëqyrjes 27 vendime të sanksioneve me gjobë;
- Drejtoria Juridike dhe Licencave 3 vendime të sanksioneve me gjobë;
- Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme 1 vendim të sanksionit me gjobë.

### **Drejtoria e Mbikëqyrjes**

Gjatë vitit të raportimit, Drejtoria e Mbikëqyrjes është fokusuar në monitorimin e spektrit të frekuencave, në kuadër të procesit të digjitalizimit. Megjithatë, në lidhje me piraterinë audiovizive janë kryer inspektime të veprimtarive audiovizive në terren si dhe monitorime të programeve nga studio e monitorimit.

Në lidhje me veprimtarinë inspektuese, Drejtoria e Mbikëqyrjes, gjatë vitit 2018, përmes grupeve të veta të inspektimit ka ushtruar 224 kontrole të aktivitetit audioviziv në vend, ndaj subjekteve ofrues të shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA).

Në përfundim të kontrolleve dhe shqyrtimit të procedurave përkatëse administrative janë marrë masat si më poshtë:

- **27** vendime për sanksione me gjobë ndaj subjekteve OSHMA që janë konstatuar në shkelje të Ligjit nr.97/2013, prej të cilave:
  - o **22** sanksione me gjobë ndaj subjekteve përsëritës të shërbimit të tretëve (kablurë, iptv, ott); prej të cilave **11** gjoba janë shfuqizuar nga Bordi i AMA-s, pas ankimeve administrative, kurse **5** janë ende në shqyrtim.
  - o **5** sanksione me gjobë ndaj subjekteve OSHMA TV, prej të cilave **4** gjoba janë shfuqizuar nga Bordi i AMA-s, pas ankimeve administrative.
- Për **49** raste është vendosur tërheqja e vëmendjes së subjekteve OSHMA.
- Përveç sa më sipër, AMA, pas verifikimeve dhe shqyrtimeve pëkatëse, ka kryer sekuestrimin e pajisjeve transmetuese të **11** subjekteve, të cilët ushtronin aktivitet audioviziv pa licencimin ose autorizimin e AMA-s.

Siç vihet re, në krahasim me vitet e mëparshme, aktivitetet e paligjshme audiovizive, pa licencimin ose autorizimin e AMA-s janë gjithnjë në rënie.

Në vijim, informacioni në formë krahasuese me tre vitet e mëparshme:

| VITI | INSPEKTIMET | GJOBA TOTAL<br>(Shfuqizuar) | TËRHEQJE<br>VËMENDJE | SEKUESTRIME |
|------|-------------|-----------------------------|----------------------|-------------|
| 2016 | 257         | 58 (32)                     | -                    | 23          |
| 2017 | 488         | 64 (29)                     | 25                   | 19          |
| 2018 | 224         | 27 (10)                     | 49                   | 11          |

Për sa i përket veprimtarisë monitoruese, Drejtoria e Mbikëqyrjes, gjatë vitit të raportimit është fokusuar në monitorimin e programeve mbi tematikën e tyre dhe respektimin e parashikimeve ligjore për transmetimin e reklamave dhe për evidentimin e volumit të reklamave në televizionet kombëtare, sikurse edhe në monitorimin e programeve të lira në platformat numerike tokësore.

#### **Drejtoria Juridike dhe Licencave**

Për verifikimin e respektimit të detyrimit ligjor, njoftimit pranë autoritetit licencues të ndryshimeve të ndodhura në të dhënat për marrjen e licencës/autorizimit, AMA në mënyrë periodike ka kontrolluar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, strukturën e pronësisë së OSHMA-ve.

Në vijim të kontrolleve të kryera, AMA gjatë vitit 2018 ka iniciuar hetim administrativ për 3 subjekte. Për të njëjtën kundërvajtje administrative, gjatë vitit 2017, AMA ka nisur procedimin administrativ për 10 subjekte. Gjatë vitit 2018, AMA ka marrë vendim të shfuqizojë 2 sanksione me gjobë të vitit 2018.

AMA vëren një ndërgjegjësim më të madh të subjekteve audio/audiovizive për respektimin e kuadrit ligjor në fuqi për njoftimin e ndryshimeve, pasi gjatë periudhës raportuese rezultoi se pjesa më e madhe e subjekteve kanë njoftuar Autoritetin mbi ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë, brenda afatit të përcaktuar në kuadrin ligjor, 30 ditë nga kryerja e tyre.

#### **Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme**

Në zbatim të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, në vitin 2018 pati një rritje të madhe të depozitimit të bilanceve të vitit 2017 nga OSHMA-të. Vetëm 1 subjekt i autorizuar nuk depozitoi bilancin për vitin 2017, subjekt për të cilin AMA mori vendimin e sanksionimit me gjobë. Në vitin 2017, AMA ka marrë vendim të sanksionimit me gjobë për 14 subjekte të cilët nuk kishin depozituar bilancet për vitin 2016. Gjatë vitit 2018, AMA ka marrë vendim të lërë në fuqi vendimin sanksion me gjobë të vitit 2018.

Ecuria financiare gjatë vitit 2018 e sanksioneve me gjobë (në lekë)

|                                                                                                          |                    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| <b>Çelja në fillim të vitit 2018</b>                                                                     | <b>295.822.801</b> |
| + Vendime të sanksioneve me gjobë në 2018                                                                | 55.100.000         |
| + Kamatë vonesa të lindura në vitin 2018                                                                 | 3.577.453          |
| - Detyrime të shlyera nga vendime të sanksioneve me gjobë (vitet 2010 -2018) dhe kamatëvonesat e lindura | 12.977.014         |
| - Vendime të sanksioneve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi       | 30.744.062         |
| <b>Detyrimi në fund të vitit 2018</b>                                                                    | <b>310.779.178</b> |

Masa e detyrimeve të lindura prej 31 sanksioneve me gjobë të vitit 2018 ka qenë në vlerën 55.100.000 lekë.

Masa e uljes në vlerën 30.744.062 lekë për “Vendime të sanksioneve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi” rezulton prej:

- Me vendim të AMA-s është ulur masa e detyrimit për 1 vendim të sanksionit me gjobë të vitit 2018;
- Me vendime të AMA-s të vitit 2018 janë shfuqizuar 10 vendime të sanksione me gjobë të vitit 2018; 1 vendim sanksion me gjobë të vitit 2013; 1 vendim sanksion me gjobë të vitit 2015 dhe 5 vendime sanksion me gjobë të vitit 2017.
- 2 vendime të sanksioneve me gjobë (1 vendim të vitit 2014 dhe 1 vendim të vitit 2015) janë shfuqizuar me vendime gjyqate.



## **6 QEVERISJA E AUTORITETIT**

### **6.1 Vendimmarrja mbi licencat/autorizimet**

Veprimtaria administrative e AMA-s është formalizuar përmes vendimmarrjeve për dhënien e licencave apo autorizimeve për ofrimin e shërbimeve mediatike audio/audiovizive dhe përsëritjen e shërbimeve mediatike audio/audiovizive, për shqyrtimin e aplikimeve për rinovimin e licencave/autorizimeve të OSHMA-ve të subjekteve të ndryshëm, pavlefshmërinë e tyre, shqyrtimin e ankimeve administrative etj.

Lëshimi i licencave dhe autorizimeve për ofrimin e shërbimeve mediatike është një prej kompetencave kryesore të AMA-s. Referuar kuadrit ligjor, dhënia e licencave duke qenë se varet nga disponibiliteti i frekuencave, jepet përmes konkurrimit publik, ndërsa dhënia e autorizimeve bëhet në bazë të kërkesave të subjekteve të interesuara dhe shqyrtimit të aplikimeve përkatëse.

Në fillim të vitit 2018 ka përfunduar procedura e dhënies së licencës private kombëtare të transmetimit audio analoge, konkurrim i shpallur publikisht gjatë muajit dhjetor 2017. Pas shqyrtimit të aplikimeve të depozituara në vijim të shpalljes publike, AMA me vendimin nr. 26, datë 21.02.2018 lëshoi licencën private kombëtare të transmetimit audio analoge, shoqërisë “Club Muzikor” sh.a., të përbërë nga licenca e shërbimit të programit audio “Club FM Radio” dhe licenca për ndërtimin e operimin e rrjetit analog, për të mbuluar me sinjal audio, territorin e Republikës së Shqipërisë”

Në zbatim të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 153, datë 18.07.2016, të ndryshuar, gjatë vitit 2018, AMA ka zhvilluar 2 gara për kandidaturat për dhënien e licencave të transmetimit audio analoge.

Fillimisht, AMA me vendimin nr. 29, datë 21.02.2018 të AMA-s “Për çeljen e garës për dhënien e 16 licencave të transmetimit audio analoge private” shpalli në mënyrë publike garën e kandidaturave për dhënien e 16 licencave private të transmetimit audio analoge, të përbërë nga licenca e shërbimit të programit audio dhe licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit analog. Pranë AMA-s, në datat e përcaktuara si data përfundimtare për depozitimin e aplikimeve, u depozituan 6 aplikime. Të gjithë aplikimet rezultuan me të meta dhe në mbledhjen e datës 16 maj 2018 AMA vendosi rrëzimin e tyre dhe mosdhënien e aplikimeve.

Më tej, AMA me vendimin nr. 119, datë 16.05.2018 të AMA-s “Për çeljen e garës për dhënien e licencave të transmetimit audio analoge private” shpalli garën e kandidaturave për dhënien e 7 licencave private të transmetimit audio analoge, për zonat e ofrimit të shërbimit, për të cilat është shfaqur interes prej subjekteve të interesuara.

Pranë AMA-s, në datën e përcaktuar si datë përfundimtare për depozitimin e aplikimeve, u depozituan 11 aplikime. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjektet aplikuese, AMA vendosi:

1. Dhënien e licencës së transmetimit audio analoge rajonale shoqërisë “Radio Network Albania” sh.p.k., për subjektin audio “Hit Radio”, për të mbuluar me sinjal audio, “Qarqet Tiranë dhe Durrës”. (Vendimi nr. 157, datë 12.09.2018);
2. Dhënien e licencës së transmetimit audio analoge lokale shoqërisë “Emi Advertisement CO” sh.p.k., për subjektin audio “Radio Fantasy”, për të mbuluar me sinjal audio “Bashkitë Korçë dhe Devoll”. (Vendimi nr. 158, datë 12.09.2018);
3. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Kiss FM” sh.p.k., licencuar për subjektin audio “Kiss FM” në “Qarqet Fier dhe Vlorë”. (Vendimi nr. 159, datë 12.09.2018);
4. Rrëzimin e aplikimit të shoqërisë “Media New Vizion” sh.p.k., për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit audio privat “Radio 1”. (Vendimi nr. 160, datë 12.09.2018);
5. Rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës së transmetimit audio analoge lokale shoqërisë “One Tv Vlora” sh.p.k., për subjektin audio analog privat “One Vlora Fm”. (Vendimi nr. 161, datë 12.09.2018);
6. Rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës së transmetimit audio analoge rajonale subjektit person fizik Olta Paja, për subjektin audio analog privat “Radio Lezha”. (Vendimi nr. 162, datë 12.09.2018);
7. Rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës së transmetimit audio analoge rajonale shoqërisë “Radio Sol” sh.p.k., për subjektin audio analog privat “Radio Sol”. (Vendimi nr. 163, datë 12.09.2018);
8. Rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës së transmetimit audio analoge rajonale shoqërisë “Multiscreen” sh.p.k., për subjektin audio analog privat “Radio Report”. (Vendimi nr. 164, datë 12.09.2018);
9. Rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës së transmetimit audio analoge rajonale shoqërisë “Super Star” sh.p.k., për subjektin audio analog privat “Super Star”. (Vendimi nr. 165, datë 12.09.2018);
10. Rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës së transmetimit audio analoge rajonale shoqërisë “Tema Tv” sh.p.k., për subjektin audio analog privat “MCN Radio”. (Vendimi nr. 166, datë 12.09.2018);
11. Rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës së transmetimit audio analoge rajonale shoqërisë “Top Vibe” sh.p.k., për subjektin audio analog privat “Top Vibe”. (Vendimi nr. 167, datë 12.09.2018).

Procedurat e mësipërme të lëshimit të licencave audio janë të parat që zhvillohen që prej hyrjes në fuqi të ligjit organik nr. 97/2013, të ndryshuar, dhe rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 153, datë 18.07.2016. Problematikat e ndeshura gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit të subjekteve që kanë shfaqur interes për t’u pajisur me licencë transmetimi audio apo dhe dokumentacionit për rinovimin e licencave të transmetimit audio, janë mosparaqitja e saktë e dokumentacionit për aplikim, që ka sjellë si nevojë rishikimin e kuadrit nënligjor për lëshimin e këtyre licencave, duke patur si qëllim lehtësimin dhe dhënien ndihmë subjekteve të interesuar.

Po ashtu, gjatë vitit 2018, në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar dhe vendimit nr. 55, datë 04.04.2016, me të cilin u miratua rregullorja për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit, në muajin shkurt 2018, AMA shpalli në mënyrë publike procedurën për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit në zonën e ofrimit të shërbimit Qarqet Elbasan, Fier, Korçë.

AMA pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjektet aplikuese vendosi pranimin e kërkesës së Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë, për ofrimin e shërbimit të subjektit audio të komunitetit “Radio Ngjallja” në “Qarqet Fier, Elbasan dhe Korçë”, dhe reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit në “Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Durrës dhe Shijak.

Në zbatim të neneve 68 dhe 69 të ligjit që parashikojnë kompetencën e autoritetit rregullator për heqjen e licencës/autorizimit, AMA ka miratuar gjithashtu edhe vendime për heqje, konstatim pavlefshmërie apo mosrinovim licence/autorizimi për subjektet që nuk kanë respektuar kushtet dhe kriteret të përcaktuara në ligj dhe licencën/autorizimin e miratuar.

Një nga shkeljet më të shpeshta që është bërë shkak për heqjen e licencës/autorizimit të subjekteve të fushës është mosshlyerja e detyrimeve financiare nga AMA-s apo Buxhetit të Shtetit. Gjatë periudhës raportuese është rritur numri i subjekteve, kryesisht kabllorë që kanë hequr dorë nga autorizimi, duke kërkuar bërjen të pavlefshëm të tyre.

Sa u përket aplikimeve të reja për marrje autorizimi gjatë vitit 2018, rezulton se interesi i subjekteve për të ofruar shërbim mbështetur në rrjet kabllor është i njëjtë, krahasuar me vitet e kaluara.

#### Vendimmarrjet 2018:

- Dhënien e licencës së transmetimit audio analoge 4 subjekte, nga të cilët 1 kombëtar, 2 subjekte të reja dhe 1 zgjerim zone ofrimi shërbimi.
- Dhënien e autorizimit për 6 subjekte për ofrimin e shërbimit të programit audio/audioviziv dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit për 7 subjekte të autorizuar;
- Rinovimin e licencës për transmetime audio për 17 subjekte, rinovimin dhe zëvendësimin e licencës për transmetime audiovizive analoge për 4 subjekte dhe rinovimin e autorizimit për 9 subjekte dhe pajisjen me licencë shërbimi programi audioviziv për 13 subjekte.
- Mosdhënien e autorizimit për 3 subjekte, heqjen e licencës dhe/ose autorizimit apo konstatimin e pavlefshmërisë së licencës për 27 subjekte.
- Miratimin e ndryshimeve në të dhënat e ndodhura në kërkesën për marrje licence/autorizimi për 23 subjekte, duke përfshirë në këtë numër edhe kalimin e të drejtave të licencës/autorizimit (15 subjekte)

AMA, në përmbushje të detyrave të saj funksionale, për vënien në ekzekutim të vendimeve të marra në bazë të nenit 132 të ligjit të saj organik, ka vijuar ndjekjen e procedurave për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit. Kërkesat e Autoritetit janë pranuar nga Gjykatat duke i shndërruar këto vendime të AMA-s në tituj ekzekutivë. Më tej, ka vijuar ekzekutimi i tyre përmes shërbimit privat përmbarimor duke lidhur kështu për vitin 2018, kontrata shërbimi për ekzekutimin e 31 titujve ekzekutivë (nga të cilat janë ekzekutuar plotësisht 9 tituj ekzekutivë). Ndërkohë që gjatë kësaj periudhe kanë vijuar ekzekutimet e titujve në zbatim të kontratave të lidhura në vitet e kaluara.

## 7 AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM

### 7.1 Shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuara

Gjatë vitit 2018, në zbatim të angazhimeve që bazohen në Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, e akteve të tjera nënligjore që janë në fuqi; në zbatim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të AMA-s për periudhën 2017-2019; por dhe referuar rekomandimeve dhe detyrave që janë lënë për Autoritetin nga Kuvendi i Shqipërisë pas raportimit të fundit vjetor - AMA ka kryer sistematikisht shqyrtime mbi përmbajtjet e transmetuara nga OSHMA-të. Ato janë fokusuar te mbrojtja e fëmijëve në transmetimet audiovizive; reklamat dhe komunikimet tregtare; programet audiovizive me karakter informimin mbi shëndetin dhe përdorimin e medikamenteve; respektimi i standardeve të shqipes së folur dhe të shkruar; përmbajtjet e dëmshme me dhunë, pornografi apo përdorim të substancave narkotike në kanalet e profilit muzikor etj. Këto tematika janë vlerësuar në segmente të ndryshme të tregut, në OSHMA-të kombëtare që kanë dhe impakt të madh në publik, por dhe subjektet rajonale a lokale, duke e kombinuar shqyrtimin edhe me emisione të veçanta, të cilat shfaqin problematika, edicione informative etj. Për rastet kur shqyrtimet kanë nxjerrë problematika, gjetjet dhe konkluzionet janë ndarë me OSHMA-të, përmes shpjegimeve të hollësishme të konstatimit dhe përputhshmërisë ligjore të përmbajtjes së emetuar.

**Mbrojtja e fëmijëve.** Nga shqyrtimet tematike për këtë aspekt është evidentuar se nga OSHMA-të se tashmë ka më shumë kujdes për respektimin e kërkesave ligjore dhe Kodit të Transmetimit, duke aplikuar teknika të veçanta për rastet kur nuk duhet bërë identifikimi i portretit apo të dhënave personale, si dhe duke përdorur shenja paralajmëruese për programe që duhen ndjekur me prezencën dhe të prindërve, ose kur ka përmbajtje të dëmshme. Për rastet kur janë konstatuar anashkalim ose mosrespektim i kërkesave profesionale dhe etike u është tërhequr vëmendje subjekteve përmes shkresave ku janë evidentuar konkretisht shkeljet.

Duke e lidhur drejtpërdrejt me mbrojtjen e fëmijëve që janë para ekranit, AMA ka tërhequr vëmendjen dhe të OSHMA-ve të formatit muzikor, të cilat përfshijnë në programin e tyre dhe pjesë që kanë pamje të dhunës, të grupeve që demonstrojnë armë dhe lëndë të ndryshme luftarake, që paraqesin konsumimin e lëndëve narkotike apo alkoolin, si dhe skena të rënda erotike. Duke vlerësuar angazhimin e këtyre kanaleve për promovimin e kulturës kombëtare, sidomos për nxjerrjen në pah të krijimtarisë dhe performancës muzikore në gjuhën shqipe, AMA, në shkresat që u ka nisur gjatë muajit tetor 2018, u ka tërhequr vëmendjen OSHMA-ve, që në procesin e argëtimit, edukimit dhe informimit për ndjekësit, duhet të evitojnë përmbajtjet që bien në kundërshtim me kërkesat e Ligjit 97/2013 “Për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Kodin e Transmetimit të AMA-s, përmbajtje të cilat nuk respektojnë në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.

Siç parashikon ligji, në nenin 4, pika 1, germa b, veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton “në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve”. Po kështu, në nenin 33 pika 1, germa d, përcaktohet se “ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv, duhet të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik...”. Këto kërkesa të ligjit janë theksuar e përforcuar edhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s. Në seksionin 1, pikat 1.4 dhe 1.7, si dhe në seksionin 5, pikat 5.29, thuhet se “OSHMA-të, në programet kulturore e argëtuese...duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë së publikut dhe

efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të të miturve“, për të shmangur transmetime të tilla në orare të papërshtatshme për ta.

**Reklamat dhe komunikimet tregtare.** Miratimi nga AMA më 19 mars 2018 i rregullores “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e reklamave” (me vendimin nr. 42), pas një procesi të gjatë të konsultimit publik, kryesisht me grupet e interesit, ka qenë një shtysë në favor të angazhimit për të evituar shkeljet apo neglizhencat e OSHMA-ve në këtë drejtim. Reklamat dhe komunikimet tregtare kanë qenë një tematikë ku AMA ka realizuar disa shqyrtime gjatë vitit 2018. Aktualisht, ndjehet dukshëm një përmirësim dhe ndërgjegjësim nga OSHMA-të për të shmangur reklama të fshehta, situata të tilla transmetimi ku nuk ndahej përmbajtja e programit nga promocioni, si një metodë abuzive që sugjestionon ndjekësit dhe i keqadreson ata në informacionin që jepet mbi mallra e shërbime të ndryshme. Identifikimi i hapësirës reklamuese është një aspekt që tani merret parasysh nga moderatorët e programeve argëtuese dhe zbavitëse. Gjithashtu, ka reagim pozitiv nga OSHMA-të dhe tek qëndrimi i tyre ndaj subjekteve që sponsorizojnë, apo për konceptin e “vendosjes së produktit”. Por sërish sa i takon hapësirës së reklamave dhe komunikimeve tregtare ka ende forma të hapura ose të kamufluara që synojnë reklamimin e fshehur. Një prej këtyre segmenteve kohore ku abuzohet është ajo e edicionit informative, ku përfshihen dhe “kronika”, që në fakt janë reklama të fshehura për veprimtari biznesi konkrete.

Tjetër aspekt i reklamave dhe komunikimeve tregtare ku AMA është përqëndruar gjatë vitit 2018 kanë qenë dhe shqyrtimi i përmbajtjeve me informacione dhe diskutime mbi kujdesin shëndetësor dhe prezantimin e produkteve farmaceutike. Autoriteti ka tërhequr vëmendjen OSHMA-ve për të shmangur nga transmetimi shërbime mjekësore, si komunikim me natyrë tregtare të fshehur, për spitale, institucione shëndetësore apo personel të caktuar që shërben në to, që në të vërtetë ndikojnë në keqorientimin e ndjekësve të programeve audiovizive, në për zgjedhjen që ata bëjnë për marrjen e shërbimeve të kësaj natyre dhe që janë me rëndësi të dorës së parë për shëndetin.

Qëndrimi i disa mjekëve në programet audiovizive ka qenë në kundërshtim edhe me “Kodin e etikës dhe deontologjisë mjekësore”, ku ndalohet, për mjekun, të merret me reklama a publicitet të çfarëdo lloji, me përjashtim të rasteve kur këto kanë qëllim shkencor apo edukativ. Në këtë rast, mjeku duhet të bëjë kujdes që publiciteti të jetë objektiv dhe në përshtatje me rregullat e deontologjisë mjekësore. Mjekut nuk i lejohet të bëjë asnjë publicitet në favor të aktivitetit të tij personal apo të një institucioni të caktuar” (neni 60 pika 3). Për rastet e prezantimit të produkteve farmaceutike, redaksive audiovizive u është përsëritur kërkesa që duhet të tregojnë kujdes maksimal për të reklamuar vetëm ato produkte farmaceutike pjesë e listës së barnave që jepen pa recetën e mjekut, bazuar në listën e barnave OCT të Urdhrit të Farmacistëve. Pikërisht reklamat e fshehura në edicionet e lajmeve, përmbajtjet e transmetuara mbi kujdesin shëndetësor dhe përdorimin e medikamenteve, si dhe mbrojtja e fëmijëve janë evidentuar si tre prioritete nga Bordi i AMA-s, që në mbledhjen e parë të tij për vitin 2019.

**Respektimi i standardit të shqipes në transmetimet audiovizive.** Ka qenë një tjetër tematikë, ku janë fokusuar shqyrtimet e vitit 2018 për përmbajtjet e transmetuara. Pikërisht pas procesit vlerësues të problematikave kryesore në këtë drejtim dhe bërjes prezente të gjetjeve të OSHMA-ve që u monitoruan, AMA zhvilloi dhe një seri veprimtarish informimi dhe ndërgjegjësimi për redaksitë audiovizive në Tiranë dhe në qarqet Shkodër, Lezhë, Vlorë, Fier dhe Korçë. Në bashkëbisedim me gazetarët, redaktorët dhe reporterët e OSHMA-ve u diskutuan jo vetëm rastet e shkeljeve të konstatuara nga shqyrtimet e AMA-s, por dhe aspekte

të ndryshme të evidentuara nga një monitorim i pavaruar nga një eksperte e njohur e Departamentit të Gjuhës Shqipe në Fakultetin e Histori-Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

Tërheqjet e vëmendjes për OSHMA-të pas shqyrtimeve tematike, gjatë vitit 2018

| Nr | Data       | Nr. prot. | OSHMA                                            | Emisioni                                                                      | Shkaku                                      |
|----|------------|-----------|--------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|
| 1  | 20.02.2018 | 902       | Ora News, News 24, Report TV, Abc News, Top News |                                                                               | Për respektimin e normave të gjuhës letrare |
| 2  | 13.04.2018 | 1662      | Klan                                             | “Në kurthin e Piter Pan-it”                                                   | Mbrojtja e fëmijëve                         |
| 3  | 16.04.2018 | 1700      | Klan                                             | “E diela shqiptare”, “Xing me Ermalin”                                        | Reklamat dhe komunikimet tregtare           |
| 4  | 16.04.2018 | 1701      | Top Channel                                      | “Në shtëpinë tone”, “Pasdite në Top Channel”                                  | Reklamat dhe komunikimet tregtare           |
| 5  | 16.04.2018 | 1702      | Vizion Plus                                      | “My living”,<br>“Vizioni i pasdites”                                          | Reklamat dhe komunikimet tregtare           |
| 6  | 16.04.2018 | 1703      | Report Tv                                        |                                                                               | Reklamat dhe komunikimet tregtare           |
| 7  | 16.04.2018 | 1704      | Ora News                                         |                                                                               | Reklamat dhe komunikimet tregtare           |
| 8  | 16.04.2018 | 1705      | News 24                                          |                                                                               | Reklamat dhe komunikimet tregtare           |
| 9  | 16.04.2018 | 1706      | ABC News                                         |                                                                               | Reklamat dhe komunikimet tregtare           |
| 10 | 15.05.2018 | 2237      | Klan                                             | “E diela shqiptare”, “Xing me Ermalin”, “Zonë e lire”,<br>“Aldo morning show” | Reklamat dhe komunikimet tregtare           |
| 11 | 23.05.2018 | 2338      | Klan                                             | “Xing me Ermalin”                                                             | Reklamat dhe komunikimet tregtare           |
| 12 | 06.09.2018 | 3624      | Club FM                                          |                                                                               | Mungesa e muzikës shqip në transmetime      |
| 13 | 06.09.2018 | 3636      | Klan                                             | “Stop”                                                                        | Reklamat dhe komunikimet tregtare           |

|    |            |      |                                |                     |                                   |
|----|------------|------|--------------------------------|---------------------|-----------------------------------|
| 14 | 07.09.2018 | 3650 | Top Channel, Klan, Vizion Plus |                     | Reklamat dhe komunikimet tregtare |
| 15 | 17.09.2018 | 3764 | Klan                           | “Zonë e Lirë”       | Mbrojtja e fëmijëve               |
| 16 | 17.09.2018 | 3765 | Klan                           | “Xing me Ermalin”   | Mbrojtja e fëmijëve               |
| 17 | 09.10.2018 | 4058 | RTSH 1                         |                     | Reklamat dhe komunikimet tregtare |
| 18 | 09.10.2018 | 4059 | Digitalb                       |                     | Reklamat dhe komunikimet tregtare |
| 19 | 09.10.2018 | 4060 | Tring                          |                     | Reklamat dhe komunikimet tregtare |
| 20 | 16.10.2018 | 4127 | Digitalb                       | “Bar Sport Skedina” | Reklamat dhe komunikimet tregtare |
| 21 | 18.10.2018 | 4200 | Klan                           | “Dance with me”     | Reklamat dhe komunikimet tregtare |
| 22 | 19.10.2018 |      | Ora News                       | “Ditë e re”         | Mbrojtja e fëmijëve               |
| 23 | 26.10.2018 | 4325 | BBF, Supersonik, My Music      |                     | Mbrojtja e fëmijëve               |
| 24 | 31.10.2018 | 4372 | TNT, Klan Music, Click Tv      |                     | Mbrojtja e fëmijëve               |

## 7.2 Monitorimet e përmbajtjeve

Për monitorimin e transmetimeve analoge në periudhën janar - gusht 2018 kanë qenë në regjistrim 12 kompjutera regjistruar dhe në periudhën shtator - dhjetor 2018, 2 kompjutera regjistruar, ku janë regjistruar nga ora 07:00 deri në 04:00 të ditës së nesërme, (për t’u ristartuar përsëri në 07: 00 ) subjektet audio, audiovizive, si dhe platforma ABCom, sipas një plani të miratuar që përshtatet me kërkesat nga drejtoritë e tjera apo me ankesat nga palët e treta.

Për monitorimin e transmetimeve digjitale kanë qenë në funksion 16 njësi regjistrimi (regjistrimi kryhet pa ndërprerje 24 orë), ku përveç subjekteve audio dhe audiovizive, janë në regjistrim edhe platformat Digitalb Satelitor, Digitalb Tokësor, Tring Satelitor, Tring Tokësor.


*Në terma statistikore, në total gjatë këtij viti, janë regjistruar:*

- në transmetime analoge rreth **50,000** orë transmetime audiovizive, **7,200** orë transmetime audio të subjekteve kombëtare dhe të subjekteve audio me kërkesë të të tretëve.
- në transmetimet digjitale **128,000** orë transmetime audiovizive dhe rreth **8,500** orë

### *transmetime audio*

që krahasuar me vitet e mëparshme janë si më poshtë :

| Viti                        | 2015   | 2016   | 2017    | 2018    |
|-----------------------------|--------|--------|---------|---------|
| Orë regjistrime televizione | 69,000 | 70,000 | 142,000 | 178,000 |
| Orë regjistrime radio       | 5,000  | 5,000  | 5,650   | 15,700  |



*Krahas regjistrimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive që janë pjesë e Arkivës së Autoritetit të Mediave Audiovizive, puna në Studion e Monitorimit fokusohet në monitorime:*

- Reklamave;
- Edicioneve informative;
- Detyrimeve programore;
- Shqyrtimin e ankesave nga publiku;
- Shqyrtimin e ankesave nga operatorët;
- Monitorimet për të drejtat e transmetimit;
- Monitorimet për të drejtat e autorit.

*Gjatë vitit 2018 në Studion e Monitorimit dhe Arkivës janë kryer **92 monitorime** të subjekteve Ofrues të Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA), si dhe janë kërkuar **17 (26 ditë)** regjistrime programesh nga subjektet OSHMA, që nuk mund të monitorohen dot nga Studio e Monitorimit.*

- Edicione informative në subjektet audio dhe audiovizivë kombëtarë janë




monitoruar rreth **2,500 edicione informative** (1,500 edicione të subjekteve audioviziv kombëtarë dhe 1000 edicione të subjekteve audio kombëtare).

- Monitorimi i reklamave në subjektet audiovizivë kombëtarë janë rreth **17,500 orë** programe të monitoruara.
- Monitorim programacioni për të drejtat e transmetimit dhe të drejtat e autorit:
  - për subjekte lokale rreth **420 orë transmetime**,
  - për subjekte lokale që nuk mund të regjistrohen në Studion e Monitorimit **1,080 orë transmetime** (pasqyrim i 17 kërkesave ose 26 ditë regjistrime).

Krahasuar me vitet e mëparshme, të dhënat janë si më poshtë :


#### A. Monitorime edicione lajmesh

| Kategoria e OSHMA-ve | Viti 2015 | Viti 2016 | Viti 2017 | Viti 2018 |
|----------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Televizione          | 900       | 900       | 1,340     | 1500      |
| Radio                | 600       | 600       | 770       | 1000      |




#### B. Monitorime reklamash

| Kategoria e OSHMA-ve           | Viti 2015 | Viti 2016 | Viti 2017 | Viti 2018 |
|--------------------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Subjekte audiovizive kombëtarë | 14,000    | 14,000    | 16,000    | 17,500    |



### ***C. Monitorime për të drejta transmetimi***

| Kategoria e OSHMA-ve          | Viti 2015 | Viti 2016 | Viti 2017 | Viti 2018 |
|-------------------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Televizione lokale            | 1,250     | 3,300     | 6,700     | 1500      |
| Platformat Digitalb dhe Tring |           | 1,250     | 2,100     |           |



Sa i takon monitorimit të edicioneve kryesore informative të OSHMA-ve kombëtare, nga AMA realizohet vlerësimi i një edicioni në ditë, si bartës i linjës editoriale. Të dhënat sasiore të proporcionalitetit kohor në edicionet informative kryesore publikohen rregullisht çdo muaj në website-n e institucionit, në një rubrikë të veçantë. Gjithashtu, dhe në edicionet e Buletinit Periodik të AMA-s ato përfshihen në rubrikë më vete.

Më poshtë po japim të përmbledhura të dhëna nga viti 2018.

#### Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qendrore

##### JANAR 2018

| Subjektet                            | TCH      |        | KLAN     |        | RTSH 1   |        | R.TIRANA |        | TAR      |        | VIZION PLUS |        |
|--------------------------------------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|-------------|--------|
|                                      | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min    | koha/% |
| Presidence                           | 5,25     | 3,79%  | 2,5      | 1,34%  | 9,13     | 3,64%  | 13,08    | 6,62%  | 1,33     | 1,97%  | 5,03        | 1,79%  |
| Kryeministria                        | 16,25    | 11,72% | 40,18    | 21,61% | 29,9     | 11,93% | 38,28    | 19,36% | 8,38     | 12,39% | 47,57       | 16,88% |
| Qeveria                              | 36,15    | 26,07% | 52,02    | 27,98% | 54,53    | 21,76% | 55,55    | 28,09% | 12,42    | 18,35% | 76,4        | 27,11% |
| Parlamenti                           | 17,38    | 12,53% | 16       | 8,61%  | 23,08    | 9,21%  | 18,17    | 9,19%  | 5,58     | 8,25%  | 25,68       | 9,11%  |
| Partia Socialiste                    | 14,45    | 10,42% | 16,78    | 9,03%  | 26,72    | 10,66% | 9,48     | 4,80%  | 6,05     | 8,94%  | 23,8        | 8,45%  |
| Partia Demokratike                   | 41,07    | 29,61% | 54,93    | 29,55% | 76,15    | 30,39% | 41,65    | 21,06% | 24,28    | 35,88% | 78,32       | 27,79% |
| Lëvizja Socialiste për Integrim      | 6,4      | 4,61%  | 0        | 0,00%  | 21,52    | 8,59%  | 16,35    | 8,27%  | 7,45     | 11,01% | 14,35       | 5,09%  |
| Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 0,6      | 0,43%  | 0        | 0,00%  | 3,48     | 1,39%  | 1,37     | 0,69%  | 0,25     | 0,37%  | 0           | 0,00%  |
| Të tjera                             | 1,14     | 0,81%  | 3,5      | 1,88%  | 6,09     | 2,44%  | 0,42     | 0,21%  | 1,93     | 2,86%  | 4,42        | 1,57%  |

##### SHKURT 2018

| Subjektet                            | TCH      |        | KLAN     |        | RTSH 1   |        | R.TIRANA |        | TAR      |        | VIZION PLUS |        |
|--------------------------------------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|-------------|--------|
|                                      | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min    | koha/% |
| Presidence                           | 6,92     | 5,22%  | 15,07    | 8,58%  | 9,58     | 5,27%  | 12,2     | 6,18%  | 3,48     | 5,32%  | 15,68       | 6,25%  |
| Kryeministria                        | 31,67    | 23,90% | 42,85    | 24,42% | 36,47    | 20,05% | 37,08    | 18,77% | 11,62    | 17,74% | 54,95       | 21,90% |
| Qeveria                              | 32,15    | 24,26% | 46,98    | 26,77% | 58,97    | 32,43% | 64,22    | 32,50% | 15,42    | 23,55% | 66,97       | 26,69% |
| Parlamenti                           | 22,38    | 16,89% | 20,07    | 11,43% | 21,83    | 12,01% | 27,45    | 13,89% | 10,32    | 15,76% | 30,52       | 12,16% |
| Partia Socialiste                    | 4,15     | 3,13%  | 4,75     | 2,71%  | 5,9      | 3,24%  | 5,2      | 2,63%  | 2,95     | 4,51%  | 9,48        | 3,78%  |
| Partia Demokratike                   | 25,65    | 19,36% | 42,13    | 24,01% | 39,12    | 21,51% | 39,3     | 19,89% | 16,93    | 25,87% | 60,75       | 24,22% |
| Lëvizja Socialiste për Integrim      | 5,42     | 4,09%  | 3,65     | 2,08%  | 4,52     | 2,48%  | 7,93     | 4,02%  | 3,58     | 5,47%  | 2,9         | 1,16%  |
| Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 3,55     | 2,68%  | 0        | 0,00%  | 5,45     | 3,00%  | 1,2      | 0,61%  | 1,17     | 1,78%  | 0           | 0,00%  |
| Të tjera                             | 0,63     | 0,48%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 1,73     | 0,88%  | 0        | 0,00%  | 4,22        | 1,68%  |

##### MARS 2018

| Subjektet                            | TCH      |        | KLAN     |        | RTSH 1   |        | R.TIRANA |        | TAR      |        | VIZION PLUS |        | CLUB FM  |        |
|--------------------------------------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|-------------|--------|----------|--------|
|                                      | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min    | koha/% | koha/min | koha/% |
| Presidencia                          | 10,82    | 7,36%  | 9,65     | 5,33%  | 10,23    | 4,89%  | 19,15    | 9,57%  | 3,68     | 4,10%  | 11,7        | 4,11%  | 2,5      | 16,83% |
| Kryeministria                        | 21,05    | 14,32% | 37,85    | 20,89% | 37,1     | 18,10% | 43,8     | 21,89% | 13,45    | 14,96% | 62,4        | 21,92% | 2,88     | 19,53% |
| Qeveria                              | 35,27    | 23,89% | 47,58    | 26,26% | 56,37    | 27,51% | 58,58    | 29,28% | 17,87    | 19,87% | 70,33       | 24,70% | 3,1      | 20,99% |
| Parlamenti                           | 15,52    | 10,56% | 14,22    | 7,85%  | 21,4     | 10,44% | 14,98    | 7,49%  | 9,88     | 10,99% | 20,57       | 7,22%  | 0,98     | 6,66%  |
| Partia Socialiste                    | 13,92    | 9,47%  | 15,8     | 8,72%  | 18,67    | 9,11%  | 15,02    | 7,51%  | 10,43    | 11,62% | 17,38       | 6,11%  | 0,48     | 3,27%  |
| Partia Demokratike                   | 41,45    | 28,20% | 53,05    | 29,27% | 39,83    | 19,44% | 39,35    | 19,67% | 28,48    | 31,68% | 79,47       | 27,91% | 3,28     | 22,23% |
| Lëvizja Socialiste për Integrim      | 5,52     | 3,75%  | 1,35     | 0,74%  | 16,08    | 7,82%  | 7,95     | 3,97%  | 4,45     | 4,95%  | 19,02       | 6,68%  | 1,53     | 10,38% |
| Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0,97        | 0,34%  | 0        | 0,00%  |
| Të tjera                             | 3,45     | 2,34%  | 1,72     | 0,95%  | 5,29     | 2,58%  | 1,22     | 0,61%  | 1,65     | 1,83%  | 1,83        | 0,64%  | 0        | 0,00%  |

| PRILL 2018                           |          |        |          |        |          |        |          |        |          |        |             |        |          |
|--------------------------------------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|-------------|--------|----------|
| Subjektet                            | TCH      |        | KLAN     |        | RTSH 1   |        | RTIRANA  |        | TAR      |        | VIZION PLUS |        | CLUB FM  |
|                                      | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min    | koha/% | koha/min |
| Presidenca                           | 6,07     | 4,33%  | 10,48    | 5,00%  | 14,82    | 7,67%  | 8,5      | 4,55%  | 3,85     | 7,03%  | 9,97        | 3,55%  | 1,8      |
| Kryeministria                        | 36,83    | 26,30% | 47,6     | 22,72% | 34,48    | 17,84% | 35,17    | 18,84% | 11,87    | 21,65% | 47          | 16,74% | 3,9      |
| Qeveria                              | 15,82    | 11,29% | 58,58    | 27,97% | 59,58    | 30,83% | 64,67    | 34,64% | 9,33     | 17,03% | 81,63       | 29,08% | 1,35     |
| Parlamenti                           | 9,28     | 6,63%  | 12,07    | 5,76%  | 9,7      | 5,02%  | 15,05    | 8,06%  | 5,52     | 10,07% | 15,22       | 5,41%  | 0,43     |
| Partia Socialiste                    | 8        | 5,71%  | 9,35     | 4,46%  | 14,75    | 7,63%  | 10,3     | 5,52%  | 2,62     | 4,77%  | 20,9        | 7,45%  | 0        |
| Partia Demokratike                   | 50,33    | 35,94% | 64,3     | 30,69% | 38,57    | 19,96% | 37,98    | 20,35% | 14,75    | 26,92% | 91,63       | 32,64% | 3,13     |
| Lëvizja Socialiste për Integrim      | 9,83     | 7,02%  | 0,87     | 0,41%  | 16,48    | 8,53%  | 14,03    | 7,52%  | 6,07     | 11,07% | 10,38       | 3,70%  | 0,98     |
| Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0,35     | 0,19%  | 0        | 0,00%  | 0           | 0,00%  | 0        |
| Të tjera                             | 3,18     | 2,27%  | 6,24     | 2,97%  | 4,87     | 2,52%  | 0,63     | 0,34%  | 0,8      | 1,46%  | 2,03        | 0,72%  | 0,28     |

| MAJ 2018                             |          |        |          |        |          |        |          |        |          |        |             |        |          |
|--------------------------------------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|-------------|--------|----------|
| Subjektet                            | TCH      |        | KLAN     |        | RTSH 1   |        | RTIRANA  |        | TAR      |        | VIZION PLUS |        | CLUB FM  |
|                                      | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min    | koha/% | koha/min |
| Presidenca                           | 2,88     | 1,56%  | 8,15     | 3,12%  | 9,12     | 4,14%  | 7,22     | 4,84%  | 4,2      | 4,76%  | 11,13       | 3,67%  | 0        |
| Kryeministria                        | 39,78    | 21,46% | 58,05    | 22,25% | 37       | 16,79% | 23,17    | 15,53% | 15,53    | 17,62% | 58,05       | 19,15% | 3,22     |
| Qeveria                              | 34,17    | 18,43% | 75,02    | 28,75% | 51,85    | 23,53% | 55,63    | 27,29% | 20,07    | 22,76% | 98,15       | 32,38% | 3,18     |
| Parlamenti                           | 31,42    | 16,95% | 19,43    | 7,45%  | 28,02    | 12,71% | 7,42     | 4,97%  | 11,55    | 13,10% | 22,05       | 7,28%  | 1,57     |
| Partia Socialiste                    | 15,77    | 8,50%  | 23,22    | 8,90%  | 20,37    | 9,24%  | 10,32    | 6,91%  | 5,2      | 5,90%  | 26,53       | 8,75%  | 1,33     |
| Partia Demokratike                   | 54,77    | 29,54% | 75,38    | 28,89% | 57,37    | 26,03% | 35,97    | 24,11% | 26,73    | 30,33% | 78,8        | 26,00% | 4,95     |
| Lëvizja Socialiste për Integrim      | 2,67     | 1,44%  | 0        | 0,00%  | 14,83    | 6,73%  | 8,4      | 5,63%  | 2,82     | 3,20%  | 7,77        | 2,56%  | 1,6      |
| Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0           | 0,00%  | 0        |
| Të tjera                             | 3,63     | 1,96%  | 1,7      | 0,65%  | 1,85     | 0,84%  | 0        | 0,00%  | 2,05     | 2,33%  | 0           | 0,00%  | 0        |

| QERSHOR 2018                         |          |        |          |        |          |        |          |        |          |        |             |        |          |
|--------------------------------------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|-------------|--------|----------|
| Subjektet                            | TCH      |        | KLAN     |        | RTSH 1   |        | RTIRANA  |        | TAR      |        | VIZION PLUS |        | CLUB FM  |
|                                      | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min    | koha/% | koha/min |
| Presidenca                           | 2,1      | 1,74%  | 4,77     | 2,72%  | 2        | 1,82%  | 7,25     | 7,19%  | 3,78     | 5,55%  | 11,63       | 4,78%  | 2,17     |
| Kryeministria                        | 40,58    | 33,58% | 64,33    | 36,74% | 28,38    | 25,80% | 32,2     | 31,94% | 19,6     | 28,75% | 70,38       | 28,93% | 1,97     |
| Qeveria                              | 17,25    | 14,27% | 40,28    | 23,01% | 11,28    | 10,26% | 27,82    | 27,60% | 11,85    | 17,38% | 71,53       | 29,41% | 1,62     |
| Parlamenti                           | 22,62    | 18,71% | 11,57    | 6,61%  | 25,82    | 23,47% | 9,52     | 9,44%  | 7,53     | 11,05% | 27,08       | 11,13% | 0,42     |
| Partia Socialiste                    | 8,97     | 7,42%  | 9,05     | 5,17%  | 7,82     | 7,10%  | 3,38     | 3,36%  | 7,57     | 11,10% | 9,43        | 3,88%  | 2,32     |
| Partia Demokratike                   | 21,62    | 17,89% | 41,22    | 23,54% | 23,95    | 21,77% | 18,08    | 17,94% | 15,92    | 23,35% | 42,75       | 17,57% | 2,88     |
| Lëvizja Socialiste për Integrim      | 2,98     | 2,47%  | 0        | 0,00%  | 4,35     | 3,95%  | 1,87     | 1,85%  | 1,92     | 2,81%  | 8,47        | 3,48%  | 0,43     |
| Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0,68     | 0,68%  | 0        | 0,00%  | 1,98        | 0,82%  | 0        |
| Të tjera                             | 4,73     | 3,92   | 0        | 0      | 6,42     | 5,83   | 0        | 0      | 0        | 0      | 0           | 0      | 0        |

| KORRIK 2018                          |          |        |          |        |          |        |          |        |          |        |             |        |          |
|--------------------------------------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|-------------|--------|----------|
| Subjektet                            | TCH      |        | KLAN     |        | RTSH 1   |        | RTIRANA  |        | TAR      |        | VIZION PLUS |        | CLUB FM  |
|                                      | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min    | koha/% | koha/min |
| Presidenca                           | 4,58     | 4,75%  | 8,77     | 5,14%  | 16,5     | 9,01%  | 6,53     | 4,76%  | 1,05     | 2,16%  | 11,18       | 3,99%  | 1,72     |
| Kryeministria                        | 16,07    | 16,67% | 37,97    | 22,25% | 28,28    | 15,44% | 18,05    | 13,15% | 10,73    | 22,11% | 52,02       | 18,57% | 3,75     |
| Qeveria                              | 21,25    | 22,04% | 44,77    | 26,24% | 46,58    | 25,43% | 46,95    | 34,20% | 8,23     | 16,96% | 94,22       | 33,63% | 2,2      |
| Parlamenti                           | 17,95    | 18,62% | 19,3     | 11,31% | 29,7     | 16,21% | 15,28    | 11,13% | 5,18     | 10,68% | 23,73       | 8,47%  | 0        |
| Partia Socialiste                    | 4,85     | 5,03%  | 9,58     | 5,62%  | 15,28    | 8,34%  | 10,6     | 7,72%  | 4,23     | 8,72%  | 11,47       | 4,09%  | 3        |
| Partia Demokratike                   | 29,88    | 31,00% | 44,87    | 26,30% | 38,38    | 20,96% | 35,38    | 25,78% | 15,67    | 32,27% | 82,17       | 29,33% | 3,78     |
| Lëvizja Socialiste për Integrim      | 1,6      | 1,66%  | 0        | 0,00%  | 5,12     | 2,79%  | 3,22     | 2,34%  | 3,45     | 7,11%  | 3,78        | 1,35%  | 2,2      |
| Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 3,08     | 1,68%  | 1,25     | 0,91%  | 0        | 0,00%  | 0           | 0,00%  | 0,25     |
| Të tjera                             | 0,22     | 0,22%  | 5,36     | 3,13%  | 0,23     | 0,13%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0,68        | 0,24%  | 0        |

**GUSHT 2018**

| Subjektet                            | TCH      |        | KLAN     |        | RTSH 1   |        | R.TIRANA |        | TAR      |        | VIZION PLUS |        | CLUB FM  |        |
|--------------------------------------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|-------------|--------|----------|--------|
|                                      | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min    | koha/% | koha/min | koha/% |
| Presidenca                           | 0,2      | 0,38%  | 3,82     | 3,52%  | 5,52     | 6,13%  | 7,15     | 6,01%  | 1,08     | 4,73%  | 6,48        | 5,35%  | 0,7      | 6,31%  |
| Kryeministria                        | 13,42    | 25,17% | 17,4     | 16,03% | 15,4     | 17,10% | 24,37    | 20,48% | 2,82     | 12,31% | 23,52       | 19,42% | 2,17     | 19,52% |
| Qeveria                              | 5,4      | 10,13% | 32,7     | 30,13% | 21,37    | 23,73% | 14,68    | 12,34% | 3,9      | 17,04% | 33,77       | 27,88% | 0,7      | 6,31%  |
| Parlamenti                           | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 2,05     | 2,28%  | 0,62     | 0,52%  | 0        | 0,00%  | 0           | 0,00%  | 0        | 0,00%  |
| Partia Socialiste                    | 4,08     | 7,66%  | 9,35     | 8,61%  | 7,72     | 8,57%  | 13,38    | 11,25% | 1,35     | 5,90%  | 5,82        | 4,80%  | 0,35     | 3,15%  |
| Partia Demokratike                   | 28,55    | 53,56% | 45,27    | 41,71% | 33,13    | 36,79% | 56,68    | 47,63% | 13,43    | 58,70% | 50,38       | 41,60% | 6,75     | 60,81% |
| Lëvizja Socialiste për Integrim      | 1,65     | 3,10%  | 0        | 0,00%  | 4,87     | 5,40%  | 2,12     | 1,78%  | 0,3      | 1,31%  | 1,13        | 0,94%  | 0,43     | 3,90%  |
| Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0           | 0,00%  | 0        | 0,00%  |
| Të tjera                             | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0           | 0,00%  | 0        | 0,00%  |

**SHTATOR 2018**

| Subjektet                            | TCH      |        | KLAN     |        | RTSH 1   |        | R.TIRANA |        | TAR      |        | VIZION PLUS |        | CLUB FM  |        |
|--------------------------------------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|-------------|--------|----------|--------|
|                                      | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min    | koha/% | koha/min | koha/% |
| Presidenca                           | 0,05     | 0,04%  | 7,12     | 3,83%  | 1,47     | 0,82%  | 9,97     | 5,76%  | 2,33     | 3,41%  | 9           | 3,15%  | 1,52     | 10,13% |
| Kryeministria                        | 24,07    | 17,40% | 41,37    | 22,27% | 31,98    | 17,82% | 28,27    | 16,34% | 15,72    | 22,95% | 36,32       | 12,73% | 3,57     | 23,83% |
| Qeveria                              | 10,25    | 7,41%  | 28,65    | 15,43% | 30,12    | 16,78% | 36,03    | 20,83% | 9,02     | 13,17% | 68,22       | 23,91% | 2,97     | 19,82% |
| Parlamenti                           | 15,05    | 10,88% | 18,82    | 10,13% | 30,13    | 16,79% | 19,53    | 11,29% | 5,33     | 7,79%  | 20,05       | 7,03%  | 0,37     | 2,45%  |
| Partia Socialiste                    | 28,57    | 20,65% | 27,05    | 14,56% | 22,62    | 12,60% | 17,03    | 9,85%  | 10,62    | 15,50% | 28,78       | 10,09% | 2,07     | 13,81% |
| Partia Demokratike                   | 51,17    | 36,99% | 58,05    | 31,25% | 48,08    | 26,79% | 53,32    | 30,82% | 24,38    | 35,60% | 103,48      | 36,27% | 4,13     | 27,62% |
| Lëvizja Socialiste për Integrim      | 2,32     | 1,67%  | 0        | 0,00%  | 1,82     | 1,01%  | 4,28     | 2,48%  | 0,67     | 0,97%  | 14,92       | 5,23%  | 0,35     | 2,34%  |
| Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 3,08     | 2,23%  | 0        | 0,00%  | 11,38    | 6,34%  | 1,6      | 0,92%  | 0,42     | 0,61%  | 0           | 0,00%  | 0        | 0,00%  |
| Të tjera                             | 3,77     | 2,72%  | 4,69     | 2,53%  | 1,9      | 1,06%  | 0,83     | 0,48%  | 0        | 0,00%  | 4,57        | 1,60%  | 0        | 0,00%  |

**TETOR 2018**

| Subjektet                            | TCH      |        | KLAN     |        | RTSH 1   |        | R.TIRANA |        | TAR      |        | VIZION PLUS |        | CLUB FM  |        |
|--------------------------------------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|-------------|--------|----------|--------|
|                                      | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min    | koha/% | koha/min | koha/% |
| Presidenca                           | 4,8      | 2,49%  | 6,38     | 3,20%  | 11,07    | 4,83%  | 7,57     | 3,38%  | 1,17     | 1,35%  | 11,75       | 3,20%  | 1,92     | 10,04% |
| Kryeministria                        | 46,45    | 24,11% | 53,73    | 26,91% | 40,8     | 17,80% | 48       | 21,45% | 16,4     | 19,01% | 54,62       | 14,90% | 4,38     | 22,97% |
| Qeveria                              | 24,13    | 12,52% | 35,43    | 17,74% | 54,73    | 23,88% | 51,12    | 22,85% | 11,43    | 13,25% | 89,55       | 24,42% | 2,63     | 13,80% |
| Parlamenti                           | 18,98    | 9,85%  | 10,5     | 5,26%  | 23,45    | 10,23% | 21,68    | 9,69%  | 8,77     | 10,16% | 17,2        | 4,69%  | 0,58     | 3,06%  |
| Partia Socialiste                    | 30,68    | 15,92% | 28,78    | 14,41% | 30,35    | 13,24% | 22,78    | 10,18% | 1,6      | 18,55% | 59,62       | 16,26% | 3,28     | 17,21% |
| Partia Demokratike                   | 63,15    | 32,77% | 62,18    | 31,14% | 57,02    | 24,87% | 61,67    | 27,56% | 28,55    | 33,10% | 116,32      | 31,73% | 6,03     | 31,62% |
| Lëvizja Socialiste për Integrim      | 1,58     | 0,82%  | 0        | 0,00%  | 7,98     | 3,48%  | 6,83     | 3,05%  | 2,42     | 2,80%  | 7,87        | 2,15%  | 0,25     | 1,31%  |
| Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 3,83     | 1,67%  | 3,02     | 1,35%  | 0        | 0,00%  | 0           | 0,00%  | 0        | 0,00%  |
| Të tjera                             | 2,9      | 1,51%  | 2,68     | 1,35%  | 0        | 0,00%  | 0,28     | 0,13%  | 1,53     | 1,78%  | 9,72        | 2,65%  | 0        | 0,00%  |

**NËNTOR 2018**

| Subjektet                            | TCH      |        | KLAN     |        | RTSH 1   |        | R.TIRANA |        | TAR      |        | VIZION PLUS |        | CLUB FM  |        |
|--------------------------------------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|-------------|--------|----------|--------|
|                                      | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min    | koha/% | koha/min | koha/% |
| Presidenca                           | 28,5     | 17,24% | 28,13    | 15,23% | 23,28    | 10,53% | 28,37    | 12,78% | 9,53     | 9,85%  | 34,23       | 10,57% | 3,67     | 22,45% |
| Kryeministria                        | 45,85    | 27,74% | 50,67    | 27,44% | 41,55    | 18,80% | 44,6     | 20,10% | 42,43    | 43,82% | 61,27       | 18,92% | 4,45     | 27,24% |
| Qeveria                              | 19,55    | 11,83% | 29,67    | 16,06% | 50,38    | 22,79% | 53,27    | 24,00% | 14,62    | 15,09% | 60,8        | 18,78% | 2,63     | 16,12% |
| Parlamenti                           | 25,07    | 15,16% | 13,32    | 7,21%  | 37,55    | 16,99% | 24,27    | 10,93% | 4,25     | 4,39%  | 24,05       | 7,43%  | 0        | 0,00%  |
| Partia Socialiste                    | 5,77     | 3,49%  | 13,65    | 7,39%  | 18,08    | 8,18%  | 10,67    | 4,81%  | 4,82     | 4,97%  | 33,62       | 10,38% | 2,35     | 14,39% |
| Partia Demokratike                   | 32,97    | 19,94% | 46,32    | 25,08% | 44,43    | 20,10% | 49,33    | 22,23% | 18,83    | 19,45% | 92,68       | 28,62% | 2,87     | 17,55% |
| Lëvizja Socialiste për Integrim      | 5,35     | 3,24%  | 0        | 0,00%  | 3,4      | 1,54%  | 8,93     | 4,03%  | 1,4      | 1,45%  | 15,3        | 4,72%  | 0,37     | 2,24%  |
| Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 2,08     | 0,94%  | 0,77     | 0,35%  | 0,62     | 0,64%  | 0           | 0,00%  | 0        | 0,00%  |
| Të tjera                             | 2,26     | 1,35%  | 0        | 0,00%  | 0,28     | 0,26%  | 1,05     | 0,47%  | 0,33     | 0,34%  | 0           | 0,00%  | 0        | 0,00%  |

**DHETOR 2018**

| Subjektet                            | TCH      |        | KLAN     |        | RTSH 1   |        | R.TIRANA |        | TAR      |        | VIZION PLUS |        | CLUB FM  |        |
|--------------------------------------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|----------|--------|-------------|--------|----------|--------|
|                                      | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min | koha/% | koha/min    | koha/% | koha/min | koha/% |
| Presidenca                           | 4,73     | 3,05%  | 12,45    | 6,42%  | 11,42    | 5,82%  | 10,82    | 6,10%  | 2,28     | 3,47%  | 10,22       | 3,38%  | 2,5      | 15,46% |
| Kryeministria                        | 42,17    | 27,16% | 56,55    | 29,16% | 34,25    | 17,45% | 40       | 22,55% | 20       | 30,40% | 63,98       | 21,18% | 5,55     | 34,33% |
| Qeveria                              | 16,5     | 10,63% | 30,45    | 15,70% | 32,62    | 16,62% | 40,4     | 22,77% | 5,68     | 8,64%  | 54,07       | 17,90% | 1,13     | 7,01%  |
| Parlamenti                           | 20,92    | 13,47% | 15,3     | 7,89%  | 22,7     | 11,57% | 12,68    | 7,15%  | 6,27     | 9,52%  | 21,18       | 7,01%  | 0        | 0,00%  |
| Partia Socialiste                    | 19,8     | 12,75% | 15,72    | 8,11%  | 19,78    | 10,08% | 6,08     | 3,43%  | 8,87     | 13,48% | 33,87       | 11,21% | 0,73     | 4,54%  |
| Partia Demokratike                   | 43,62    | 28,09% | 58,42    | 30,13% | 57,13    | 29,11% | 41,47    | 23,37% | 16,03    | 24,37% | 85,27       | 28,23% | 5,95     | 36,80% |
| Lëvizja Socialiste për Integrim      | 7,52     | 4,84%  | 0        | 0,00%  | 14,6     | 7,44%  | 20,5     | 11,56% | 6,67     | 10,13% | 22,65       | 7,50%  | 0,3      | 1,86%  |
| Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 0           | 0,00%  | 0        | 0,00%  |
| Të tjera                             | 0        | 0,00%  | 5,02     | 2,59%  | 3,76     | 1,92%  | 0        | 0,00%  | 0        | 0,00%  | 10,2        | 3,38%  | 0        | 0,00%  |

### 7.3 Përqasja ndaj fenomenit të piraterisë në transmetimet audiovizive

Gjatë vitit të raportimit, AMA ka vijuar monitorimin dhe inspektimin e veprimtarive audiovizive, si në terren, ashtu në distance, nga studio e monitorimit.

Në lidhje me veprimtarinë inspektuese, në mënyrë të veçantë, AMA është fokusuar në luftën kundër piraterisë që kryhet përmes internetit. Duke pasur parasysh ndryshimet e vazhdueshme teknologjike dhe shtimin e formave të reja të piraterisë në rrjetin e internetit, përmes portaleve, faqeve apo aplikacioneve të ndryshme online, AMA ka zhvilluar një sërë takimesh, pranë ambienteve të saj, me përfaqësues të AKEP, si institucioni kryesor që autorizon dhe monitoron aktivitetet në rrjetin e internetit, por edhe me përfaqësues të palëve të interesuara, prodhues dhe përdorues të produkteve dhe të drejtave televizive, si Digitalb, Tring, Albtelecom dhe ABCom.

Me fokus në kërkesat dhe shqetësimet e operatorëve në fjalë, AMA dhe AKEP nisën punën për hartimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi, me qëllim përcaktimin e procedurave dhe krijimin e një marrëdhënie bashkëpunimi konstante dhe intensive, e cila do të ishte përtej bashkëpunimit të zakonshëm ndër-institucional. Por pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të AMA-s, AKEP e shprehu gadishmërinë e vet për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje vetëm në janar 2019, por edhe kësaj here, ndryshimet dhe sugjerimet e AKEP mbi mënyrën e zbatimit të marrëveshjes e bënë atë të pazbatueshme dhe joefikase për qëllimin e dakordësuar nëpër takimet e zhvilluara.

Pavarësisht kësaj, nisur edhe nga rekomandimet e Kuvendit, AMA ka bërë verifikimin e çdo ankese të ardhur pranë saj nga subjektet e interesuara (Tring, Digitalb, ABCom dhe Albtelecom), duke përcjellë më pas në AKEP kërkesat për mbylljen e të paktën 150 ofruesve të shërbimit internet, përmes të cilëve ushtrohej aktivitet audioviziv pirat, i paautorizuar.

Komunikimi me AKEP për ndalimin e piraterisë online ka nisur që në maj, për t'u intensifikuar më pas në muajt nëntor-dhjetor, kur janë dërguar 5 kërkesa për ndalim të piraterisë online, të kryer nga ofrues të shërbimit audioviziv në internet.

Duhet theksuar se AKEP në asnjë rast nuk ka kthyer përgjigje konkrete mbi masat konkrete të marra, por nga verifikimet e mëpasshme të kryera nga specialistët e AMA-s, është konstatuar mbyllja e ofruesve të shërbimit audioviziv në internet, përmes të cilëve ushtrohej aktivitet pirat, i paautorizuar.

Njëkohësisht, përmes grupeve të inspektimit, AMA ka bërë vetë verifikimin dhe identifikimin e aktiviteteve audiovizive të paligjshme, që kryheshin përmes internetit nga subjekte ISP. Gjatë periudhës së raportimit janë proceduar:

- 4 subjekte iptv të paligjshëm me dënim me gjobë prej 5.000.000 lekë secili;
- 1 subjekt iptv/ott të paligjshëm me sekuestrim pajisjesh audiovizive.

Duke pasur parasysh se ky lloj aktiviteti ushtrohet nga subjekte ISP të autorizuar nga AKEP për ofrimin e shërbimit të aksesit në internet, AMA i ka kërkuar AKEP krijimin e grupeve të përbashkëta kontrolli, me qëllim verifikimin e aktiviteteve të tyre dhe eventualisht, identifikimin e piraterisë televizive të ushtruar përmes këtyre rrjeteve. Për këtë, AKEP ka shprehur gatishmërinë e vet dhe bashkëpunimi ka filluar të konkretizohet prej muajit shkurt 2019, me kontrolle të përbashkëta.

Për vitin 2019, AMA parashikon të forcojë akoma edhe më shumë luftën kundër kësaj dukurie, duke planifikuar kontrolle të vazhdueshme në të gjithë territorin e vendit, në bashkëpunim me AKEP, por edhe me institucionet e tjera, të Policisë së Shtetit, etj.

Përverç fenomenit të piraterisë online përmes internetit, AMA ka mbikëqyrur edhe veprimtarinë audiovizive të subjekteve të autorizuar prej saj për ofrim shërbimi audioviziv, të mbështetur në rrjete kabllore. Për këtë lloj aktiviteti, gjatë periudhës së raportimit është vënë re një ndryshim i rëndësishëm i sjelljes së këtyre operatorëve në treg.

AMA, me vendimin nr. 182 datë 06.09.2016, ka vendosur “Kalimin në transmetime digjitale të subjekteve të autorizuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv mbështetur në rrjet kabllorë”. Afati i fundit i lënë për kalim ishte data 31.12.2017.

Nisur nga sa më sipër, duke pasur parasysh fillimin e efekteve juridike dhe financiare të këtyre dy vendimeve, por duke pasur parasysh edhe:

- Se kalimi i transmetimeve kabllorë nga analoge në dixhitale diktonte investime të konsiderueshme në rrjetet e tyre;
- rritjen e tarifës së autorizimit që duhej paguar për një vit;
- kërkesave të vazhdueshme të AMA-s për respektimin e të drejtave të transmetimit dhe, për rrjedhojë, moslejimin e transmetimeve të kanaleve që subjektet kabllorë transmetonin pa pagesë, duke eliminuar konkurrencën e pandershme;

gjatë vitit 2018 u vu re një tkurrje e kabllorëve, për sa i përket numrit të tyre. Kështu, nëse në fund të vitit 2017 numëroheshin 88 subjekte kabllorë, nga këta në fund të vitit 2018, numëroheshin 72. AMA gjatë vitit 2018 dha 4 autorizime të reja, duke bërë që numri i subjekteve kabllorë në fund të vitit 2018 të jetë 76.

Në krahasim me vitin 2017, gjatë të cilit AMA miratoi heqjen e autorizimeve për 13 subjekte kabllorë, gjatë vitit 2018 numri i autorizimeve të hequra shkoi në 16.

Por, vlen të theksohet se, në vitin 2017, ndër 13 vendime për heqje autorizimi, kemi:

- 2 vendime për mosrinovim autorizimi për shkak se subjekte ishin dënuar vazhdimisht për pirateri;
- 2 vendime për heqje autorizimi për shkak të mospagimit të taksës ndaj AMA-s;
- 2 vendime për shkak të heqjes dorë nga autorizimi nga vetë subjektet;
- 1 vendim për shkak të kalimit të të drejtave nga një subjekt te një tjetër;
- 6 vendime për shkak të bashkimit me subjekte të tjerë për mbulimin e zonës së autorizimit.

Kurse në vitin 2018 është rritur ndjeshëm fenomeni i heqjes dorë nga autorizimi dhe bashkimi me subjekte të tjerë për mbulimin e zonës së autorizimit. Kështu, ndër 16 vendime për heqjen e autorizimeve për gjatë këtij viti, kemi:

- 1 vendim për heqje autorizimi për shkak të mospagimit të taksës ndaj AMA-s;
- 2 vendime për shkak të kalimit të të drejtave nga një subjekt te një tjetër;
- 1 vendim për shkak të heqjes dorë nga autorizimi nga vetë subjekti;
- 12 vendime për shkak të bashkimit me subjekte të tjerë për mbulimin e zonës së autorizimit.

Së fundmi, theksohet se, pavarësisht rënies së numrit të kabllorëve, asnjë prej zonave që kanë mbuluar subjektet të cilëve iu është hequr autorizimi, në mënyrë ose tjetrën, nuk ka mbetur pa mbulim nga një apo disa subjekte të tjerë.

## **8 KËSHILLI I ANKESAVE**

### ***Shqyrtimi i Ankesave***

Përgjatë vitit 2018, në përmbushje të detyrave, angazhimeve dhe objektivave të përcaktuara, Këshilli i Ankesave ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Transmetimit dhe të rregulloreve të miratuara nga AMA, si dhe ka shqyrtuar me rigorozitet dhe profesionalizëm ankesat e adresuara në AMA.

Këshilli i Ankesave ka trajtuar dhe propozuar masat përkatëse për dhjetëra ankesa të ardhura nga qytetarë, institucione dhe organizata të ndryshme, mbi probleme të evidentuara në përmbajtjet audiovizive. Pjesa më e madhe e shqetësimeve dhe ankesave të adresuara kishin në fokus çështje për shkeljen e të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm ankesash u regjistruan edhe për shkelje të dinjitetit në transmetimet audiovizive. Në tërësi, Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar rreth 50 ankesa përgjatë vitit 2018, pjesa më e madhe e të cilave janë dërguar pranë Autoritetit nga individë.

Përgjatë vitit raportues, disa çështje janë iniciuar kryesisht nga Këshilli i Ankesave, pas monitorimit dhe vëzhgimit të përmbajtjeve audiovizive në raport me respektimin e normave ligjore dhe etike. Shkeljet kryesore të konstatuara, dhe për të cilat u propozuan masa ligjore, lidhen kryesisht me mosrespektimin e parimeve të Kodit të Transmetimit gjatë kronikave për fëmijët dhe rreth fëmijëve, intervistimit të tyre; shkeljen e të drejtave të njeriut dhe cenimin e dinjitetit të tyre; transmetimin e reklamave të ndaluara me ligj, të reklamave të fshehta, transmetimin e përmbajtjeve të papërshtatshme etj.

### ***Miratimi i udhëzimit për shqyrtimin e ankesave***

Përgjatë vitit 2018 u përmbyll i gjithë kuadri nënligjor i kërkuar nga Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që ka të bëjnë me punën e Këshillit të Ankesave. Pas miratimit, në fund të vitit 2017, të rregullores “Mbi procedurat për trajtimin e ankesave dhe për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes”, në maj 2018 u miratua edhe udhëzimi “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA)”. Miratimi i udhëzimit erdhi gjithashtu në vijim të përmbushjes së detyrave të parashikuara në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) për vitin 2017”.

Në pikën 10 të kësaj Rezolute, Kuvendi nxiti dhe kërkon nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, për vitin 2018, “ritjen e efikasitetit në shqyrtimin e ankesave të ardhura nga qytetarët dhe institucionet për shkelje të parimeve të mbrojtjes së interesit publik, respektimit të dinjitetit të individëve dhe rregullave që parashikohen në Kodin e Transmetimit, shtimin e organizimit të tryezave tematike, si dhe të dëgjësive me grupe të ndryshme interesi për njohjen me përmbajtjen e Kodit të Transmetimit dhe ndërgjegjësimin e respektimit të tij”.

Më hyrjen në fuqi të udhëzimit, Këshilli i Ankesave u ka kërkuar zyrtarisht të gjithë OSHMA-ve ngritjen e Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave. Në të njëjtën kohë, po ndjek nga afër procesin e ngritjes së këtyre Bordeve, me të cilët u realizua edhe Tryezë Diskutimi, me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë.



Aktualisht, Televizionet kombëtare dhe rajonale kanë ngritur Bordet e Shqyrtimit të Ankesave dhe Këshilli i Ankesave ka inkurajuar Bordet e krijuara tashmë që të bëhen pjesë aktive e shqyrtimit të ankesave. Disa prej Bordeve janë krijuar dhe janë në funksion të shqyrtimit të ankesave të qytetarëve, organizatave apo institucioneve të ndryshme. Fillimi duket premtues, por gjithsesi Këshilli i Ankesave do të vijojë edhe në të ardhmen me ndjekjen nga afër të këtij procesi të rëndësishëm.

Duhet theksuar se, përmbyllja e këtyre akteve, ndjekja e tyre, ka përmirësuar, nga pikëpamja procedurale dhe profesionale, trajtimin e ankesave. Përfshirja e OSHMA-ve në këtë proces dhe paraqitja nga ana e tyre e pretendimeve për ankesat ndaj tyre, e ka ndihmuar gjithë procesin e shqyrtimit të ankesave dhe ka ndihmuar gjithashtu edhe në sensibilizimin e OSHMA-ve për zbatimin e normave dhe kërkesave ligjore dhe etike.

### ***Tryeza dhe konferenca***

Në përmbushje të objektivave të caktuara, veç detyrave të përditshme të marrjes dhe trajtimit të ankesave, në zbatim të Strategjisë së Komunikimit, si një nga prioritetet, dhe të detyrave të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ankesave ka qenë aktor dhe ka kontribuar në disa aktivitete të përbashkëta me partnerë institucionalë dhe ndërkombëtarë, si OSBE, KiE etj.

Gjatë vitit 2018, Këshilli i Ankesave ka organizuar tre konferenca dhe tryeza, me pjesëmarrjen dhe kontributin e figurave të njohura të jetës akademike, universitare, të medias, publikut dhe të shoqërisë civile. Këto konferenca trajtuan tema të rëndësishme, njëherazi dhe shqetësuese në transmetimet audiovizive, si mbrojtja e fëmijëve, edukimi për median dhe gjuha e urrejtjes.

Në janar të vitit 2018, Këshilli i Ankesave organizoi Tryezën e Rrumbullakët, me temë “Mbrojtja e fëmijëve në shërbimet e medias audiovizive - sfidat drejt së ardhmes”.

Pjesë e kësaj Tryeze ishin përfaqësues të televizioneve, Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, organizmave ndërkombëtarë, Institutit Shqiptar të Medias, studentë të gazetarisë etj.

Tryeza në fjalë, që u organizua menjëherë pas rishikimit të Kodit të Transmetimit, synoi të promovojë kulturën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në transmetimet audiovizive e të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe të të gjithë aktorëve të interesuar mbi këtë çështje. Rekomandimet e tryezës iu përcollën redaksive, gazetarëve dhe editorëve, në mënyrë që të kenë parasysh rregullat etike, dhe nga ana tjetër, të jetë objektiv trajnimi i vazhdueshëm të gazetarëve për ligjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve dhe normat apo parimet etike.

Në maj 2018, Këshilli i Ankesave organizoi Tryezën e Rrumbullakët “Edukimi për Median - Koordinimi dhe sinergjitë mes palëve për një komunikim të përgjegjshëm etik”.

Pjesë e këtij diskutimi të gjerë ishin anëtarë të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, përfaqësues të televizioneve, organizmave ndërkombëtarë, Institutit Shqiptar të Medias, studentë të gazetarisë etj.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi konceptin se çfarë në thelb është edukimi mediatik dhe sa na shërben ai. Nxitja e iniciativave të ndryshme për edukimin e publikut nga dukuria e lajmeve të rreme, si dhe nevoja e përfshirjes së Edukimit për Median si lëndë më vete në kurrikulat mësimore u konsideruan nga pjesëmarrësit nevojë emergjente që mund të vetërregullojë në mënyrë të drejtë dhe profesionale efektet e medias në shoqëri dhe sidomos të fëmijëve.

Në nëntor 2018, Këshilli i Ankesave organizoi konferencën “Gjuha e urrejtjes në mediat audiovizive”. Në konferencë, ndër të tjerë, kontribuan 6 ekspertë të njohur të medias, të cilët prezantuan studimet dhe gjetjet e tyre për këtë dukuri në median dhe shoqërinë shqiptare.

Qëllimi i konferencës ishte skanimi i situatës përmes prezantimeve të studiuesve dhe ekspertëve të fushës, të cilët ndanë pikëpamjet e tyre analitike në lidhje me gjuhën e urrejtjes në mediat audiovizive, temë kjo që ka tërhequr vëmendjen e katedrave të shumta. Prezantimet dhe studimet e kësaj konferencë do të botohen përgjatë këtij viti në një broshurë, siç u botua gjatë vitit 2018 edhe revista “Fake News”, një përmbledhje e konferencës që zhvilloi AMA po me këtë temë.

Përpos këtyre organizimeve, Këshilli i Ankesave ka vijuar takimet e tij me aktorë të ndryshëm të shoqërisë, për t’u shpjeguar rolin dhe detyrat e tij, në mbrojtje të parimeve themelore të sanksionuara nga Kodi i Transmetimit. Këto takime e përpjekje kanë shërbyer për të sensibilizuar shoqërinë që të adresojnë ankesat dhe shqetësimet e tyre, si dhe për të ndërgjegjësuar operatorët audiovizivë mbi respektimin e normave dhe parimeve të sanksionuara nga ligji.

Përgjatë vitit 2018, Këshilli i Ankesave ka qenë pjesëmarrës në disa tryeza të iniciuara nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile që kanë të bëjnë me lirinë e medias, antidiskriminimin apo respektimin e etikës. Anëtarët e Këshillit të Ankesave morën pjesë në takimet e organizuara nga Instituti Shqiptar i Medias dhe Këshilli i Medias për diskutimin e Kodit të Etikës.

### ***Gjuha e shenjave në transmetimet audiovizive***

Këshilli i Ankesave ka iniciuar një kërkesë për të gjithë operatorët kombëtarë që të përmbushin detyrimin ligjor për informim në gjuhën e shenjave. Përveç operatorit publik kombëtar, 3 operatorët e tjerë kombëtarë nuk e kanë respektuar ende këtë detyrim ligjor për të pasur një edicion informativ të transmetuar me gjuhën e shenjave për “komunitetet me nevojë të veçanta shqisore” (“Komunitet me mangësi të pjesshme ose të plotë shikimi ose dëgjimi, aftësia e të cilëve për të perceptuar sinjale audio apo audiovizive është e kufizuar në atë masë që bën të pamundur gëzimin e të drejtës së informimit” - Ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kapitulli “Përkufizime”, pika 10). Këshilli i Ankesave po e ndjek në vijimësi zbatimin e kësaj norme ligjore.

### ***Buletini i Ankesave***

Gjatë periudhës raportuese, Këshilli i Ankesave hartoi dhe publikoi Buletinin nr. 4, që përmban ankesat e ardhura deri në muajin qershor 2018, ndërkohë që është drejt fundit procesi për hartimin dhe publikimin e Buletinit nr. 5, që reflekton të gjitha rastet e shqyrtuara për periudhën korrik-dhjetor 2018. Në Buletinin nr. 4 janë trajtuar dhe pranuar 14 ankesa nga qytetarë dhe institucione publike. Në Buletinin nr. 5 do të jenë mbi 30 ankesa të shqyrtuara dhe disa ankesa të rrëzuara nga Këshilli i Ankesave.

Në Buletinin nr.4, që gjendet në faqen e internetit të AMA-s ([ama.gov.al](http://ama.gov.al)) janë publikuar shqyrtimet dhe masat përkatëse mbi ankesat e adresuara në AMA, kryesisht për cenim dinjiteti, shkelje të të drejtave të fëmijëve, reklamat e ndaluara etj. Mendojmë se ky Buletin, por edhe të tjerët, shërbejnë si udhërrëfyes për çdo OSHMA që mund të përballlet në të ardhmen me raste të ngjashme.

Këshilli i Ankesave çmon se, publikimi i çdo ankese të trajtuar ka nxitur ndërgjegjësimin e OSHMA-ve në përmirësimin e standardeve mbi zbatimin e Kodit të Transmetimit, por dhe të individëve, agjencive, institucioneve dhe organizatave të ndryshme për të referuar në AMA shkelje të pretenduara të Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit.

## 9 AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMËRISË LIGJORE

### 9.1 Referencat ligjore mbi të cilat mbështetet aktiviteti i institucionit

Kuadri ligjor bazë, që rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, publike e private, në Republikën e Shqipërisë, mbështetet në Ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë dhe zbatim të tij. Ky ligj është tërësisht i përafëruar me direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë”, dhe me standardet evropiane dhe ato ndërkombëtare. Fusha e zbatimit të tij përfshin transmetimet lineare e ato jo lineare dhe është në një linjë me direktivat e rrjeteve të komunikimeve elektronike, shërbimet e reja të programeve, si dhe shërbimet e mbrojtura.

AMA menaxhon burimet e financimit bazuar në Ligjin nr. 97/2013, i ndryshuar; Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligjin nr.7703 datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr.10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura, të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të shërbimit informativ të shtetit, të policisë së burgjeve, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të këtyre ligjeve.

Kriteret e punësimit në administratën e AMA-s bëhen sipas përcaktimeve të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Baza ligjore për administrimin dhe planifikimin e frekuencave për shërbimet audio/audiovizive, përveç ligjit bazë, është përkatësisht:

- Ligji 9851, datë 26.12.2007 “Për ratifikimin e akteve finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve për planifikimin e shërbimit të transmetimit numerik tokësor në pjesë të Rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekencës 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC 06) dhe të akteve finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve për rishikimin e marrëveshjes së Stokholmit, 1961 (RRC-06 Rev. ST 61), të zhvilluar në Gjenevë, 15 maj-16 qershor 2006”.
- Plan i Kombëtar i Frekuencave, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 29.03.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.

Një tjetër akt që përcakton dhe rregullon hapat për procesin e digjitalizimit është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012 “Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike”.

Ndërkohë vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 3.6.2015 “Për miratimin e rregullave teknike për aparatet marrëse televizive, që do të vendosen në treg”, përcakton kërkesat/specifikat e detajuara për veprimtarinë e vendosjes në treg, lëvizjes së lirë dhe vënies në shërbim të aparateve marrëse televizive në Republikën e Shqipërisë.

## **9.2 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA.**

Në këndvështrimin e kompetencës së AMA-s, si rregullator i tregut mediatik për të hartuar akte nënligjore në zbatim të ligjit, edhe përgjatë këtij viti është punuar për hartimin apo ndryshimin e rregulloreve, me qëllim që brenda kuadrit ligjor të mbështetet dhe lehtësohet veprimtaria e subjekteve të fushës. Legjislacioni dytësor është plotësuar në respekt të afateve të miratuara në Planin e Veprimit të Dokumentit Strategjik të AMA-s. Gjatë vitit 2018 janë miratuar 4 akte nënligjore, nga të cilat 3 janë rregullore dhe një akt nënligjor, udhëzim.

Projekt-aktet pas hartimit të tyre i janë nënshtruar konsultimit publik, detyrim ky që rrjedh prej nenit 48 të ligjit organik, sipas të cilit: *“AMA, në procesin e përgatitjes së dokumenteve rregullatore, sipas kërkesave të këtij ligji, dhe përpara marrjes së vendimeve, të cilat kanë një ndikim të ndjeshëm në ofrimin e shërbimeve audio dhe audiovizive, është i detyruar të marrë dhe të vlerësojë mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet këshillimit publik”*.

Ky proces këshillimi publik, përkundër zbatimit të një norme ligjore, ka patur si qëllim tërheqjen e mendimeve dhe sugjerimeve të grupeve të interesit në drejtim të përmirësimit të përmbajtjes së dokumenteve rregullatore.

Ligji organik mbi të cilin mbështetet veprimtaria administrative e autoritetit raportues, përgjatë vitit 2018, nuk ka pësuar shtesa apo ndryshime. Gjatë kësaj periudhe, përmes legjislacionit sekondar është plotësuar kuadri ligjor me akte rregullatore që synojnë krijimin e një mjedisi rregullator që lehtëson zhvillimin e sektorit të transmetimeve audiovizive.

Aktet që janë miratuar dhe janë bërë pjesë e kuadrit ligjor të deritanishëm:

- *Rregullore “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare. Format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e tyre”*, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 42, datë 19.03.2018. Miratimi nga AMA i kësaj rregulloreje erdhi pas një procesi të gjatë pune, konsultimesh me ekspertë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Përfaqësuese për lirinë e medias (OSBE) dhe duke marrë në të njëjtën kohë edhe mendimet e subjekteve të fushës. Ky akt, për nga rëndësia që kanë reklamat në ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve audio/audiovizive, ka ndikim të gjerë në aktivitetin e tyre tregtar. Në të përcaktohen kushtet dhe kërkesat për mbrojtjen e konsumatorit dhe sidomos fëmijëve, respektimin e rregullave të etikës në përmbajtjen dhe mënyrën e transmetimit të reklamave dhe komunikimeve tregtare.

- Rregullore “Mbi kriteret e ofrimit të shërbimeve të mbrojtura”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 68, datë 20.04.2018. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për ofrimin e shërbimeve me akses të kushtëzuar, për të siguruar lëvrimin e shërbimeve të mbrojtura tek abonentët me cilësi, në kushte të ndershme, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.
- Udhëzimi “Për format dhe kategoritë e programeve për regjistrim dhe arkivim nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA)”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 121, datë 08.06.2018. Në këtë akt përcaktohen procedurat dhe rregullat që duhet të ndiqen për regjistrimin dhe arkivimin e programeve të transmetuara nga ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv.
- Rregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 41 datë 12.03.2018. Qëllimi i këtij akti nënligjor është përcaktimi i procedurave të monitorimit të spektrit të frekuencave, duke synuar që spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme.

Një tjetër akt nënligjor, miratimi i të cilit është rekomanduar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, është vendimi për miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e AMA-s, nr. 209, datë 16.09.2016 “Për miratimin e rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive”. (Vendimi nr. 120, datë 08.06.2018). Në këtë akt përcaktohen parimet dhe rregullat e zbatueshme nga Autoriteti në rastet e shqyrtimit të ankimeve administrative nga subjektet e ndëshkuara me sanksione.

### **9.3 Nevoja për ndryshime të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit.**

AMA, në ushtrim të detyrave të tij funksionale, ka konstatuar rregullime në kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë, që rregullojnë fusha të tjera veprimtarie dhe që ngarkojnë me detyrime edhe subjektet e fushës audiovizive duke evidentuar edhe nevojën për ndryshime legislative.

Kështu, diktuar prej problematikave kryesisht në aspektin social dhe ekonomik, AMA ka propozuar dhe sugjeruar ndryshime në Ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky akt ligjor përveç rregullimit të kushteve dhe kriterëve të kategorive të lojërave të fatit të lejuara, parashikon edhe rregulla për publicitetin/reklamën e lojërave të fatit, edhe në median elektronike dhe audiovizive.

AMA me shkresën nr. 4097 prot., datë 12.10.2018, ka propozuar që kushtet e publicitetit/reklamës së lojërave të fatit të përfshihen në dispozitat e Ligjit nr. 97/2013, duke përcaktuar kufizimet në transmetimin e tyre, si dhe masat përkatëse administrative. Referuar rregullimit ligjor në fuqi lidhur me reklamën për lojërat e fatit, AMA-s nuk i është dhënë asnjë tagër konkret, pavarësisht se OSHMA-të (audio, audioviziv, internet tv) licencohen/autorizohen prej këtij Autoriteti dhe veprimtaria e tyre monitorohet prej AMA-s, duke u pasuar me vakum/boshllëk në ushtrimin e funksioneve të AMA-s në këtë sferë, por edhe në përmbushjen e detyrimeve të transmetuesve radio e televizive apo subjekteve të tjera audiovizive.

Po ashtu, AMA me shkresën nr. 2063 prot., datë 03.05.2018, kërkoi nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ndryshimin e nenit 5 të Ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të pavarura të krijuara me ligj” të ligjit nr. 9584/2006, lidhur me masën e shpërblimit të anëtarëve të organit kolegjal, duke vlerësuar se ky përcaktim ligjor lidhur me masën e shpërblimit të anëtarëve të

Këshillit nuk është në përputhje me funksionet dhe qëllimet e veprimtarisë së AMA-s dhe duke kërkuar rishikimin e tyre. AMA propozoi që masa e shpërblimit të anëtarëve të AMA-s të ndryshojë nga 20% në 50% të pagës së Kryetarit të AMA-s, duke e vlerësuar këtë ndryshim në favor të rritjes së pavarësisë financiare dhe përshtatshmërisë së burimeve. Qëllimi i ndryshimit të propozuar është forcimi i rolit mbikëqyrës dhe rregullator të AMA-s, nëpërmjet forcimit të pavarësisë financiare. Në përgjigje të kërkesës sonë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë thekson se përqindja e masës së shpërblimit të propozuar për ndryshim duhet argumentuar duke mbajtur në konsideratë edhe masën e shpërblimit të organeve të tjera kolegjiale të së njëjtës natyrë, duke e lënë këtë nismë në stad propozimi.

Direktiva 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë”, ka pësuar ndryshime në fund të vitit 2018. Këto ndryshime përfshijnë ndër të tjera disa rregullime të reja që synojnë mbrojtjen më të mirë të të miturve; ndryshime në rregullat e komunikimeve me natyrë tregtare, rregulla të reja për platformat online, promovimin e punëve evropiane, etj.

Në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, harmonizimi i legjislacionit të fushës audiovizive me “*acquis communautaire*” është detyrim për Shqipërinë. Në këto kushte, prioriteti i ardhshëm do të jetë transpozimi i ndryshimeve të miratuara në legjislacionin e brendshëm kombëtar me qëllim përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis* të BE-së. Paralelisht me zërvendimin e ndryshimeve të direktivës 2010/13/BE, në kuadrin ligjor të brendshëm, duke mbajtur parasysh se ka kaluar një periudhë prej 5 vitesh nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikë Shqipërisë”, për zgjidhjen e një sërë problematikash të ndeshura gjatë zbatimit të ligjit, do të propozohen ndryshime ligjore, me synimin e përmbushjes së objektivave rregullatorë të autoritetit.

#### **9.4 Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave**

Gjatë vitit 2018, AMA ka kryer në mënyrë periodike monitorimin e spektrit të frekuencave 174 -230 MHz dhe 470 -862 MHz për shërbimet audiovizive dhe 88 -108 MHz për shërbimet audio në të gjitha pikat transmetuese të Republikës. Për pikën transmetuese Fushë-Dajt, monitorimi është kryer çdo ditë nga qendra fikse e monitorimit në AMA.

Nga monitorimi është verifikuar nëse:

- Subjektet e licencuara janë në transmetim.
- Subjektet që u është hequr licenca kanë ndërprerë transmetimin apo jo.
- Subjektet transmetojnë në mënyrë të paligjshme.
- Subjektet kanë pasur ndërprerje transmetimi më tepër se 30 ditë.
- Subjektet kanë zgjeruar zonën e licencimit në mënyrë të paligjshme.
- Subjektet mbulojnë me sinjal zonën e tyre të licencimit.

Gjatë vitit 2018, bazuar në monitorimet e kryera rezulton se:

- Subjektet e licencuar nga AMA janë të gjithë në transmetim, me përjashtim të disa subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në ato zona ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit. Këto subjekte rezultojnë të pambartura në asnjë nga rrjetet numerike të licencuara (publik dhe privat).

**Në qarkun Fier** rezulton që subjektet TV “JUG”, TV “Apollon”, TV” Margit” dhe TV “Kombi” nuk janë mbartur në asnjë nga rrjetet numerike të licencuara (publik dhe privat).

**Në qarkun Berat** rezulton që subjekti TV “Globi” nuk është mbartur në asnjë nga rrjetet numerike të licencuara (publik dhe privat).

**Në qarkun Korçë** rezulton që subjekti TV “Lobi” nuk është mbartur në asnjë nga rrjetet numerike të licencuara (publik dhe privat).

- Subjektet, të cilëve u janë shfuqizuar licencat përkatësisht Radio “Vintage”, Radio “Albania FM” dhe Radio “World Family”, kanë ndërprerë menjëherë transmetimin.
- Subjekte të cilët transmetojnë në mënyrë të jashtëligjshme kanë qenë përkatësisht subjekti audioviziv “Adriamed” (analog), i cili transmetonte në Tiranë, si dhe subjektet TV “Shijak”, RTSH, “Tring TV”, TV “Ora News”, TV “Top Channel” dhe TV “News 24”, që transmetonin në mënyrë numerike nga pika e transmetimit Fushë- Dajt. Të gjithë këto subjekte kanë mbyllur transmetimet e tyre të paligjshme më datë 10 shtator 2018. Gjithashtu në muajin shkurt, nga monitorimet e kryera në qarkun e Gjirokastrës u konstatua se subjekti TV “Alpo” kishte filluar transmetimet në mënyrë numerike pa autorizimin e AMA-s. Pas konstatimit, AMA i ndërpreu këtij subjekti transmetimin si dhe i sekuestroi pajisjet transmetuese.
- Nuk janë konstatuar subjekte që kanë zgjeruar zonën e tyre të licencimit në mënyrë të paligjshme.
- Lidhur me subjektet audiovizivë që nuk mbulojnë me shërbim zonën për të cilën janë licencuar theksojmë se, Operatori Publik Shqiptar (RTSH) nuk mbulon me sinjal analog zona të caktuara, si më poshtë:
  - Njesitë administrative Qukës, Gramsh, Prrenjas (Kotodesh), Labinot, Lunik, Kostenje e Drenovicë, Orenjë dhe Steblevë të qarkut Elbasan.
  - Njesitë administrative Selenicë, Qeparo, Borsh dhe Lukovë të qarkut Vlorë.
  - Njësia administrative Këlcyrë e qarkut Gjirokastrë.
  - Njesitë administrative Vau i Dejës, Razëm të qarkut Shkodër.
  - Njesitë administrative Maqellarë, Sllovë, Kalaja e Dodës, Kalis të qarkut Dibër.
  - Njesitë administrative Krujë, Cudhi, Maminas dhe Lagjet pas Vilës së Zogut në qarkun Durrës.

Ndërkohë nuk mbulohen me sinjal numerik edhe zona të caktuara në qarqet Korçë, Berat dhe Fier, ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit nga RTSH dhe operatorët privatë numerik kombëtarë (TV“Klan”, TV“Top Channel”, “Digjitalb”, “Vizion+” dhe “ADTN”). Informacion i detajuar gjendet në kapitullin “Digjitalizimi”.

Subjektet e sipërcituar janë njoftuar zyrtarisht për marrjen e masave të menjëhershme për realizimin e mbulimit sipas licencës. Në veçanti, shkresa të njëpasnjëshme i janë dërguar operatorit publik RTSH, për të cilin në AMA ka pasur dhe ankesa me shkrim nga qytetarë të zonave të ndryshme. Edhe pas korrespondencave tona, situata lidhur me transmetimet analoge nuk ka ndryshuar plotësisht, pasi RTSH ngre pretendimin se janë duke investuar për të kaluar në transmetimet numerike dhe nuk mund të bëjnë shpenzime dyfishe edhe për transmetimet analoge. Përsa u përket transmetimeve numerike të subjektit RTSH, nga monitorimet e kryera është konstatuar gjithashtu se subjekti RTSH, krahas zonave ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit ka ndezur transmetuesit e tij edhe në zona të tjera të vendit. Konkretisht, RTSH mbulon me sinjal numerik qarqet Tiranë-Durrës, Shkodër, Pukë, Dibër, Kukës, Vlorë, Gjirokastrë, Tepelenë, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Burrel dhe Lezhë.



## **10 AUTORITETI SI NXITËS I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT AUDIOVIZIV**

### **10.1 Angazhimi i Autoritetit në zhvillimet teknologjike të tregut audioviziv**

Promovimi dhe inkurajimi i futjes së teknologjive të reja, duke ruajtur konkurrencën dhe mundësitë e barabarta për të gjitha palët e interesuara, është një ndër detyrat funksionale të AMA-s. Tregues për përmbushjen e kësaj detyre është vetë tregu mediatik, i cili tashmë ofron shërbimet e reja inovative.

AMA ka nxitur dhe inkurajuar operatorët në treg nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, ka përgatitur terrenin për të lehtësuar hyrjen e shërbimeve të reja, duke miratuar akte rregullative me procedura lehtësuese për të gjithë të interesuarit.

Në zbatim të ligjit, me vendimin e AMA-s nr. 68, datë 20.04.2018, është miratuar rregullorja “Mbi kriteret e ofrimit të shërbimeve të mbrojtura”, që u hap rrugën shërbimeve të tilla, si Video on Demand, Chach up, Shift etj.

Sikurse kemi raportuar mbi veprimtarinë e AMA-s për vitin 2017, me vendimin nr. 182, datë 6.9.2016, AMA ndërmori hapin për kalimin e plotë në teknologjinë digjitale të transmetimeve audiovizive mbështetur në rrjetin kabllor, duke u lënë kohë subjekteve të kalonin në teknologjinë e re brenda datës 31.12.2017.

Gjatë vitit të raportimit, AMA ka mbikëqyrur procesin e migrimit të operatorëve ekzistues kabllorë në teknologjinë e re digjitale, përmes kontrolleve dhe njoftimeve të vazhdueshme. Theksohet se në të gjitha aplikimet e ardhura në AMA, për marrje ose rinovim autorizimi, kalim të drejtash ose zgjerim zone, AMA ka pranuar dhe miratuar vetëm ato aplikime ku është pasqyruar qartë edhe ndryshimi i teknologjisë, nga analoge në digjiitale.

### **10.2 Kontributi i Autoritetit në mbështetje të studimeve shkencore**

AMA ka konsoliduar një traditë bashkëpunimi me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Fakultetin e Histori- Filologjisë në Universitetin e Tiranës prej vitit 2015, kur zhvilloi për herë të parë një konferencë ndërkombëtare shkencore për procesin e digjitalizimit. Prej këtij eventi shkencor, që kishte në thelb një studim dhe analizë të tregut audioviziv në Shqipëri dhe prezantimin e disa përvojave nga vendet e BE-së dhe ato të rajonit, AMA ka vijuar sinergjinë me Departamentin, si një rast i artë për të tërhequr në vlerësimin e aktualitetit dhe prognozimin e së ardhmes për fluksin e shërbimeve audiovizive në vend, realizuar nga një qendër kërkimore dhe studimore e certifikuar e kësaj fushe.

Për vitin 2018 Autoriteti mbështeti projektin “Oferta programore e transmetuesve televizivë shqiptarë”, i cili kishte si qëllim kryesor realizimin e një studimi dhe analize shkencore mbi aspekte të ndryshme të përmbajtjeve që emetojnë subjektet audiovizive në Shqipëri dhe mbi bazën e tij të organizonte një konferencë shkencore me pjesëmarrjen e pedagogëve, studiuesve dhe ekspertëve të fushës, doktorantëve të gazetarisë dhe komunikimit etj. Ky kombinim i produkteve u vlerësua si në favor të pasurimit të këndvështrimeve dhe analizave që bëjnë studiuesit, për të shikuar më tej se sa fotografia aktuale e situatës në transmetimet audiovizive, për prezantimin dhe të trendeve e prirjeve të tregut në të ardhmen e afërt dhe atë të largët.

Në kuadër të projektit “Oferta programore e transmetuesve televizivë shqiptarë” është kryer dhe një sondim i publikut në terren, një kampion me 500 të pyetur, si dhe kryerja e intervistave cilësore. Të gjitha data-t e grumbulluara i janë nënshtruar një procesi përpunues për t’i bërë funksionale, si pjesë e studimit përfundimtar, ndarë me kapituj të veçantë, bazuar tek operatorët në fokus apo problematika me përmbajtjet e emetuara - një material që ishte i gatshëm për të qenë në bazë të një diskutimi të hapur publik, në konferencën shkencore që u zhvillua në Fakultetin e Histori-Filologjisë në fillim të muajit dhjetor 2018.

Konferenca shkencore "Strategjitë e programacionit dhe sfidat e transmetimeve televizive në Shqipëri" u organizua në dy seanca pune, duke u ndalur në problematika të tilla, si programacioni në RTSH dhe veçoritë e tij në procesin e reformimit; politika e programacionit në televizionet informative; programacioni nën presionin e burimeve financiare; ndikimi i reklamës në programacionin e televizioneve informative; politika e fashave orare në programacionin televiziv të “Vizion Plus” dhe shpërndarja e emisioneve të ndryshme në to; kostoja e lajmit informativ në televizionet gjeneraliste kombëtare dhe tematik; ndikimi i donatorëve të huaj mbi programacionin televiziv në kontekstin elektoral; rigjetja e informacionit ekonomik dhe programeve për mbrojtjen konsumatore si mënyra tërheqje të audiencave të fragmentuara; konvergimi tematik i lajmeve të aktualitetit në programet javore të argëtimit; lajmi për biznesin apo biznes me lajmin; problemet sociale të komunitetit në optikën e programacionit të televizioneve lokale etj. Gjatë punimeve të konferencës pati dhe pyetje apo ndërhyrje e komente nga pjesëmarrësit mbi kumtesat dhe prezantimet e bëra, gjithashtu u bënë edhe vlerësime mbi gjetjet e përfundimet e studimit të Departamentit.

### **10.3 Bashkëpunimi në rregullimin e tregut audioviziv**

Gjatë vitit 2018 AMA ka vijuar partneritetin me organizata dhe institucione që punojnë në fushën e medias, për të realizuar projekte që ndikojnë në përmirësimin e raportimit të redaksive audiovizive në aspekte të tilla si, mbrojtja e fëmijëve, barazia gjinore, fake news, edukimi mediatik apo përshtatja e aplikacioneve të reja në redaksitë audiovizive. Risi në partneritetin e vitit 2018 ishte angazhimi për të pasuruar literaturën në gjuhën shqipe mbi median audiovizive, duke përkthyer tituj nga fondi i bibliografisë ndërkombëtare. Nga bashkëpunimi me partnerët tanë u bë i mundur publikimi i librave të UNESCO-s: “Media and Information Literacy: Reinforcing Human Rights, Countering Radicalization and Extremism”, dhe “Privacy, Free expression and transparency: Redefining their new boundaries in the digital age”.

Botimet sjellin informacion dhe analizim të dy çështjeve të rëndësishme të angazhimit të medias, përballë rrezikut të fenomeneve të radikalizmit dhe ekstremizmit, jo vetëm fetar, ku përfshihet dhe gjuha e urrejtjes, por dhe krijimi i një balance mes kërkesës për ‘privacy’ dhe nevojës për transparencë dhe lirisë së shprehjes, si një ndër parimet bazë të demokracisë.

Botime të tjera që u sollën në shqip gjatë vitit 2018 janë edhe “L’explosion du journalism, des medias de masse de medias”; “From PrimeTime to DayTime”; “Sociologie de la television” dhe “Television and Youth Culture”, të cilat kanë krahas lëndës informative dhe analiza mbi dukuri e trende në sektorin e mediave audiovizive, me hulumtime e gjetje të ecurisë për periudha të ndryshme kohore - duke përfshirë tregues dhe fenomene karakterizuese në kushtet e ndryshimeve të vrullshme teknologjike, menaxheriale, sociologjike, etike etj.

Projekti “Respektimi i të drejtave dhe lirive të fëmijëve, mbrojtja e tyre në transmetimet e përmbajtjeve audiovizive” u aplikua jo vetëm me përfshirjen në të të gazetarëve, redaktorëve e reporterëve nga OSHMA-të në kryeqytet, por dhe në qarqe të tjera, Fier, Pogradec, Lushnjë, Lezhë dhe Durrës, për t’i ndërgjegjësuar në respektimin e kërkesave që ka Ligji 97/2013, i ndryshuar, dhe Kodi i Transmetimit të AMA-s. Prosesi kualifikativ bazohej tek trajnimet “in house”, ku trajnerët dhe ekspertët ishin në vendet e punës së gazetarëve, duke menaxhuar bashkë me ta axhendën ditore, që nga planifikimi dhe deri tek publikimi i produktit audioviziv. Një nga temat me të cilat po angazhohen dukshëm autoritetet rregullatore në vendet anëtare të BE-së apo ato që janë aspirante është dhe edukimi mediatik. Për të dytin vit, një prej projekteve të partnerëve kishte këtë fokus. I titulluar “Media literacy, edukimi mediatik i qytetarëve dhe përdorimi i drejtë i përmbajtjes audiovizive me fokus të rinjtë”, projekti krijoi një hapësirë për diskutime dhe reflektime tek të rinjtë, perceptimet dhe vlerësimet e tyre për përmbajtjet e transmetuara në mediat audiovizive. Për të ndikuar tek gjenerata e re, nxënësit dhe studentët, për një vështrim sa më kritik për përmbajtjet audiovizive që emetohen, në dallimin e të vërtetave dhe të pavërtetave në fluksin e informacioneve që përgatisin redaksitë, por dhe duke kuptuar procesin e konvergjencës së mediave klasike me ato të reja.

Përmirësimi i përfaqësimit dhe protretizimit të grave në median elektronike ishte një tjetër projekt që bazohej mbi një publikim të UNESCO-s, titulluar “Vendosja e balancës së drejtë: barazia gjinore në gazetari”. Një studim me gjetje e prirje të tregut audioviziv mbi problematikën gjinore u diskutua në panele me grupet e interesit, gjithashtu dhe në formën e broshurës print dhe virtualisht u shpërnda në redaksitë audiovizive, me synimin që të ndikojnë në përmirësimin e aftësive të gazetarëve në raportimin e çështjeve gjinore dhe, në mënyrë të veçantë, kundër dhunës në familje.

Përshtatja e gazetarëve në kushtet e zhvillimit të vrullshëm teknologjik dhe përdorimit të pajisjeve inteligjente ishte një projekt që u ofroi gazetarëve të rinj kurse për trajnimin digjital, produktin audio të avancuar, studion televizive, respektimin e etikës në shkrimin e lajmeve etj. Ndërkohë projekti “Fake News dhe sfidat e raportimit në median audiovizive” u aplikua në disa qarqe të vendit Shkodër, Vlorë, Korçë, Gjirokastër, Tiranë dhe Elbasan, si një harmonizim i kualifikimit me ndërgjegjësimin e gazetarëve të rinj në median audiovizive, për evitimin e lajmeve të rreme, por dhe përshtatja e tyre me zhvillimet teknologjike dhe përhapjen në shkallë të gjerë të internetit, apo konkurrenca që vjen nga mediat e reja dhe rrjetet sociale etj.

## 11 KALIMI NË TRANSMETIMET NUMERIKE

Në përmbushje të detyrave dhe funksioneve të AMA-s të përcaktuara në Ligjin 97/2013, Strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në transmetimet numerike, Planin e Veprimit të Dokumentit Strategjik të AMA-s, si dhe në përmbushje të rekomandimeve të Bashkimit Evropian dhe Kuvendit të Shqipërisë, gjatë vitit 2018, AMA është angazhuar maksimalisht dhe ka ndërmarrë një sërë veprimtarish lidhur me procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive.

Koordinimi i vazhdueshëm në kuadër të implementimit të dy rrjeteve numerike të operatorit publik shqiptar (RTSH) dhe 5 rrjeteve numerike të operatorëve privatë kombëtarë të licencuar nga AMA, ka zënë një vend të rëndësishëm në këto aktivitete. Janë zhvilluar takime dhe vendosur korrespondenca të vazhdueshme me këta operatorë lidhur me zbatimin e afateve të implementimit të rrjeteve, sipas grafikut të “ishujve numerike”, mbi përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për mbështetjen në rrjetet e tyre të operatorëve lokalë/rajonale, mbi mbulimin me sinjal numerike cilësor të territorit, mbi respektimin e numrit logjik të programeve të tyre etj.

Ndërkohë, AMA ka koordinuar punën edhe me operatorët analogë lokalë/rajonale në kuadër të përmbushjes së afateve për mbështetjen e programeve të tyre audiovizive në rrjetet kombëtare numerike si dhe gjetjen e zgjidhjeve teknike efektive për të realizuar këtë mbështetje.

Në zbatim të kuadrit rregullator, Autoriteti duhet të sigurojë vijimësinë e transmetimeve televizive nga operatorët ekzistues analogë në zonat respektive të mbulimit. Në dispozitat kalimtare të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet edhe vlefshmëria e licencave ekzistuese, me qëllim harmonizimin e të drejtave dhe detyrimeve të këtyre subjekteve me dispozitat e ligjit, pas mbylljes së transmetimeve analoge.

Një nga mundësitë që u njeh ligji kësaj kategorie subjektesh është mbështetja e programeve analoge ekzistues vendorë në rrjetin numerik të televizionit publik ose rrjetet e tjera numerike. Zëvendësimi i licencave të transmetimit mbështetur në rrjet analog me licencë shërbimi programi audioviziv ndërvaret me datën e mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet ku këto subjekte ushtrojnë aktivitet.

AMA, pas depozitimit të kontratave të mbështetjes dhe fillimit të ofrimit të shërbimit në teknologjinë numerike, ka zëvendësuar licencat për 13 subjekte audiovizivë. Licencat e shërbimit të programit audioviziv janë lëshuar me afat 8-vjeçar, duke qenë në përputhje me nenin 74 të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar.

Aktivitetet e zhvilluara në kuadër të procesit të digjitalizimit kanë sjellë progres në procesin e implementimit të rrjeteve numerike si dhe në procesin e mbylljes së transmetimeve analoge në të gjithë vendin.

Informojmë se operatori publik shqiptar (RTSH) ka shtruar infrastrukturën digjitale në të gjithë vendin dhe operatorët privatë numerik kanë implementuar rrjetet e tyre në pjesën më të madhe të allotmenteve të mbetura. Tashmë rreth 70% e popullsisë ka mundësi të aksesojë transmetimet digjitale audiovizivë.

Sa i takon mbylljes së transmetimeve analoge, informojmë se bazuar në strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në transmetime digjitale, procesi i digjitalizimit zhvillohet me faza. Çdo fazë parashikon mbylljen e transmetimeve analoge në një allotment (çdo allotment përkon me një qark të vendit, me përjashtim vetëm të allotmentit të Tiranës i cili përmban qarqet Tiranë dhe Durrës). Aktualisht procesi ka përfunduar në 3 qarqe: Berat, Korçë dhe Fier përkatësisht në datat 15 gusht 2017, 08 janar 2018 dhe 31 mars 2018. Në këto qarqe, operatorët lokalë/rajonale kanë mbështetur programet e tyre kryesisht tek rrjeti numerik i RTSH-së.

Ndërkohë, AMA përcaktoi që më datë 31 korrik 2018 të realizohej mbyllja e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë dhe Durrës, me qëllim mbylljen e transmetimeve analoge edhe në dy qarqe të tjera të vendit brenda vitit 2018.

Operatorët audiovizivë në një takim të zhvilluar më datë 24.07.2018 nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, ku merrnin pjesë përfaqësues të AMA-s, RTSH-së, Shoqatës së Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë-Valorë (RRTL) si dhe operatorë lokalë/rajonale, adresuan një sërë problematikash, ku ndër të tjera kërkuan edhe shtyrjen e afatit të mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Tiranë, Durrës deri në fund të vitit. AMA vlerësoi se kërkesa e tyre ishte e pabazuar, duke qenë se infrastruktura ishte prej kohësh prezente në këto qarqe dhe vendosi të shtyjë afatin vetëm me një muaj e gjysëm, deri më 10 shtator 2018. Me mbylljen e transmetimeve analoge më datë 10 shtator 2018, u konstatuan radhë të gjata të qytetarëve në pikat e shitjeve të dekoderave dhe fluks i madh telefonatash drejt numrave Call Center në AMA, që tregonin për konfuzion të qytetarëve lidhur me teknologjitë DVB-T dhe DVB-T2, si dhe mungesë të dekoderave në treg. Duke e konsideruar këtë një situatë jonormale dhe për të krijuar kushte lehtësuese për qytetarët, AMA vendosi të shtyjë afatin deri më 15 janar 2019.

Kjo ishte një situatë e paparashikuar për AMA, së pari, pasi procesi kishte përfunduar me sukses në 3 qarqe të vendit dhe nuk ishte shfaqur një problematikë e tillë dhe, së dyti, pasi AMA ka filluar fushatën e ndërgjegjësimit të publikut që në vitin 2016 në formë të ndryshme të tilla si broshura, fletëpalosje, spote publicitare, njoftime/mesazhe publike, ngritjen e strukturës Call Center, përgjigje pyetjeve të drejtuara në faqen sociale Facebook apo adresën zyrtare [info@ama.gov.al](mailto:info@ama.gov.al).

Mbajtur parasysh situatën e krijuar në datën 10 shtator 2018, AMA, me shkresën e datës 4 janar 2019, kërkoi prej disa operatorëve tregtarë informacion mbi numrin e aparateve televizive dhe dekoderave të sistemit DVB-T2, të importuar gjatë 3-mujorit të fundit të vitit 2018 dhe numrin gjendje të tyre. Informacioni i është kërkuar edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Duke konsideruar se në qarqet Tiranë dhe Durrës është përqendruar numri më i madh i banorëve, si dhe bazuar në të dhënat e ardhura nga operatorët ekonomikë tregtarë dhe Drejtoria së Përgjithshme të Doganave, u evidentua se **ende nuk është siguruar sasia e mjaftueshme e dekoderave të tipit DVB-T2.**

Strategjia e kalimit në transmetimet numerike parashikon: *Që të realizohet plani i mësipërm i kalimit të plotë në transmetime numerike krahas ndërtimit të rrjeteve duhet planifikuar pajisja e audiencës me marrës numerikë ose dekoder që bëjnë të mundur përdorimin e marrësve ekzistues analogë edhe për marrjen e sinjaleve numerikë. Dekoderët që duhen planifikuar janë të sistemit të kompresionit DVB-T2/MPEG 4. **Përfundimisht, në planifikimin e nevojave për dekoder, duhet marrë parasysh pajisja me ta e 100 % të familjeve***”.

Gjithashtu, duke patur parasysh situatën e krijuar në datën 10 shtator 2018, Autoriteti i Konkurrencës, pasi ka monitoruar tregun në disa pika tregtimi të pajiseve dekoder, ka arritur në përfundimin se kjo situatë ka ardhur si pasojë e mungesës së informimit të publikut për mundësitë që ofronte tregu i pajisjeve elektronike për përmbushjen e kërkesave të tyre. Ky Autoritet me vendimin nr. 547, datë 24.09.2018 “Për dhënien e rekomandimeve për rritjen e konkurrencës gjatë procesit për dixhitalizimin e transmetimeve audiovizive” ka rekomanduar që AMA të rritë sensibilizimin ndaj opinionit publik, nëpërmjet fushatave informuese, duke informuar publikun se tregu i shitjes së dekoderëve DVB-T2, është treg i hapur dhe këto dekoderë mund të sigurohen në çdo pikë shitje të pajisjeve elektronike.

Në këto kushte, bazuar edhe në vendimin e Autoritetit të Konkurrencës, të sipërcituar, me qëllim që kalimi nga transmetimet analoge në ato numerike për qarqet e Tiranës dhe Durrësit, ku banojnë rreth 1/3 e popullatës së Shqipërisë, të realizohet në mënyrë sa më efikase, duke shmangur problematikat e hasura deri tani, me qëllim që qytetarët të kuptojnë sa më mirë informacionin dhe detajet e nevojshme, në mënyrë të veçantë ato teknike, që prekin drejtpërdrejt përdorimin e pajisjeve apo aksesoreve shtëpiakë të nevojshëm për të mundësuar marrjen e sinjalit numerik dhe eventualisht shikimin e kanaleve digjiitale, AMA për përmirësimin e fushatës informuese për publikun, angazhoi një ekspert të jashtëm për ndryshimin e përmbajtjes së spoteve informuese, njoftimeve, zgjerimin e kanaleve të komunikimit, etj. në mënyrë që procesi i mbylljes së programeve (kanaleve) analoge dhe kalimi në transmetimet numerike të jetë sa më i qartë dhe i kuptueshëm për qytetarët.

Bazuar në Strategjinë e Komunikimit për fushatën e kalimit në transmetimet numerike të hartuar nga eksperti i kontraktuar, tashmë ka nisur procedurat administrative për realizimin e spoteve të reja informuese për procesin e digjitalizimit.

Referuar sa më sipër, në pamundësi të përmbushjes së kriterëve të mësipërme, përkatësisht sigurimit të dekoderave në treg, si dhe përmirësimit të fushatës së informimit për publikut, me qëllim që procesi të vijojë pa ndërprerje sinjali audioviziv për publikun e gjerë, dhe të mos përsëritet situata e shtatorit 2018, AMA ka shtyrë afatin e mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Tiranë dhe Durrës deri më datë 1 shtator 2019. Brenda këtij afati do të mbyllen transmetimet analoge edhe në qarkun e Vlorës.

Ndërkohë sqarojmë se, në qarqet Tiranë, Durrës dhe Vlorë, deri më datë 1 shtator 2019 do të bashkekzistojnë/do të jenë të pranishme si transmetimet analoge, ashtu edhe ato digjitale, që sigurojnë cilësi të lartë dhe një numër më të madh programesh televizive pa pagesë.

AMA gjithashtu vijon të nxisë operatorët e tregut që të sigurojnë sasinë e mjaftueshme të dekoderave, me qëllim finalizimin e procesit të digjitalizimit në qarqet Tiranë dhe Durrës.

Lidhur me procesin e digjitalizimit informojmë se aktualisht nuk janë funksionale strukturat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012 “Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike”, për ndjekjen e implementimit të këtij procesi. Konkretisht, Komiteti Ndërinstitucional i ngritur me Urdhrin nr. 144 të Kryeministrit, datë 7.4.2014, për ndjekjen e zbatimit të Strategjisë për kalimin në transmetimet numerike si dhe Sekretariati Teknik, strukturë mbështetëse e Komitetit Ndërinstitucional nuk janë funksionalë që nga shtatori i vitit 2017. Në këto kushte AMA duke bashkëpunuar ngushtë me operatorët audivizivë në treg, si dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe rekomandimeve të Kuvendit, ka marrë vendime mbi ecurinë e këtij procesi sikurse vendimet lidhur me përcaktimin e qarkut vijues si dhe afateve kur do të mbyllen transmetimet analoge, si dhe çështje të tjera.

Gjithashtu, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 3.6.2015 “Për miratimin e rregullave teknike për aparatet marrëse televizive, që do të vendosen në treg”, janë përcaktuar strukturat përgjegjëse lidhur me tipin e dekodereve të hedhur në tregun shqiptar, sqarojmë këtu se ndër këto struktura është edhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila ka detyrimin që të mos lejojë hyrjen e dekodereve të ndryshëm nga ato të përcaktuar në VKM 480 (tipi i dekodereve që duhet të jenë në treg është DVB-T2/MPEG-4).

## TEKNOLOGJIA DVB-T2

Strategjia për kalimin në transmetimet numerike ka përcaktuar përdorimin e teknologjisë DVB-T2/MPEG 4 për ofrimin e transmetimeve numerike në vendin tonë.

Është përzgjedhur pikërisht kjo teknologji duke qenë se ofron një gamë më të gjerë programacioni dhe me një cilësi më të mirë krahasuar me teknologjinë DVB-T.

Gjithashtu, përcaktimi i kësaj teknologjie është bazuar edhe në studimin e tregut shqiptar dhe tregjeve ndërkombëtare audiovizive. Duke qenë se vendi ynë karakterizohet nga një numër i madh operatorësh dhe kërkesat për të ofruar transmetime numerike kanë qenë të vazhdueshme nga operatorët ekzistues në treg, e vetmja mundësi për të përmbushur këto kërkesa ka qenë përzgjedhja e teknologjisë DVB-T2. Aktualisht, edhe vendet e tjera në BE janë duke implementuar këtë teknologji.

Ndërkohë, teknologjia DVB-T ka qenë prezente në vendin tonë që prej vitit 2004 dhe procesi i kalimit në teknologjinë e re DVB-T2 ka kaluar përmes sfidash të konsiderueshme, si për AMA-n, ashtu edhe për operatorët në treg.

AMA ka detyrimin ligjor të mbrojtë dhe informojë publikun mbi pajisjet (dekodera apo TV), që duhet të blejë në mënyrë që të aksesojë transmetimet numerike. Në këtë kuadër ka zhvilluar fushatë informimi të vazhdueshme ku informon publikun mbi teknologjinë e re dhe nevojën e pajisjes me dekoder të tipit DVB-T2 apo televizor, i cili të ketë të inkuorporuar këtë tip dekoderi. Gjithashtu, në fushatat e organizuara, AMA ka bërë me dije se për t'u pajisur me këto pajisje, qytetarëve u ofrohet mundësia të shkojnë në çdo pikë shitjeje ku gjendet pajisje televizive (si televizorë, antena etj). Pra, tregu i shitjës së dekoderave apo televizorëve nuk ka qenë në asnjë rast treg monopol. Në tregun shqiptar janë disa kompani që ofrojnë shitjen e tyre dhe madje në periudha të caktuara kanë ofruar edhe oferta në çmimet e tyre, veçanërisht në periudhën e fundvitit.

Kalimi i plotë në teknologjinë DVB-T2 gjithashtu bëri të mundur mbylljen e të gjithë transmetimeve të paligjshme në vendin tonë, që ofroheshin përmes teknologjisë DVB-T. Kjo është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me operatorët në treg, të cilët janë angazhuar maksimalisht në zëvendësimin e pajisjeve të përdoruesve apo rikonfigurimin e tyre.

Mbulimi i territorit të Shqipërisë me transmetime numerike paraqitet në hartën e mëposhtme.

Ndërkohë në Aneksin nr.1 bashkëngjitur këtij raporti, paraqiten hartat e mbulimit të territorit të Shqipërisë me transmetime numerike nga operatori publik shqiptar (RTSH) dhe operatorët privatë kombëtarë numerikë.



**Mbulimi i territorit të Shqipërisë me  
transmetime numerike**



**LEGJENDA**

- Prezencë e sinjalit numerik
- Në proces digjitalizimi, përfundon në 1 Shtator 2019
- Përfunduar procesi i digjitazimit

### 11.1 Lirimi i brezit të Dividendit DigjitalError! Bookmark not defined.

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me procesin e lirim të brezit 800 MHz, në shkurt të vitit 2018 AMA ka njoftuar zyrtarisht Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë lidhur me lirim të plotë të këtij brezi. Në këtë mënyrë u shmangën përfundimisht interferencat e dëmshme që shkaktonin transmetimet audiovizive shqiptare drejt vendeve fqinjë, kryesisht Malit të Zi dhe njëkohësisht iu hap rruga përdorimit të këtij brezi për shërbimet mobile (LTE) edhe në vendin tonë.

Ndërkohë, në kuadër të zhvillimeve të fundit mbi përdorimin e brezit audioviziv, ku një pjesë tjetër e këtij brezi 694-790 MHz (brezi DD2) do të përdoret për shërbimet broadband, gjatë vitit 2018, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, AKEP dhe AMA organizuan disa takime për të diskutuar mbi hapat e nevojshëm për hartimin e politikës spektrale në vendin tonë, si dhe mbi procesin e lirim të këtij brezi (brezi 700 MHz).

AMA, duke njohur situatën aktuale të shfrytëzimit të këtij brezi në vendin tonë, ka konkluduar sa më poshtë:

- Në situatën aktuale në të cilën ndodhet vendi ynë, kur procesi i digjitalizimit ende nuk ka përfunduar, lirimi i brezit DD2 në një periudhë afatshkurtër do të çonte në mospërmbushjen e një detyrimi ndërkombëtar (digjitalizimit të shërbimeve audiovizive), i cili duhej të ishte realizuar më 17.06.2015.
- Nevojiten studime dhe analiza më të thelluara nga të gjitha institucionet e përfshira në këtë proces, lidhur me kërkesën e tregut të mediave audiovizive dhe tregut të komunikimeve elektronike (operatorëve mobile) për përdorimin e brezit 700 MHz.
- Institucionet dhe palët e përfshira në këtë proces, në vendimmarrjet e tyre, duhet të mbajnë parasysh garantimin dhe mbrojtjen e shërbimeve audiovizive në kuadër të mbrojtjes së vlerave kulturore dhe kombëtare transmetuar për publikun ndër vite nga mediat audiovizive.
- Institucionet dhe palët e përfshira në këtë proces, në vendimmarrjet e tyre, duhet të mbajnë parasysh garantimin dhe mbrojtjen e investimeve të kryera nga operatorët e mediave audiovizive në kuadër të procesit të digjitalizimit të rrjeteve/shërbimeve të tyre.
- Duke qenë se ky proces do të ketë një impakt të ndjeshëm në tregun e mediave audiovizive, konsultimi me operatorët audiovizivë, konsiderohet i një rëndësie të veçantë dhe duhet të marrë kohën e nevojshme për diskutimin dhe analizimin e një sërë çështjeve që lidhen me këtë proces. Aktivitetet në kuadër të konsultimeve duhet të jenë të koordinuara mirë, me objektiva të qarta dhe të bazuara në strategji të përcaktuara.

Gjithashtu, AMA ka propozuar ngritjen e një grupi teknik pune për ndjekjen e procesit të lirim të brezit DD2 deri në përfundimin e plotë të tij, i cili të udhëhiqet dhe koordinohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

## **Monitorimet e kryera në kuadër të procesit të digjitalizimit të transmetimeve audiovizive.**

Në kuadër të procesit të kalimit nga transmetimet analoge në transmetime numerike janë kryer monitorime intensive në të gjithë Shqipërinë. Monitorime janë kryer në qarqet ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit me qëllim garantimin e vijimësisë së transmetimeve audiovizive gjatë dhe pas periudhës tranzitore të kalimit në transmetime digjitale dhe për të garantuar mbulimin me sinjal cilësor të qarqeve ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit nga operatori publik shqiptar dhe operatorët privatë kombëtarë numerikë.

Gjithashtu, fokusi i monitorimeve ka qenë edhe verifikimi i mbylljes së transmetimeve analoge, mbartja e operatorëve lokalë/rajonalë në rrjetet kombëtare dhe përmbushja e kërkesave/kushteve të licencës nga operatorët kombëtarë numerikë (realizimi i mbulimit të territorit me sinjal numerik, cilësia e sinjalit, respektimi i numrit logjik të programit etj).

Nga monitorimet e kryera në qarqet Berat, Korçë, Fier, ku tashmë janë mbyllur transmetimet analoge përkatësisht në 15 gusht 2017, 8 janar 2018 dhe 11 mars 2018, ka rezultuar se RTSH dhe operatorët privatë kombëtarë numerikë nuk mbulojnë me sinjal numerik disa zona të caktuara si më poshtë:

### **1. Për Subjektin RTSH shih më poshtë (pika 11.3)**

**2. Subjektet private kombëtare** TV “Top-Channel”, TV “Vizion +”, Digjitalb dhe ADTN nuk i kanë të ndezur të gjithë transmetuesit, për rrjedhojë disa zona mbeten të pambuluara me sinjal audioviziv. Konkretisht:

- **Në qarkun Berat nuk mbulohet nga sinjali i TV “Top Channel”, TV “Klan”, “Digjitalb”, TV “Vizion +”, dhe “ADTN-së.**
- Njësia administrative Kuçovë
- Njësia administrative Poliçan.
- Njësia administrative Çorovodë
- **Në qarkun Fier nuk mbulohet nga sinjali i TV “Top Channel”, “Digjitalb, TV “Vizion +” dhe “ADTN”-së.**
- Pjesërisht Bashkia Divjakë
- **Në qarkun Korçë nuk mbulohet nga sinjali i TV “Top Channel”, TV “Klan” “Digjitalb”, TV Vizion + dhe ADTN-së.**
- Njësia administrative Ersekë
- Njësia administrative Leskovik
- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë
- Njësia administrative Çërravë
- Njësia administrative Mokër

Sa më sipër, AMA ka bashkëpunuar ngushtë dhe vijon bashkëpunimin me operatorët numerikë dhe në mënyrë të veçantë me operatorin publik shqiptar (RTSH) për të gjetur zgjidhjet e duhura dhe të shpejta për realizimin e mbulimit të plotë të këtyre qarqeve me transmetime numerike.

Gjithashtu, rëndësi të veçantë u është dhënë monitorimeve në qarqet Tiranë, Durrës, për të cilët ishte parashikuar të mbylleshin transmetimet analoge më datë 10 shtator 2018. Në këtë datë u bë e mundur mbyllja e të gjithë transmetimeve analoge dhe çfarë vlen për t'u theksuar, në këtë datë janë mbyllur edhe të gjithë transmetimet numerike të paligjshme.

Pavarësisht ecures së procesit të digjitalizimit në qarqet Tiranë, Durrës, ku data e mbylljes së transmetimeve analoge është shtyrë për më 1 shtator 2019, është e rëndësishme të theksojmë se tashmë në të gjithë vendin nuk ka më transmetime numerike dhe analoge të palicencuara. Për sa u përket programeve të RTSH-së nga verifikimet e kryera rezulton se RTSH ka çelur edhe programe te reja. Numri total i programeve të RTSH-së dhe numri logjik jepet si më poshtë:

- RTSH 1 HD—LCN-1
- RTSH 2 HD—LCN-2
- RTSH 3 HD—LCN-3
- RTSH KUVEND—LCN-34
- RTSH 24—LCN-33
- RTSH FILM—LCN-41
- RTSH SPORT HD—LCN-42
- RTSH SHQIP—LCN-43
- RTSH MUZIKE—LCN-44
- RTSH PLUS— LCN-31
- RTSH FEMIJE — LCN-32
- TV KORÇA —LCN 36
- RTV GJIROKASTRA —LCN 35

Theksojmë se programet e RTSH-së e respektojnë numrin logjik të caktuar nga AMA.

## **11.2 Fushata e infomimit të publikut në lidhje me procesin e transmetimeve digjitale**

Strategjia e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike përcakton AMA-n si autoritetin përgjegjës për realizimin e fushatës së informimit të publikut. Duke qenë se procesi i kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike është jo vetëm një proces prioritar për të gjitha vendet evropiane, pjesë e BE ose jo, por mbi të gjitha është një proces me ndikim të gjerë në gjithë shoqërinë shqiptare, AMA, prej muajit prill të vitit 2016, por edhe gjatë vitit 2017 dhe gjithë vitit 2018 ka vënë në dispozicion numrin e Call Center (04-410-44-55 dhe 04-410-44-56).

Këto dy numra janë në dispozicion të të gjitha pyetjeve të qytetarëve apo operatorëve nga ora 9.00 deri në orën 21.00, nga e hëna në të shtunë.

Gjithashtu, në rubrikën “Digjitalizimi” në faqen online zyrtare të institucionit, gjatë vitit raportues, AMA ka vijuar me publikimin e njoftimeve dhe ka mbajtur të informuar në kohë reale të gjitha palët e interesuara në lidhje me kuadrin rregullator, planin numerik frekuencor, të dhëna të përgjithshme mbi procesin, broshurën dhe fletëpalosjen e përgatitur nga AMA për digjitalizimin, kontaktet e strukturës Call Center, linkun që të çon direkt në faqen e rrjetit social facebook të AMA-s, reklamat dhe të gjitha intervistat e emisioneve speciale mbi digjitalizimin e transmetimeve audiovizive të realizuara nga stafi i AMA-s.

Në adresën zyrtare të Autoritetit [info@ama.gov.al](mailto:info@ama.gov.al) kanë ardhur kërkesa të ndryshme nga qytetarë në lidhje me digjitalizimin e transmetimeve. Sipas specifikës së pyetjes, stafi AMA-s është munduar t'i asistojë dhe t'u japë përgjigje në kohë reale.

Në kuadër të fushatës informuese, AMA ka vijuar duke mbajtur të informuar publikun edhe nëpërmjet llogarisë së saj në facebook “Autoriteti i Mediave Audiovizive – Digjitalizmi”, ku publikohen të gjitha informacionet në lidhje me procesin si për kuadrin ligjor, ashtu edhe për informacione praktike në lidhje me procesin.

Gjithashtu, bazuar në planin e shtrirjes së transmetimeve digjitale, AMA njofton me spote televizive për shtrirjen e procesit dhe masat që duhet të marrin përdoruesit e mediave audiovizive për të vijuar shikimin e transmetimeve audiovizive.

Theksojmë se AMA do të vijojë me informimin e publikut mbi procesin dhe zhvillimet e tij deri në momentin kur transmetimet digjitale të jenë aktive në të gjithë territorin e vendit.

Gjatë vitit 2018 janë pritur rreth 4600 telefonata nga struktura Call Center.

Pyetjet më të shpeshta kanë qenë:

1. Kur fillon digjitalizimi?
2. Ku mund të gjendet dekoderi? Sa është çmimi i tij?
3. Si të dalloj nëse televizori e ka të inkoorporuar dekoderin?
4. Si realizohet kërkimi automatik i kanaleve?

Qytetet nga kanë ardhur më shumë telefonata janë: Berat, Kuçovë, Kavajë, Tiranë, Durrës, Pogradec, Elbasan, Fushë-Krujë, Shkodër, Fier

Telefonatat më të shpeshta janë bërë nga meshkujt.

Theksojmë se AMA do të vijojë me informimin e publikut mbi procesin dhe zhvillimet e tij deri në momentin kur transmetimet digjitale të jenë aktive në të gjithë territorin e vendit.

Sikurse kemi informuar më sipër, Autoriteti i Konkurrencës referuar situatës së krijuar më datë 10 shtator 2018, me vendimin nr. 547, datë 24.09.2018 “Për dhënien e rekomandimeve për rritjen e konkurrencës gjatë procesit për dixhitalizimin e transmetimeve audiovizive” ka rekomanduar që AMA të rrisë sensibilizimin ndaj opinionit publik.

Në këto kushte, AMA për përmirësimin e fushatës informuese për publikun, angazhoi një ekspert të jashtëm për ndryshimin e përmbajtjes së spoteve informuese, njoftimeve, zgjerimin e kanaleve të komunikimit etj. në mënyrë që procesi i mbylljes së programeve (kanaleve) analoge dhe kalimi në transmetimet numerike të jetë sa më i qartë dhe i kuptueshëm për qytetarët.

Bazuar në Strategjinë e Komunikimit për fushatën e kalimit në transmetimet numerike të hartuar nga eksperti i kontraktuar, tashmë kanë nisur transmetimet e spoteve të reja prej muajit shkurt 2019.

### 11.3 Kontrata AMA - RTSH

Gjatë vitit 2018 AMA ka realizuar dy vlerësime mbi dinamikën e procesit të ndërtimit të buqetës me programet e vetë RTSH-së, bazuar në kërkesat e Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Kontratën e Shërbimit të transmetimit publik, miratuar nga AMA me vendim 18, datë 02.03.2017, si dhe në plotësim të rekomandimit për këtë aspekt të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për AMA-n vitin e kaluar. Sipas standardit të AMA-s, edhe dy vlerësimet e vitit 2018 u janë përcjellë për njohje drejtuesve të RTSH-së dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues. Informacioni mbi ndërtimin e buqetës së programeve të vetë RTSH-së është shoqëruar dhe me informacionin mbi nivelin e arritjes së mbulimit me sinjal të Transmetuesit Publik në territorin e vendit.

Në shqyrtimet që ka kryer AMA për buqetën programore të vetë RTSH-së ka evidentuar se transmetohen pesë programe (kanale) gjeneraliste: RTSH 1, RTSH 2, RTSH 3, RTSH GJIROKASTRA dhe RTSH KORÇA), si dhe 8 tematike: RTSH FËMIJË, RTSH PLUS, RTSH MUZIKË, RTSH SPORT, RTSH FILM, RTSH SHQIP, RTSH 24, RTSH KUVENDI.

Nga krahasimi i sasisë dhe llojshmërisë të programeve aktuale të RTSH-së me Katalogun e Programeve të parashikuar në Kontratë rezultoi se, përgjithësisht, ishte përmbushur detyrimi për sasinë e programeve dhe afatet e përcaktuara në Kontratën e Shërbimit të Transmetimit Publik.

Duke krahasuar gjetjet e vlerësimit të muajit prill me atë që u zhvillua 6 muaj më pas, ishte evidente se në buqetë kishte shtesë të programeve, konkretisht, RTSH FËMIJË, RTSH PLUS, RTSH GJIROKASTRA, RTSH KORÇA. Por sa u takon kanaleve për fëmijë, ende nuk është përmbushur objektivi i Kontratës për një kanal të dytë po për fëmijë

Ka nisur transmetimet RTSH 24, program tematik vetëm për lajmet, i parashikuar në Kontratë si Program (kanal) tematik RTSH Lajme (kanal tematik i ndërtuar vetëm me lajme dhe emisione informuese), por nuk transmeton ende emisione informuese. Gjithashtu ende nuk është në transmetim kanali tematik RTSH JETË, me programe të dedikuara për mënyrën e jetesës, udhëtimet, turizmin kuzhinën, veshjen, shëndetin dhe trupin. Duhet thënë se Transmetuesi Publik ka kanalin RTSH PLUS, por përmbajtja e natyra e programeve të tij nuk përputhet me konceptimin e parashikuar në Kontratë për RTSH JETË.

Nga vlerësimi i dytë për vitin 2018 u vërejt se, në kanalin RTSH 2 transmetohen rregullisht edicione informative në gjuhët e pakicave greke, maqedonase, serbe, rome dhe vllehe, si dhe përmbajtje audiovizive në këto gjuhë: dokumentarë, reportazhe dhe muzikë. Kohëzgjatja e paketës ditore për secilin nga gjuhët e sipërcituara është 3 orë në total për çdo ditë, nga e hëna në të premte, dhe 2 orë të shtunë e të dielë. Me këtë ritëm kohor rezulton se kanali u rezervon pakicave 19 orë në javë, ose rreth 570 orë në muaj, (rreth 6840 orë në një vit). Duke e vlerësuar si kanal gjeneralist RTSH 2-in, Transmetuesi Publik duhet të shikojë dhe marrë parasysh edhe ruajtjen e proporcionalitetit të problematikave që trajton, duke respektuar kështu ato hapësira që u dedikohen përmbajtjeve nga “zakonet, traditat si shenjë identiteti, njohja e momamenteve të kulturës sonë, trajtimi i problemeve të ndryshme që hasin bashkëkombësit, emigrantët...), historike, gjeografike, artistike”, sipas përcaktimeve që ka vetë Kontrata e Shërbimit, në nenin 7, pika IV. Në këtë mënyrë krijohet dhe sigurohet për ndjekësit e këtij kanali një raport i drejtë i tematikave të trajtuara, duke ruajtur karakterin plural dhe gjithëpërfshirës, sikundër dhe është zotimi i Transmetuesit Publik në Kontratën e Shërbimit që është ende në fuqi.

Bazuar në këto vlerësime duhet që RTSH të përmbushë dhe kërkesat e Ligjit nr. 76/2014, për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar. Sikundër kemi evidentuar në një shkresë që i kemi drejtuar RTSH-së në muajin prill të vitit 2018, në nenin 1 të ligjit të sipërcituar theksohet se, RTSH “transmeton çdo muaj programe edukative për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, në përputhje me ligjin për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Këto programe edukative kanë një kohëzgjatje në total prej 90 minutash dhe transmetohen nga ora 08.00 deri në orën 22.00. Një prej këtyre programeve, me kohëzgjatje prej 30 minutash transmetohet detyrimisht nga ora 17.00 deri në orën 22.00.

Në lidhje me mbulimin me sinjal të operatorit publik, RTSH, sqarohet se:

Nga monitorimet e kryera në qarqet Berat, Korçë, Fier ku tashmë janë mbyllur transmetimet analoge, RTSH nuk mbulon me sinjal numerik zona të caktuara si më poshtë:

- **Allotmenti Berat**
  - *Lagjet mbas kalasë së Beratit*
  - *Njësia administrative Roshnik*
  - *Njësia administrative Sinjë*
  - *Njësia administrative Potom*
  - *Njësia administrative Çepan*
- **Allotmenti Korçë**
  - *Njësia administrative Voskopojë*
  - *Njësia administrative Dardhë*
  - *Njësia administrative Çërravë*
  - *Njësia administrative Gorë*
  - *Njësia administrative Barmash*

Për sa i përket transmetimeve **analoge të RTSH-së**, gjatë monitorimeve në zonat ku nuk është finalizuar procesi, janë konstatuar zona që nuk mbulohen me sinjal. Konkretisht,

- Njësiti administrative Qukës, Gramsh, Prrenjas (Kotodesh), Labinot, Lunik, Kostenjë e Drenovicë, Orenjë dhe Steblevë të qarkut Elbasan
- Njësiti administrative Selenicë, Qeparo, Borsh dhe Lukovë të qarkut Vlorë
- Njësia administrative Këlcyrë e qarkut Gjirokastrë
- Njësiti administrative Vau i Dejës, Razëm të qarkut Shkodër.
- Njësiti administrative Maqellarë, Slllovë, Kalaja e Dodës, Kalis të qarkut Dibër.
- Njësiti administrative Krujë, Cudhi, Maminas dhe Lagjet pas Vilës së Zogut në qarkun Durrës.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme, AMA ka pasur korrespondenca të njëpasnjëshme me RTSH, por edhe pas sinjalizimeve të AMA-s, situata lidhur me transmetimet analoge nuk ka ndryshuar plotësisht. RTSH ngre pretendimin se janë duke investuar për të kaluar në transmetimet numerike dhe nuk mund të bëjnë shpenzime dyfishe edhe për transmetimet analoge.

Përsa u përket transmetimeve numerike të subjektit RTSH, nga monitorimet e kryera është konstatuar gjithashtu se subjekti RTSH, krahas zonave ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit, ka ndezur transmetuesit e tij edhe në zona të tjera të vendit. Konkretisht, RTSH mbulon me sinjal numerik qarqet: Tiranë-Durrës, Shkodër, Pukë, Dibër, Kukës, Vlorë, Gjirokastrë, Tepelenë, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Burrel dhe Lezhë.

#### **11.4 Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave**

Spektri i frekuencave, duke qenë një burim i fundëm natyror duhet të menaxhohet me maturi për të siguruar përdorimin në mënyrë eficiente të tij. Gjithashtu, në vënien në përdorim të këtij spektri mbahet parasysh shmangia e interferencave të dëmshme që mund të shkaktohen në dhe nga transmetimet audio/audiovizive.

Në kuadër të përdorimit të mjeteve të nevojshme për të realizuar sa më mirë administrimin dhe planifikimin e frekuencave, AMA gjatë vitit 2018 në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, bëri të mundur realizimin e një projekti lidhur me përditësimin e programit profesional që përdoret aktualisht për këtë qëllim (ICS Telecom), si dhe trajnimin e stafit mbi përdorimin e këtij programi.

Përditësimi i programit është realizuar nga kompania ATDI, që është edhe kompania që e ka prodhuar këtë program dhe trajnimi i stafit është realizuar në ambientet e AMA-s nga Drejtori Teknik i kompanisë ATDI. AMA-s i ofrohet mirembajtja dhe asistenca e kësaj kompanie për një vit nga data e përditësimit të këtij programi.

Në këtë kuadër përveç rritjes së kapaciteteve njerëzore, AMA-s i vihet në dispozicion tashmë një program i cili përfshin teknologjitë dhe metodologjitë e fundit për menaxhimin e spektrit.

Në buxhetin e vitit 2019, AMA ka parashikuar gjithashtu blerjen e programit ICS Manager, i cili është modul shtesë që shërben për të kryer procesin e koordinimit ndërkombëtar dhe për të bërë analiza më të thelluara.

##### **11.4.1 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive**

Statusi i përdorimit të brezit audioviziv mbetet i pandryshuar edhe gjatë vitit 2018. Pjesa më e madhe e këtij brezi është në përdorim nga RTSH dhe operatorët privatë kombëtarë numerikë. Ndërkohë që frekuencat e mbetura të lira janë ende të pashfrytëzuara.

Aktualisht, nisur nga zhvillimet e fundit lidhur me lirimin e brezit 700 MHz, procesi i dhënies në përdorim të kanaleve të lira konsiderohet i pezulluar, deri në një vendimarrje përfundimtare mbi gjetjen e zgjidhjeve teknike mbi përdorimin e brezit të mbetur (470-694 MHz).

Nga përlllogaritjet rezulton se 30.9 % e kanaleve të frekuencave të përcaktuara nga AMA për 5 rrjetet UHF private kombëtarë i përkasin brezit DD2.



**Kanalet e caktuara për licencimin e operatorëve privatë kombëtar dhe atyre me eksperiencë në transmetimet numerike**

| Numri i Rrjeteve | Allot. SHK | Allot. KU | Allot. DI | Allot. LE | Allot. TR | Allot. EL | Allot. FR | Allot. BR | Allot. KO | Allot. GJR | Allot. VL |
|------------------|------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|-----------|
| MUX-3            | 34         | 50        | 55        | 33        | 41        | 42        | 35        | 32        | 51        | 44         | 46        |
| MUX-4            | 59         | 40        | 30        | 46        | 53        | 48        | 28        | 36        | 55        | 29         | 57        |
| MUX-5            | 45         | 42        | 25        | 29        | 59        | 49        | 22        | 54        | 57        | 50         | 43        |
| MUX-6            | 22         | 36        | 54        | -         | 57        | 46        | 29        | 24        | 21        | 48         | -         |
| MUX-7            | 51         | 52        | 60        | -         | 39        | 40        | 45        | 47        | 27        | 35         | 51(D D2)  |

Ndërkohë, bazuar në Planin Numerik kanalet e brezit UHF që janë të lira në disa allotmente të vendit dhe janë parashikuar për licencimin e operatorëve lokalë/rajonale, i përkasin pothuajse të gjitha brezit DD2, duke përfshiruar vetëm 2 prej tyre (nga 12 gjithsej).

**Kanalet e caktuara për licencimin e rrjeteve numerike të operatorëve privatë lokalë e rajonale**

| Allot. SHK | Allot. KU | Allot. DI | Allot. LE | Allot. TR | Allot. EL | Allot. FR | Allot. BR | Allot. KO | Allot. GJR | Allot. VL |
|------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|-----------|
|            | 56 (DD2)  |           |           |           | 56(DD2)   |           | 52(DD2)   | 28        | 38         |           |
|            |           |           |           |           | 58(DD2)   |           |           | 59(DD2)   | 53(DD2)    |           |
|            |           |           |           |           |           |           |           |           | 56(DD2)    |           |
|            |           |           |           |           |           |           |           |           | 58(DD2)    |           |
|            |           |           |           |           |           |           |           |           | 60(DD2)    |           |

Sa më sipër, lirimi i brezit DD2 do të çojë në tkurrje të numrit të operatorëve audiovizivë dhe zvogëlimin e kapaciteteve transmetuese. Reduktimi i numrit të operatorëve do të sjellë ndikim negativ në gjithë tregun mediatik, pasi një kapacitet më i vogël teknik, do të ulë numrin e programeve audiovizive të ofruara, do të cenojë parimin e konkurrencës në kushtet që numri i OSHMA-ve do të zvogëlohet. Shanset për një pluralizëm të shërbimeve programore do të jenë të pakta.

Në këtë kuadër, AMA është duke bashkëpunuar me MIE dhe AKEP për gjetjen e zgjidhjeve të favorshme për operatorët audiovizivë nga njëra anë dhe për publikun e gjerë nga ana tjetër.

#### **11.4.2 Koordinimi i frekuencave të brezit audioviziv**

Në zbatim të Planit të Veprimit të Dokumentit Strategjik të AMA-s 2017-2019, ku një ndër veprimtaritë e planifikuara është edhe koordinimi me vendet nënshkruese të Marrëveshjes së GE06 mbi riorganizimin e frekuencave të planeve frekuencore përkatëse për evidentimin e hapësirave të optimizimit dhe të shtimit të kapaciteteve transmetuese, AMA, gjatë vitit 2018, ka vijuar procesin e koordinimit me vendet fqinjë.

Bazuar në kërkesat e ardhura për koordinim nga vendet fqinjë, AMA ka kryer studimet teknike dhe ka verifikuar përputhshmërinë e propozimeve të paraqitura nga vendet e rajonit me përcaktimet në Planin GE06. Administratat e Malit të Zi, Maqedonisë, Greqisë dhe Bullgarisë kanë kërkuar miratimin e AMA-s lidhur me caktime frekuencore, sipas të cilave Shqipëria është konsideruar e prekur nga ndryshimet e këtij Plani.

Nga këto kërkesa vihet re se këto shtete kanë filluar të lirojnë brezin DD2, duke ndryshuar allotmentet dhe caktimet frekuencore të tyre.

#### **11.4.3 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio**

Sa i takon planifikimit dhe administrimit të spektrit audio 87.5-108 MHz, AMA ka vlerësuar periodikisht kapacitetet e lira të frekuencave audio dhe ka përditësuar Planin e Përdorimit të frekuencave për këto shërbime.

Zonat që identifikohen problematike në lidhje me disponueshmërinë e frekuencave të lira mbeten qarqet Tiranë, Durrës dhe Fier, ndërkohë për të gjithë zonat e tjera disponohen resurset e nevojshme. Gjatë vitit 2018 është kryer një studim mbi përdorimin e brezit frekuencor audio FM, me qëllim identifikimin e frekuencave të lira dhe rritjen e numrit të burimeve të fundme frekuencore, veçanërisht për zonat e shërbimit me dendësi të madhe operatorësh audio.

Me qëllim rritjen e konkurrencës, llojshmërisë së programacioneve kulturore, ekonomike, sociale, sidomos në zonat ku nuk ka operator privat analog lokal/ rajonal, AMA ka çelur dy (2) gara për dhënien e licencave të transmetimit audio analog:

- Vendimi nr.29, datë 21.02.2018 “Çeljen e procedurës së dhënies së 16 licencave të transmetimit audio analoge private”.
- Vendimi nr.119, datë 16.05.2018 “Për çeljen e garës për dhënien e licencave të transmetimit audio analoge private”.

Bazuar në këto procedura kanë rezultuar fitues dhe janë licencuar dy (2) subjekte të rinj për ofrimin e shërbimit audio FM, ku njëri subjekt është licencuar për zonën e shërbimit “Qarqet Tiranë dhe Durrës”, ndërsa tjetri për zonën e shërbimit “Bashkitë Korçë dhe Devoll”.

Në funksion të detyrave që ka AMA, ka kryer gjithashtu studime mbi kërkesat e paraqitura nga subjektet audio për ndryshim të karakteristikave teknike të transmetimit (si Radio Val e Kaltër, Radio Saranda, Radio Maria etj). Studimet konsistojnë në kryerjen e llogaritjeve teknike mbi mbulimin e zonës së shërbimit me sinjal dhe shmangien e interferencave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë vitit 2018 janë kryer gjithashtu procedurat e koordinimit, në përputhje me aktet finale të Konferencës Rajonale GE-75 “Për transmetimet audio në brezat frekuencor LF/MF (Rajoni 1 dhe 3)”, në zbatim të notifikimeve të ardhura, kryesisht nga administrata e Italisë.

#### **11.5 Adresimi i interferencave të shkaktuara nga operatorët audio/udiovizive**

Në kuadër të përmirësimit në identifikimin e interferencave që vijnë nga vendet fqinje dhe atyre të shkaktuara nga pikat transmetuese në territorin e Shqipërisë dhe marrjen e masave për eliminimin e tyre, gjatë vitit 2018 janë kryer monitorime të shpeshta në zonat kufitare. Konkretisht, janë kryer matje periodike në zonën e Shkodrës, Durrësit, Korçës, Himarës, Sarandës dhe Pogradecit. Në këto zona janë konstatuar (matur) sinjale të stacioneve Radio FM të vendeve fqinjë. Në shumicën e rasteve këto ndërhyrje nuk kanë pasur ndikim, pasi transmetimet nuk kanë qenë në frekuenca të njëjta.

Përrjashtim bën rasti i konstatuar në muajin tetor në zonën e Korçës, ku subjekti audio Radio “Fantasy” (91.1 Mhz) kishte ndikim nga sinjali i emetuar nga një stacion grek. Theksojmë se, gjatë periudhës së verës vlerat e sinjaleve të matura nga stacionet Radio FM të vendeve fqinjë janë të larta, sidomos në zonën e Ultësirës Perendimore.

*1. Adresimi i interferencave të shkaktuara brenda vendit*

Për sa u përket interferencave të shkaktuara brenda vendit, gjatë vitit 2018 nuk janë konstatuar si dhe nuk janë raportuar nga ana e subjekteve audio dhe audiovizivë.

*2. Adresimi i interferencave të shkaktuara në vendet fqinjë.*

Kemi pasur raste të ndikimit të stacioneve tona radiofonike ndaj stacioneve të vendeve fqinjë. Konkretisht, në muajin tetor ka pasur një ankesë nga Radio “Elita” e Malit të Zi për ndikim në sinjalin e tij nga subjekti radiofonik Radio” Eagle”, që transmeton në frekuencën 94 Mhz nga pika Fushë-Dajt. Ndaj këtij subjekti AMA mori masat e duhura dhe interferenca u eliminua.

Edhe këto ankesa AMA i ka trajtuar me prioritet, duke bërë të mundur eliminimin e tyre në një kohë shumë të shkurtër.

## **12 AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RRITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL**

### **12.1 Organizimi i brendshëm i institucionit**

Gjatë vitit 2018, si rezultat edhe i analizave vjetore të kryera mbi strukturën aktuale të institucionit, AMA, në mbështetje të nenit 15, pika 2 e Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton kompetencën ligjore të Kuvendit të Shqipërisë për miratimin e propozimeve për strukturën organizative të institucionit të AMA-s, paraqiti pranë Kuvendit kërkesën për një ndryshim të vendimit nr.19/2016 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

Kërkesa për ndryshime në strukturën dhe organikën ekzistuese ishte një nevojë për një riorganizim me shtim funksionesh të reja në dy prej njësive organizative në AMA, duke mundësuar funksionimin dhe përmbushjen më të mirë të detyrimeve të këtyre Drejtorive. Ndryshimi strukturor u reflektua konkretisht:

- Studio e Monitorimit dhe Arkivës në Drejtorinë e Mbikqyrjes, u shtua me dy pozicione pune mbështetëse, të cilët do të bëjnë të mundur funksionimin 24 orë të regjistrimit të përmbajtjeve të subjekteve kombëtare audio dhe audiovizive në shfrytëzim të kapacitetit të plotë teknik dhe teknologjik që ka në dispozicion AMA.
- Zyra e Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë u shtua me një punonjës me qëllim adresimin më të mirë të nevojave dhe ngarkesës së kësaj zyre, për shkak të volumit të dokumentave hyrëse dhe dalëse në AMA.

Duke marrë në konsideratë propozimet e paraqitura nga AMA, këto ndryshime u miratuan me vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Nr. 77/2018 "Për një ndryshim në vendimin nr. 19/2016 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) duke shkuar numri total i punonjësve në 61 punonjës. Bashkëlidhur raportit gjendet struktura dhe organigrama e AMA-s si Aneks nr. 2.

Hartimi i udhëzimeve për vendosjen e rregullave të brendshme

Në kuadër të objektivit të Planit Strategjik të Veprimit 2017-2019 mbi vendosjen e rregullave të reja dhe gjithëpërfshirëse të brendshme, gjatë vitit 2018 janë miratuar aktet e mëposhtme nënligjore:

- Udhëzimi "Për rregullat, sjelljen dhe komunikimin në ambientet e brendshme të punës".
- Udhëzimi "Për parimet dhe rregullat e përgjithshme për menaxhimin e aktiveve në Autoritetin e Mediave Audiovizive".
- Strategjia e Komunikimit të AMA-s.

Miratimi dhe hyrja në fuqi e akteve të mësipërme i ka shërbyer zbatimit efektiv të rregullave të sjelljes së punonjësve, të cilët kanë përgjegjësi për dhënien e kontributit në mbarëvajtjen e mirë të institucionit me qëllim zbatimin me sukses të misionit të AMAs.

## 12.2 Programi i transparencës

Si një institucion i pavarur publik, AMA funksionon në përputhje me standardin e transparencës duke siguruar gjatë veprimtarisë së tij zbatimin rigoroz të detyrimeve që rrjedhin prej Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Përgjatë vitit 2018, në zbatim të nenit 5 të Ligjit nr. 119/2014, AMA ka kryer rishikimin e Programit të Transparencës të miratuar me urdhrin nr. 131 datë 24.04.2015, duke e përditësuar me ndryshimet e nevojshme.

Në procedurën e rishikimit janë vlerësuar të gjitha problematikat e shfaqura prej miratimit dhe publikimit për herë të parë të programit të transparencës, përfshirë rekomandimet e Komisionerit për konceptimin dhe zbatimin e programeve, janë vlerësuar praktikrat e mira ndërkombëtare të miratuara në Autoritete Publike të njëjta, duke synuar në tërësi përmirësimin e tij.

Në përgatitjen e rishikimit të programit të transparencës është mbajtur parasysh interesi më i lartë i publikut, me qëllim pakësimin e nevojave për kërkesat individuale për informacion dhe sidomos:

- Garantimin e njohjes maksimale me informacion;
- Vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- Modelet e miratuara për kategoritë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Rritja e transparencës dhe llogaridhënies, në veçanti duke siguruar funksionimin efikas dhe transparent të sistemit të prokurimit publik, menaxhimit të financave publike, legjislacionit, mekanizmave monitorues, strukturës organizative të AMA-s, deklaratimet e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, kanë qenë thelbësore në veprimtarinë e AMA-s.

Në kuadër të zbatimit të Ligjit 119/2014 dhe qasjes proaktive për informacione që promovojnë interesin publik të përcaktuar në drejtim të dhënies së informacionit, AMA ka miratuar udhëzimin “Mbi procedurat për bashkërendimin e punës me koordinаторin për të drejtën e informimit në Autoritetin e Mediave Audiovizive në zbatim të Ligjit nr. 119/2014. Nëpërmjet këtij udhëzimi janë përcaktuar qartazi procedurat operacionale specifike lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë e koordinatorëve të së drejtës së informimit, proceset konkrete në realizimin e detyrave të koordinatorëve, duke përcaktuar në mënyrë të qartë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre dhe të hallkave të tjera të institucionit.

Në shërbim të publikut dhe përmirësimit të procedurave administrative, pjesë e transparencës janë dhe formularët digjital për ankesa/aplikime, duke mundësuar thjeshtimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut.

Për vitin raportues, pranë AMA-s kanë ardhur rreth 159 (njëqindpesëdhjetëenëntë) kërkesa, të cilat gjenden të pasqyruara edhe në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve në faqen zyrtare të autoritetit, [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al) nën Rubrikën Veprimtari/Transparenca.

Ankimi në gjykatë si e drejtë që u është njohur nga ligji subjekteve të së drejtës ka bërë që AMA të jetë palë në procese gjyqësore si në cilësinë e palës së paditur, ashtu edhe të palës paditëse.

Vendimet administrative që kundërshtohen gjyqësisht kryesisht lidhen me miratimin e sanksioneve administrative (gjoba), mosdhënien/mosrinovimin e licencave/autorizimeve, heqjen apo pavlefshmërinë e tyre, etj. AMA, si person juridik publik ka investuar në disa raste organet gjyqësore, duke paditur subjektet audiovizive që rezultojnë debitorë ndaj AMA-s ose Buxhetit të Shtetit. Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, gjatë vitit 2018 janë depozituar 34 kërkesë padi/kërkesa për lëshim urdhëri ekzekutimi për subjektet debitorë, të cilëve u është hequr licenca/autorizimi me vendim të AMA-s.

Gjykimi i çështjeve gjyqësore pranë gjykatave administrative ka ndikuar këto procese të përfundojnë brenda një afati të shkurtër.

Gjatë kësaj periudhe, përveç ndjekjes së proceseve të iniciuara gjatë vitit raportues, AMA ka vijuar ndjekjen e proceseve gjyqësore të hapura përpara vitit 2018, të cilat për shkak të ushtrimit të ankimeve apo rekurseve prej palëve ndërgjyqëse janë në proces gjykimi në Gjykatat e Apelit apo Gjykatën e Lartë.

Pasqyrimi në mënyrë të përmbledhur i çështjeve gjyqësore në gjykim, në tre shkallët e gjyqësorit, jepet në Aneksin nr. 3, bashkëlidhur.

### **12.3 Aktivitete të Autoritetit**

Edhe për vitin 2018 AMA ka vazhduar aktivitetet e saj me grupet e interesit në lidhje me çështje të rëndësishme që prekin median audiovizive.

#### ***Takimet për ndryshimin në ligjin e AMA-s***

- Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) organizuan katër forume diskutimi në harkun kohor të një muaji (dhjetor 2018-janar 2019), periudha e konsultimit publik mbi ndryshimet në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Këto projektligje kanë në fokus krijimin e një kornize ligjore për rregullimin e përmbajtjes së informacionit që ofrohet online nga ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike, me qëllim garantimin e së drejtës së informimit, të drejtës së përgjigjes si dhe mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në kohën që mediat online po zënë vend gjithnjë edhe më shumë në hapësirën mediatike shqiptare ka lindur e udhës që veprimtaria e tyre të rregullohet edhe nga ana ligjore.

AMA, në fund të çdo forumi diskutimi, ka përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë të gjitha diskutimet dhe qëndrimet e pjesëmarrësve për secilin nga takimet.

## ***Gjuha e urrjetjes në median audiovizive***

- Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, në muajin nëntor, organizoi Tryezën e Rrumbullakët me temë “Gjuha e urrjetjes në mediat audiovizive”. Qëllimi i kësaj Tryeze ishte skanimi i situatës përmes prezantimeve të studiuesve dhe ekspertëve të fushës, të cilët ndanë pikëpamjet e tyre analitike në lidhje me gjuhën e urrjetjes në mediat audiovizive.
- AMA, me mbështetjen e Këshillit të Evropës, organizoi në muajin qershor tryezën e përbashkët të diskutimit me temë: “Përmirësimi i raportimit në median audiovizive për të ndaluar diskriminimin dhe përdorimin e gjuhës së urrjetjes”. Të ftuar ishin përfaqësues nga OSHMA-të, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës, nga shoqatat dhe organizatat mediatike etj.

## ***Rregullimi ligjor në marrëdhëniet e punës së gazetarëve në transmetimet audiovizive***

- Komisioni për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë dhe AMA zhvilluan në muajin maj Tryezën e Diskutimit “Rregullimi ligjor në marrëdhëniet e punës së gazetarëve në transmetimet audiovizive”.

Prej kohësh për këtë çështje janë të njohura problematika të hasura si, niveli i kushteve të punës së gazetarëve, format e rekrutimit dhe largimit nga redaksia, mosshlyerja në kohë e pagesave nga punëdhënësi, organizimi i gazetarëve ose mosorganizimi në shoqata, funksionaliteti i tyre etj.

Ndaj dhe në muajin maj, AMA dhe Komisioni, për herë të parë u ulën në një tryezë diskutimi me përfaqësues nga të gjitha grupet e interesit: gazetarë, drejtues mediash, nga shoqatat dhe organizatat e tyre, anëtarë të Parlamentit, profesorë të gazetarisë, institucionet shtetërore që mbulojnë aspekte të punësimit etj. Gjatë diskutimit mes pjesëmarrësve pati qëndrime të ndryshme, por e përbashkëta ishte se që prej fillimeve të demokracisë e në vijim, ka ardhur koha për veprime në sigurimin e lirisë së medias. Pa një gazetar të sigurt në punë nuk mund të kemi media të lirë dhe pluraliste, u tha nga diskutantët. Në Tryezë u bënë 5 propozime nga pjesëmarrësit:

- *Kontratë individuale pune* (me afat të pacaktuar), ku duhet që OSHMA-të, në lidhjen e marrëveshjeve kontraktore me gazetarët duhet të parashikojnë gjithnjë një kohëzgjatje të Kontratës individuale me afat të pacaktuar në respektim të Nenit 140, paragrafi 2, të Kodit të Punës, përveç rasteve kur ka arsye objektive në lidhje me natyrën e përkohshme të detyrës së gazetarit.

- *Formimi profesional për pranimin në punë të gazetarit*, pasi me qëllim rritjen e cilësisë dhe larmisë së përmbajtjeve të transmetuara audio dhe audiovizive, OSHMA-të gjatë procedurave të marrjes në punës, duhet të inkurajojnë, mbështesin, promovojnë persona që kanë formimin profesional të kërkuar dhe të nxisin motivimin dhe përgjegjësinë për kryerjen e detyrave brenda dhe jashtë redaksisë ku angazhohen.

- *Përshkrimi i punës së gazetarit*, pasi bazuar në Nenin 21, paragrafi 3, gërma c e Kodit të Punës, përshkrimi i punës është një element i domosdoshëm për t’u parashikuar në Kontratën e Punës, sepse specifikisht e lidh marrëdhënien e punës në rastin në fjalë të Punëdhënësit dhe gazetarit me kryerjen e detyrave të parashikuara në përshkrimin e punës dhe jo në detyra të tjera shtesë.

- *Paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të gazetarit.* Në progres-raportet e BE-së i kushtohet vëmendje e posaçme garantimit të zbatimit të duhur të të drejtave të punës, sidomos të drejtave të gazetarëve, për pajisjen me kontratë të rregullt punësimi, çka nënkupton ndër të tjera, edhe deklarimin real të pagës së përfituar. Sa u përket pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat personale, punëmarrësi duhet të kontrollojë periodikisht çdo muaj, nëse punëdhënësi i tij ka kryer rregullisht derdhjet brenda afateve ligjore.

- *Transparenca në faqen web të OSHMA-së e listës së gazetarëve të punësuar,* ku të gjitha OSHMA-të duhet të kenë të publikuara në faqet e tyre web listën e gazetarëve të punësuar pranë tyre në detyrat përkatëse.

### ***Masa kundër piraterisë televizive***

- AMA, organizoi në muajin maj një takim me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në praninë dhe të operatorëve privatë mbi fenomenin e piraterisë televizive. Qëllimi i takimit ishte ndërmarrja e hapave konkrete për rritjen e bashkëpunimit mes dy autoriteteve, operatorëve audiovizivë dhe ofruesve të shërbimit të internetit, për rritjen e efikasitetit në luftën kundër piraterisë televizive nëpërmjet një koordinimi gjithëpërfshirës dhe një procesi të mirëregulluar, përmes të cilit garantohen rezultate konkrete në luftën kundër fenomenit.

### ***Media literacy***

- Këshilli i Ankesave pranë AMA-s organizoi në muajin maj Tryezën e Rrumbullakët me temë Edukimi për Median: “Takim i grupit të ekspertëve – Koordinimi dhe sinergjitë mes palëve për një komunikim të përgjegjshëm etik”. Qëllimi i tryezës ishte ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi konceptin e edukimit mediatik

### ***Respektimi i standartit të Shqipes në transmetimet audiovizive***

AMA zhvilloi në muajin prill tryezën e diskutimit “Respektimi i standartit të shqipes në transmetimet audiovizive”. Kjo temë u trajtua në funksion të respektimit të standartit të folur dhe të shkruar të shqipes në përmbajtjet audiovizive.

Gjatë takimit u bënë të njohura problematikat e hasura nga AMA në respektimin e normave të standartit të shqipes nga televizionet kombëtare dhe ato informative, të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në audiencë.

*Në këtë kuadër AMA ka zhvilluar po ashtu :*

Tryezën e diskutimit: “Respektimi i standartit të gjuhës shqipe në transmetimet audiovizive”, në muajin qershor. Në këtë tryezë, ishin të ftuar të merrnin pjesë të gjithë OSHMA-të e qarkut Shkodër, Korçë dhe Vlorë.

### ***Paketimi i lajmit, alternativa dhe strategji në kohën dixhitale***

AMA organizoi në muajin shkurt aktivitetin “Paketimi i lajmit, alternativa dhe strategji në kohën dixhitale”, në një auditorium mes profesionistëve të lajmit. Ky diskutim shkon paralelisht me objektivin e AMA-s për përmirësimin e standardeve profesionale në departamentet e informacionit nga OSHMA-të. Ndërkohë, ky diskutim është në vazhden e fushatës që AMA ka për implementimin e Kodit të Transmetimit.



## ***Matja e audiencës***

AMA organizoi në muajin shkurt takimin e parë konsultues për rregullimin e matjes së audiencës në Shqipëri. Matja e audiencës televizive është një aspekt mjaft i rëndësishëm për rregullimin e tregut dhe bën pjesë në grupin e veprimtarive që AMA organizon, mbështet dhe promovon në përputhje me dispozitat e Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, nenet 19 (pika 2 germa c) dhe 23 (pika 1 germa ç). Në tryezën e organizuar nga Autoriteti i Mediave ishin të ftuar të gjitha palët e interesit, televizionet kombëtare dhe rajonale, shoqatat dhe agjencitë e komunikimit, kompanitë e reklamave, dhe kompanitë që masin audiencën. Në vijim të këtij takimi AMA ka kërkuar asistencën e Këshillit të Evropës për të siguruar një ekspert të kësaj fushe i cili të prezantojë AMA-n me metodat më të mira mbi mënyrën se si realizohet matja e audiencës në vendet evropiane dhe ato të rajonit si, të rekomandojë 2-3 modele të përshtatshme për realitetin shqiptar duke i dhënë AMA-s kështu ekspertizën e nevojshme për të përmbushur rolin e saj në këtë proces. Këshilli i Evropës e ka miratuar kërkesën e AMA-s, dhe në tre-mujorin e parë të 2019 pritet që eksperti i kontraktuar nga Këshilli i Evropës të dalë me përfundimet e tij.

## ***Tryezë e rrumbullakët - Mbrojtja e fëmijëve në median audiovizive***

-Këshilli i Ankesave në AMA, organizoi në janar të vitit 2018 Tryezën e Rrumbullakët, me temë “Mbrojtja e fëmijëve në shërbimet e medias audiovizive – Sfidat drejt së ardhmes”. Tryeza e Rrumbullakët synoi të promovojë kulturën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në transmetimet audiovizive e të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe të gjithë aktorëve të interesuar mbi këtë çështje.

## ***AMA kontribon në pasurimin e pyllit orbital***

- Në muajin shkurt, AMA i u bashkua aksionit të Bashkisë Tiranë për gjelbërimin e qytetit me dhurimin e 100 pemëve. Pemët e dhuruara nga AMA u mbollën pranë liqenit të Farkës, si pjesë e projektit të Pyllit Orbital.

## ***AMA i bashkohet programit të kryqit të kuq shqiptar për dhurimin vullnetar të gjakut***

- Në muajin shkurt stafi i AMA-s mori pjesë në pasurimin e bankës së gjakut, program i Kryqit të Kuq Shqiptar, me qëllim sigurimin e gjakut të mjaftueshëm dhe të sigurt në vend.

AMA ka zhvilluar dhe mbajtur gjatë vitit 2018 marrëdhënie shumë të mira dypalëshe me autoritetet rregullatore në rajon. Përmendim këtu vizitën e autoritetit grek, Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit Grek (NCRTV) në Tiranë, në muajin qershor.

Vizitën e Autoritetit të Kosovës, Komisioni i Pavarur i Medias së Kosovës (KPM) në Tiranë, në muajin shtator dhe po ashtu edhe vizitën e Autoritetit Maqedonas, Agjencisë së Medias për Shërbimet Audio dhe Audiovizive, në muajin mars.

Në këto takime u diskutuan sfidat e tregut audioviziv në një realitet gjithmonë e më të ngjashëm në kontekstin e ri të ndërtuar nga teknologjia.

Përfaqësuesit e AMA-s kanë mbajtur kontakte të vazhdueshme me homologët, në kuadër të pjesëmarrjes së tyre në organizmat evropiane apo rajonale të medias audiovizive, si EPRA, ERGA, BRAF, MNRA etj. Në fokusin e diskutimeve të takimeve ndërkombëtare kanë qenë: përshtatja e direktivave evropiane me legjislacionin kombëtar në fushën audiovizive, shqyrtimi i përmbajtjeve të transmetuara dhe procedimi me ankesat mbi shkeljet ligjore, metodologjitë efektive për matjen e audiencës; mbrojtja e fëmijëve në përmbajtjet audiovizive, reklamat, gjuha e urrjetjes dhe diskriminimit, qasja tek veprat evropiane etj.

#### **12.4 Botimet e Autoritetit**

AMA, gjatë vitit 2018, ka vijuar me publikim e radhës së Buletinit Periodik, konkretisht nr. 3 dhe nr. 4 me të dhëna nga dinamika e tregut audioviziv në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2018, gjithashtu u botua edhe Buleti i Ankesave nr. 4 dhe nr. 5. Këto dokumente janë një përmbledhje të ankesave që vijnë në AMA në lidhje me përmbajtjet audiovizive.

Gjithashtu, u publikua revista “Fakenews”, punim nga Këshilli i Ankesave pranë AMA-s. Revista është një përmbledhje e konferencës që zhvilloi AMA po me këtë temë.

Gjatë vitit 2018 u publikua Revista periodike e AMA-s nr. 4 dhe nr. 5. Revistat e AMA-s janë një përmbledhje e aktiviteteve të saj gjatë vitit ose shqyrtime tematike me interes për publikun.

Publikohet “Kodi i Transmetimit” si një nga dokumentet thelbësorë në trajtimin e çështjeve që përfshijnë moralin dhe etikën në materialet programore, veçanërisht paraqitja e sjelljeve të dhunshme dhe seksuale të realizohet me kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të të miturve dhe OSHMA-ve. Kodi i ri i Transmetimit është i aksesueshëm edhe në faqen e AMA-s.

Botimet periodike të AMA-s gjenden në versionin e tyre online edhe në faqen zyrtare të AMAs, [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al).

#### **12.5 AMA në bashkëpunim me partnerët**

AMA, në bashkëpunim me Institutin Politik të Studimeve Humane, ka mundësuar botimin e disa librave të fushës së shkencave të komunikimit dhe medias, *Koleksioni Meduza*. Koleksioni Meduza përmban botimet:

- “SOCIOLOGJIA E TELEVISIONIT”, nga Brigitte Le Grignou. Tradita e ekonomisë politike e mendon televizionin si industri kulturore, si sektor ekonomik i veprimtarive të cilat I duhen kuptuar aktorët risitë dhe strategjitë e pushimit të tregjeve dhe audiencës. Si strukturohen marrëdhëniet e forcave mes kanaleve, mes shpërndarësve dhe prodhuesve dhe mes platformave të shpërndarjes janë disa nga çështjet që trajton libri.

- “SHPËRTHIMI I GAZETARISË”, nga Ignacio Ramonet. Ky libër përfshin të gjitha ngjarjet e 30 viteve të fundit brenda këtij togfjalëshi që i shërben për titull. Madje kuptimet mbivendosen, sepse me shpërthimin e gazetarisë nënkuptojmë edhe kapitullimin e një modeli dhe lindjen e një gazetarie të re në kushtet e shpërthimit social-kulturor.
- “TELEVISIONI DHE KULTURA RINORE”, nga Jan Jagodzinski. Fokusi i librit qëndron në serialet për të rinjtë, të gjithpranishme në televizor, në dukje të padëmshme, por që vazhdimisht na pushtojnë shtëpitë dhe jetën e përditshme.
- “HISTORIA E PROGRAMEVE TELEVIZIVE AMERIKANE”, nga James Roman. Televizioni amerikan ka qenë po ashtu protagonist i ndryshimeve dhe rojar i shijes. Ekonomia e televizionit është po ashtu një fushë e rëndësishme studimi. Procesi krijues, i përfshirë në prodhimin e programeve për television, është gjithashtu një aspekt interesant në lidhje me kush vendos rendin e temave dhe përmbajtjes së programit.

Në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Medias janë publikuar:

- “PORTRETIZIMI I GRAVE DHE VAJZAVE NË MEDIAN ELEKTRONIKE” me autore Valbona Sulçe Kolgeci. Ky libër me vlerë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit i drejtohet një audience që është e lidhur me produktet e gazetarisë në Shqipëri, me synim rritjen e cilësisë së transmetimit dhe publikimit të lajmeve. Libri erdhi si një nevojë e domosdoshme për të përqasur metoda dhe përvoja të gazetarisë përëndimore me terrenin shqiptar.
- “PRIVATËSIA, LIRIA E SHPREHJES DHE TRANSPARENCA”, grup autorësh. Libri trajton përhapjen e internetit dhe lehtësimin që kjo e fundit po i shkakton lidhjes mes individëve dhe pjesëve të ndryshme të botës. Gjithashtu, edhe kontekstit të ri të ndërtuar prej kësaj shpejtësie në komunikim dhe botës virtuale të krijuar nga ky lloj i ri i komunikimit, që në disa aspekte është jo më pak e rëndësishme se bota tradicionale.
- “ALFABETIZIMI NË MEDIA DHE INFORMIMI”, grup autorësh. Ky libër trajton peizazhin gjithmonë e më shumë kompleks të medias dhe informacionit që ka rol primar në jetën tonë të përditshme, por ndryshon me shpejtësi. Ai vazhdimisht po ndryshon mënyrën se si komunikojmë, mundëson dhe sfidon të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes, aksesin universal në informacion, forcimin e paqes, zhvillimin e qëndrueshëm dhe dialogun ndërkulturor.

## 12.6 Marrëveshjet e bashkëpunimit

Në kuadër të rritjes së bashkëpunimit mes institucioneve të tjera shtetërore, AMA ka ndërmarrë disa iniciativa për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim krijimin e hapësirave dhe thellimin e formave të bashkëpunimit.

Iniciativa për lidhjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi midis institucioneve vjen gjithashtu në vijim të kërkesës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë mbi krijimin e hapësirave dhe thellimin e formave të bashkëpunimit midis organeve të krijuara me ligj, sikurse janë institucionet e shtetit shqiptar.

Mbështetur në sa më sipër, si dhe duke konsideruar se bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë mes AMA-s dhe këtyre institucioneve do të përmirësojë standardet dhe kushtet për një treg audioviziv të lirë dhe efektiv në përputhje me standardet evropiane, AMA, brenda periudhës raportuese ka propozuar nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke përgatitur draft-marrëveshje, objekt i të cilave është përcaktimi i fushave dhe formave të bashkëpunimit për vendosjen dhe garantimin e zbatimit të Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Më konkretisht, AMA gjatë vitit 2018, ka propozuar dhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet si më poshtë:

#### **1. Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Autoriteti i Konkurrencës**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është përcaktimi i fushave dhe formave të bashkëpunimit për vendosjen dhe garantimin e zbatimit të rregullave për një konkurrencë të lirë dhe efektive në fushën e mediave audiovizive.

#### **2. Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është rregullimi i marrëdhënieve dhe modaliteteve, ndërmjet DPPSH dhe AMA, në fushën e parandalimit, zbulimit dhe hetimit të personave që ushtrojnë aktivitetet të kundërligjshëm, në fushën e mediave audio/audiovizive, për bllokimin apo ndalimin e funksionimit të pajisjeve transmetuese audiovizive.

#### **3. Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave**

Qëllimi i këtij memorandumi mirëkuptimi është vendosja e një bashkëpunimi të ndërsjelltë, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit jokonfidencial dhe të frytshëm, në funksion të veprimtarisë së dy institucioneve për forcimin e shtetit ligjor në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe garantimin e tsë drejtës për informim dhe lirisë së shprehjes.

#### **4. Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Drejtoria e të Drejtave të Autorit**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i modaliteteve dhe mënyrave të bashkëpunimit për shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve mes palëve, në kuadër të respektimit të përcaktimeve ligjore që rregullojnë fushën e transmetimeve audiovizive dhe atë të mbrojtjes së të drejtave të autorit legjislationit përkatës, që rregullon fushën e transmetimeve audiovizive dhe të së drejtës së autorit, për të vendosur nën kontroll të gjithë tregun e pronësisë intelektuale në fushën e artit, kulturës dhe shkencës, me qëllim garantimin e respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të.

Gjithashtu, gjatë vitit 2018, AMA është investuar për të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me institucione të tjera, marrëveshje që për aryse subjektive, jo të lidhura me Autoritetin e Mediave Audiovizive, nuk kanë mundur të finalizohen deri tani.

Këtu mund të përmendim:

1. Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)
2. Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT)
3. Prokurorinë e Përgjithshme (PP)
4. Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit (Ministria e Financës dhe Ekonomisë).

## **12.7 Publikimi i Buletinit Periodik të AMA-s**

Buletini Periodik i AMA-s është një set treguesish mbi performancën e tregut audioviziv në Republikën e Shqipërisë. Për dy vitet e para, 2016 dhe 2017, Buletini është publikuar në print dhe virtualisht çdo 6 muaj. Kurse për vitin 2018 dhe në vijim do të ketë frekuencë vjetore botimi, kjo për shkak të vetë karakterit dhe dinamikës që ka aktiviteti audio dhe audioviziv në vendin tonë. Të dhënat e përfshira në 4 edicionet e para të Buletinit Periodik (treguesit ekonomikë dhe financiarë, pronësia, përmbajtjet e emetuara, burimet njerëzore të angazhuara, niveli i mbulimit me sinjal etj) janë referuar dhe vijojnë të referohen në mjaft prezantime që bëhen mbi aspekte të ndryshme nga tregu audio/audioviziv në vendin tonë, në punime të detyrave të kursit apo të diplomave në të gjitha nivelet e studimit universitar, apo në trajtime që bëjnë organizata, shoqata apo institucione të ndryshme të vendit. Interes për edicionet e deritanishme të Buletinit ka pasur dhe nga organizatat dhe institucionet ndërkombëtarë që janë akredituar në Shqipëri, që kanë në fokus zhvillimin e problematikat e medias shqiptare, si OSBE, KiE, përfaqësi të trupave diplomatike etj.

## **12.8 Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore**

AMA, në zbatim të objektivave të vendosura në Planin Strategjik të Veprimit 2017-2019, edhe këtë vit ka pasur në fokus të veprimtarisë së saj ngritjen dhe forcimin e kapacitetit institucional, nëpërmjet rritjes së nivelit të kualifikimit dhe të trajnimit, përmirësimit të menaxhimit të burimeve njerëzore, rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, me qëllim krijimin e një administrate sa më funksionale, eficiente dhe të aftë për të realizuar misionin dhe objektivat e institucionit.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në zbatim të detyrave funksionale, ka pasur gjatë këtij viti në fokus rritjen në cilësi dhe profesionalizëm të stafit të AMA-s, duke i dhënë prioritet procesit të kryerjes së trajnimeve dhe zhvillimit profesional të punonjësve. Aktiviteti kryesor është orientuar në menaxhimin e një procesi efikas të trajnimeve, duke përcaktuar saktë nevojat për trajnim të stafit të AMA-s në përputhje me problematikat e evidentuara gjatë punës së përditshme nga strukturat përgjegjëse.

Në kuadër të zhvillimit të aftësive, përmirësimit dhe rritjes së efektivitetit në punë dhe në vijim të kalendarit të analizës së nevojave për trajnim, gjatë vitit 2018 janë organizuar 9 (nëntë) trajnime në AMA për të gjithë nëpunësit civil. Këto trajnime u zhvilluan në trajtën e tryezave të diskutimit ndërmjet nëpunësve civil të të gjitha niveleve të drejtorive të ndryshme, duke pasur si qëllim:

- Zhvillimin e aftësive, njohurive dhe profesionalizmit të stafit;
- Prezantimin e punonjësve të rinj me institucionin;
- Fokusi në përmirësimin e pikave të dobëta;
- Përgatitja e stafit për promovim dhe rritje profesionale në përshtatje me aftësitë e fituara.

## Trajnimet e realizuara gjatë vitit 2018:

- “Shërbimi civil dhe etika në administratën publike”. Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte jo vetëm prezantimi i punonjësve të rinj me administratën publike, por dhe ofrimi i njohurive bazë mbi legjislacionin e shërbimit civil, organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe rregullat e sjelljes për punonjësit e administratës publike.
- Ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pajisja e nëpunësve me njohuri të legjislacionit mbi mediat audiovizive, përditësimi i këtyre njohurive është një faktor i lidhur ngushtë me performancën e çdo nëpunësi.
- “Digjiitalizimi”. Nisur nga ecuria e procesit të dixhitalizimit si një proces kompleks, nëpunësit e AMA-s u njohën me fazën aktuale të këtij procesi, sfidat, transmetimet digjitale, pritshmëritë dhe rolin e AMA-s.
- “Kodi i Transmetimit për median audiovizive”. Nëpërmjet trajnimit u diskutua mbi ndryshimet ligjore të fundi të miratuara, parimet bazë të transmetimit, parimet dhe rregullat për programet informative, për mbrojtjen e të miturve në programet e të gjitha llojeve, kundër dhunës së skajshme në ekran, për komunikimet e ndryshme tregtare, respektimin e dinjitetit, mbrojtjen e të dhënave personale e të personave me aftësi të kufizuar etj.
- “Manuali i regjimit të qarkullimit, përpunimit dhe administrimit të dokumentacionit shkresor”. Ky manual është një referencë për çdo nëpunës në punën e tij të përditshme duke u njohur me mënyrën e qarkullimit të shkresave, përpunimit dhe administrimit të tyre brenda institucionit dhe rregullat dhe procedurat e mirëpërcaktuara dhe miratuara, për të rritur efikasitetin në punë e respektuar rigorozisht bazën ligjore në këtë drejtim.
- “Parimet dhe rregullat për menaxhimin e aktiveve në AMA”. Qëllimi kryesor i këtij trajnimi është njohja e çdo punonjësi në AMA me detyrimin e tij për përdorim sa më efektiv dhe ekonomik të aktiveve në AMA, duke shmangur shpërdorimin, keqpërdorimin dhe vjedhjen e tyre.
- Rregullorja për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e reklamave”. Qëllimi ishte përvetësimi i njohurive mbi format e reklamave, transmetimin, kushtet dhe kohën ditore të lejuar për transmetimin e reklamave, të cilat duhet të përmbushin standardet e Ligjit nr. 97/2013.
- “Inspektimi i veprimtarisë audiovizive të OSHMA-ve, njohja dhe zbatimi i rregullores së inspektimit”. Ky trajnim shërbeu për njohjen e stafit me rregullimin ligjor mbi zbatimin dhe përputhshmërinë me kushtet e licencës dhe/ose autorizimit, si dhe më shumë informacion mbi procedurën e inspektimit të veprimtarisë së të licencuarit/të autorizuarit.
- “Strategjia e Komunikimit të AMA-s”. Nëpërmjet këtij trajnimi stafi i AMA-s u njoh me Strategjinë e Komunikimit të AMA-s, duke u fokusuar në objektivat dhe metodologjinë e strategjisë, objektivat e komunikimit, grupet e interesit, kanalet e komunikimit, si dhe Planin e Komunikimit, që ka për qëllim informimin dhe promovimin me grupet e interesit dhe publikun e gjerë në lidhje me objektivat, nismat, progresin, impaktin dhe arritjet që ka veprimtaria e AMA-s në fushën e mediave audiovizive.

Në kuadër të planit të zhvillimit profesional të nëpunësit, AMA ka vlerësuar të rëndësishme pjesëmarrjen e disa përfaqësuesve në disa trajnime ndërkombëtare me qëllim zhvillimin dhe rritjen në aspektin profesional dhe personal të nëpunësit. Këtu mund të përmendim pjesëmarrjen e një punonjësi të AMA-s në trajnimin 1-mujor të ofruar nga Radio Kina, në kuadër të planit për trajnim për vendet në zhvillim, me temë: “Teknologjia e televizionit dixhital për vendet në zhvillim”, në Pekin.

Përmirësimi i njohurive shtesë me qëllim rritjen profesionale dhe kualifikimin e personave përgjegjës për prokurimet pranë Autoriteteve Kontraktore në fushën e prokurimit publik, ka qenë në vëmendje të kalendarit të trajnimeve. Falë bashkëpunimit me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike është bërë i mundur trajnim i thelluar profesional për dy punonjës të AMA-s.

Angazhimi i stafit të AMA-s për të plotësuar detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritetit në Bashkimin Evropian, përsa i përket fushës së politikave audio-vizuale, ka qenë i vazhdueshëm dhe me prioritet maksimal. Në këtë kuadër, AMA ka vlerësuar pjesëmarrjen dhe trajnimin e disa punonjësve të institucionit në trajnime që kanë patur si qëllim kryesor përmirësimin e njohurive dhe aftësitë profesionale të punonjësve të angazhuar në çështjet e BE-së në lidhje me çështjet që mbulohen nga Negociatat e Anëtarësimit. Konkretisht:

- Bashkëpunimin e vazhdueshëm me Shkollën Rajonale të Administratës Publike (RESPA), e cila ka si mision përmirësimin e bashkëpunimit rajonal, nxitjen e mësimin të përbashkët dhe mbështetjen e zhvillimit të administratës publike brenda vendeve të rajonit dhe përmes kësaj, duke mbështetur integritetin brenda BE-së. Në vijim të këtij bashkëpunimi është organizuar një trajnim 5 ditor me temë: “Mbi negociatat e pranimit në Bashkimin Evropian (kapitujt 23 dhe 24)” zhvilluar në datat 2-6 korrik 2018, në Danilovgrad, Mal i Zi. Ky trajnim kishte si qëllim kryesor të përmirësimin e njohurive dhe aftësitë profesionale të punonjësve të angazhuar në çështjet e BE-së në lidhje me çështjet që mbulohen nga Negociatat e Anëtarësimit për Kapitujt 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore) dhe 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria) me mundësinë e rrjetëzimit me kolegë nga rajoni.
- Trajnimi i ofruar nga “Cullen International” me temë: “Mastering european audiovisual regulation”. Ky trajnim u fokusua në prespektivën historike dhe instrumentat kyçe që formojnë rregullatorin audiovizual të BE-së, kornizën legislative ndërkombëtare të BE-së, duke u fokusuar në direktivën AVMSD.
- Në kuadër të një projekti binjakëzimi me Hungarinë, i cili u mbështet nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve, përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës, AKEP dhe AMA zhvilluar një vizitë studimore më 24-26 shtator 2018 në Hungari ku fokusi ishte zhvillimi i politikave spektrale dhe administrimi i spektrit. Pjesëmarrësit nga ministria dhe dy organe rregullatore kanë pasur mundësi të diskutojnë dhe shkëmbejnë informacione për aspekte të ndryshme të politikës së spektrit dhe administrimit të spektrit me autoritetin rregullator hungarez NMHH, duke përfshirë politikat për 5G, koordinimin ndërkufitar dhe marrëveshjet e harmonizimit në Evropë, transmetimin digjital të radios, monitorimin e spektrit dhe aspekte të tjera teknike.

Duke e vlerësuar si një metodë trajnimi efektive dhe eficiente, i cili ndihmon në zhvillimin e aftësive dhe fitimin e përvojës, krijimit dhe shkëmbimit të njohurive duke mësuar të tjerët dhe nxënë njëkohësisht, edhe përgjatë këtij viti u zhvilluan dy trajnime të tipit staf-retreat.

- Në kuadër të bashkëpunimit dhe ndërthurjes së përvojës ndërmjet Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), Tiranë dhe Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), Prishtinë, si dhe mbështetur në Marrëveshjen e Bashkëpunimit, ndërmjet dy Institucioneve, stafi i AMA-s, më datë 27 prill 2018, me ftesë të Komisionit të Pavarur të Mediave u bë pjesë e një aktiviteti të përbashkët mbi shkëmbimin e eksperiencave reciproke sa i përket konsultimeve praktike mbi rregulloret e funksionimit të dy institucioneve respektive dhe fokusimit në praktikat e punës në disa aspekte të aktivitetit të përditshëm. Ky aktivitet u shoqërua dhe me një vizitë studimore në ambientet e punës së Komisionit të Pavarur të Mediave, Kosovë. Takim i përbashkët shërbeu në funksion të rritjes e zhvillimit të efikasitetit dhe përmirësimit të bashkëpunimit e ndihmës reciproke, sa i përket misionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive mbi rregullimin dhe menaxhimin e shërbimeve audiovizuale.
- Pjesëmarrja e punonjësve të AMA-s në aktivitetin trajnues me temë “Transmetimet audiovizive, roli i gjithësecilit në identifikimin, sinjalizimin e problematikave dhe bashkëpunimi me njësitë organizative në AMA, për respektimin e Kodit të Transmetimit”. Ky aktivitet trajnues për punonjësit u zhvillua në Strugë, Maqedoni.

Trajnimet dhe aktivitetet e realizuara në formën e staf-retreat nxitën komunikimin, shkëmbimin e informacionit, ideve dhe eksperiencat e ndërsjellta mes punonjësve.

AMA i ka dhënë rëndësinë që i takon trajnimit dhe zhvillimit të stafit në fusha të veçanta të njohurive dhe aftësive, sikurse kërkon funksioni dhe puna që çdo nëpunës civil kryen në kuadrin e gjerë të veprimtarisë të këtij institucioni. Prej vitit 2016, AMA ka miratuar Kodin e Sjelljes për anëtarët e AMAs.

Nëpërmjet këtij akti nënligjor sanksionohen detyrimet për kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrave zyrtare duke vepruar në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike, duke mbajtur parasysh vetëm interesin publik, pa vepruar arbitrarisht, duke shmangur konfliktin e interesave, duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe ndershmërinë në kryerjen e shërbimit publik.

Gjatë vitit 2018 ka vijuar puna për zbatimin me përgjegjësi të detyrimeve që rrjedhin nga ky Kod dhe kërkesave të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar. Në zbatim të këtij legjislacioni, e në bashkëpunim me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe me drejtuesit e AMA-s, Autoriteti Përgjegjës në këtë institucion ka ushtruar funksionin e vet duke inicuar, kryer dhe koordinuar veprimet e nevojshme për respektimin e detyrimeve të sanksionuara në Kodin e Sjelljes të Anëtarëve të AMA-s, por dhe kërkesave dhe afateve për plotësimin e detyrimeve të përcaktuara edhe në aktet nënligjore e udhëzimet e miratuara nga ILDKPKI.

Për vitin raportues anëtarët e Autoritetit të Mediave Audiovizive kanë zhvilluar 12 mbledhje, në të cilat 9 kanë qënë me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve, ndërsa në një prej tyre ka rezultuar në mungesë z. Zylyftar Bregu (mbledhje e dates 13.07.2018 dhe në dy mbledhje ka rezultuar në mungesë z. Agron Gjekmarkaj (mbledhjet e dates 5.11.2018 dhe 24.12.2018).



## 12.9 Infrastruktura e informacionit dhe e njohurive

### *Rritja e kapaciteteve komunikuese dhe përpunuese në fushën e Teknologjisë së Informacionit*

Gjatë vitit 2018, në kuadër të rritjes së efektivitetit në punë, janë përmirësuar kapacitetet komunikuese dhe përpunuese të informacionit në institucionin e AMA-s. Kjo rritje ka sjellë një performancë më të lartë të zhvillimit të detyrave funksionale, si dhe shtim të elementëve të sigurisë mbi ruajtjen e informacionit.

Rritja e kapaciteteve komunikuese, përpunuese dhe rritja e elementëve të sigurisë së informacionit në AMA konsiston më konkretisht si më poshtë:

- Rrjeti i komunikimit kompjuterik është përmirësuar me parametra bashkëkohorë, duke sjellë komunikim të shpejtë dhe pa ndërprerje të punës së punonjësve të AMA-s.
- Shtimi me elementin teknik Router Cisco duke sjellë siguri, kontroll dhe shpejtësi me te madhe të komunikimit të punonjësve të AMA në rrjet (network) për të kryer detyrat funksionale.
- Vënia në efencë e Serverit Backup të Serverit qendror të AMA-s, duke sjellë rritjen e elementëve të sigurisë së informacionit komunikues dhe përpunues në AMA.
- Pajisje me kompjuter të teknologjisë së fundit të punonjësve në studion e monitorimit të programeve, duke rritur ndjeshëm përpunimin e informacionit mediatik, si dhe ruajtjen e sigurtë të tij.
- Pajisje me kompjuter të teknologjisë së fundit të punonjësve, të cilët e kishin kompjuterin jashtë parametrave teknikë të funksionimit për të ushtruar detyrat e tyre funksionale.
- Sigurimi i dy linjave interneti të pavarura për komunikimin e brendshëm të punonjësve, duke siguruar vijimësinë e punës në raste defektesh.
- Ristrukturim i faqes së internetit në WEB të AMA-s me paraqitje të detajuar të informacionit mbi aktivitetet që kryen institucioni.

## 13 TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE

### 13.1 Menaxhimi i burimeve financiare

Autoriteti i Mediave Audiovizive, si një institucion me vetëfinancim, krijon dhe siguron me burimet e veta financiare përmbushjen e funksioneve të veta. Në këtë prizëm, përmirësimi i treguesve financiarë të veprimtarisë së Autoritetit, si dhe rritja e efektivitetit të shfrytëzimit të këtyre burimeve, ka qenë një ndër objektivat e realizuara të strategjisë së AMA-s dhe Planit të saj të Veprimeve 3-vjeëar, gjatë vitit 2018.

Bazuar në nenin 24 të Ligjit nr. 97/2013, burimet e financimit të AMA-s janë:

- a) të ardhurat nga pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave dhe/ose autorizimeve;
- b) të ardhurat nga pagesat vjetore të licencave dhe/ose autorizimeve;
- c) të ardhurat nga përpunimi administrativ i kërkesave për aplikime;
- ç) të ardhurat nga tarifat për shërbimet e transmetimeve të caktuara në ligjet fiskale, në rolin agjentit tatimor;
- d) financime nga Buxheti i Shtetit;
- dh) burime të tjera të ligjshme.

AMA, me vendimin nr. 229, datë 11.12.2017, ka miratuar projektbuxhetin për vitin 2018 për **“Të ardhura totale”** (Të ardhura korente të pritshme; Të ardhura nga debitorët e vitit kaluar; Të ardhura të mbartura nga viti kaluar; Financim i mundshëm nga Buxheti i Shtetit dhe Financime të tjera të ligjshme (të huaja) dhe **“Shpenzime totale”** (Detyrime kontraktuale të lindura; Paga, kontribute dhe shpërblime; Mallra dhe shërbime; Shpenzim për tu mbuluar nga Buxheti i Shtetit për detyrim të lindur ndaj shoqërisë “Media +” sh.a.; Shpenzime të nevojshme për t’u mbuluar nga burime të tjera të ligjshme (të huaja)).

### 13.2 Realizmi i burimeve të financimit në vitin 2018

#### 13.2.1 Ecuria e arkëtueshmërisë të burimeve të vetfinancimit (a+b+c+ ç)

000 lekë

| Nr.       | Emërtimi                                                                                           | Parashi<br>kimi i<br>të<br>ardhur<br>ave për<br>vitin<br>2018 | Detyrimeve financiare<br>të lindura OSHMA-ve<br>të<br>licencuara/autorizuara<br>në vitin 2018 | Totali i të<br>ardhurave të<br>realizuara viti<br>2018 | Realizimi<br>në % (sipas<br>projekt<br>buxhetit) | Realizimi<br>në %<br>(sipas<br>faktit) |
|-----------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|----------------------------------------|
